



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor  
“Inxhinieri Agroushqimore” profili “Teknologji  
Agroushqimore”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë  
“Universiteti Bujqësor Tiranë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Laura Shabani

Dr. Anisa Dhroso

Muaji/Viti

**Tetor / 2019**



## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky raport u hartua nga shqyrtimi i dokumentacionit mbështetës të vënë në dispozicion nga institucioni pranë ASCAL me qëllim akreditimin e PS të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Agrorshqimore”, profili “Teknologji Agrorshqimore”. Në raport janë paraqitur dhe gjetjet e GVJ nga vizita konkrete dy ditore në Departamentin e Teknologjisë Agrorshqimore (DTAU) dhe takimet me stafin akademik, studentët, dhe përfaqësues të zyrave të ndryshme (sipas axhendës të miratuar) që kontribuojnë në mbarëvajtjen e punës dhe zhvillimit të PS. Mbi bazën e tyre është bërë plotësimi dhe përgjigjia ndaj të gjitha kërkesave lidhur me plotësimin e kriterëve të standardeve të vlerësimit të jashtëm.

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Agrorshqimore”, profili “Teknologji Agrorshqimore” (Bsc në IAU profili TAU) është program studimi ofruar nga Fakulteti Bioteknologjisë dhe Ushqimit pranë UBT. Njësia përgjegjëse për këtë PS është Departamenti Teknologjisë Agrorshqimore. Ky PS është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e FBU dhe jep kontribut në sektorët e prodhimit dhe teknologjitë e ushqimit. PS synon përgatitjen e profesionistëve teknologë agrorshqimorë, specialistë për ushqimin dhe sigurinë ushqimore, të aftë të kontribuojnë në të gjitha etapat e zinxhirit ushqimor.

Programi i studimit në Bachelor në IAU profili TAU është i organizuar në tre vjet studime, gjashtë semestra, zhvillon 30 lëndë teorike të detyruara dhe tre module me zgjedhje; të gjitha modulet janë vlerësuar në kredite, të shpërndara në 6 semestra. Në semestrin e fundit ka të parashikuar si disiplinë më vete praktikë profesionale 90 orë dhe të vlerësuar me 9 kredite. PS finalizohet me provimin e formimit i cili vlerësohet me 6 kredite. Numri total i krediteve është 180.

Struktura dhe organizimi është në përputhje me legjislacionin në fuqi referuar Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 dhe VKM nr.41, datë 24.01.2018. Kreditet e lëndëve, objektivat e studimit, pritshmëritë e aktiviteteve formuese dhe ngarkesa respektive në orë mësimore, janë të paraqitura në çdo syllabus, të moduleve përkatëse sipas VKM nr. 41/2018. Gjithashtu ato janë përmbledhur në kurrikulën e çdo viti si dhe në Planin mësimor të detajuar në orë/kredite, ku tregohet dhe mënyra e vlerësimit të njohurive të fituara, ku 30%-40% fitohet nga veprimtaritë formuese gjatë vitit dhe pjesa tjetër nga provimi në fund të lëndës.

## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Në bazë të Agjendës së vizitës dy ditore (17 – 18 qershor 2019) të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për Vlerësimin dhe Akreditimin e programit të studimit: *Bachelor në "Inxhinieri Agroushqimore me profil Teknologji Agroushqimore"*, të Universitetit Bujqësor të Tiranës të miratuar nga të gjitha palët e përfshira u realizuan këto veprimtari të planifikuara. Për takimet e realizuara sipas Agjendës, shprehemi sa më poshtë:

Datë 17.06.2019

Ora	Veprimtaria e Planifikuar	Pjesmarrësitnëtakim
08 <sup>30</sup> – 09 <sup>00</sup>	Takim i grupit të vlerësimit të jashtëm (Akomodimi dhe diskutim mbi vizitën)	Ky takim u realizua midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (Prof. Asoc. L. Shabani ; Dr. A. Dhroso) dhe Koordinatorit Teknik të ASCAL
09 <sup>00</sup> – 10 <sup>00</sup>	Takim me Dekanin e Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit dhe Përgjegjësën e Departamentit të Teknologjisë Agroushqimore	Ky takim u realizua vetëm me Përgjegjësën e Departamentit të Teknologjisë Agroushqimore, sepse Dekani i Fakultetit ishte e ftuar nga Pamukkale University, Turqi për bashkëpunimin dypalësh.  <i>Megjithatë, GVJ nuk ishte njoftuar për këtë ndryshim.</i>
10 <sup>00</sup> – 11 <sup>30</sup>	Takim me Grupin e vetëvlerësimit të programit	Takimi u realizua me Dr A. P. dhe Dr O. K. Dr. N. Xh. nuk ishte prezent, sepse merrte pjesë në një konferencë jashtë shtetit. Dr V. G. nuk ishte prezent, sepse merrte pjesë në një konferencë jashtë shtetit. Gjithashtu, F. K.- Studente nuk ishte prezent. Në këtë takim morri pjesë studente nga Masteri Shkencor <i>"Inxhinieri Agroushqimore me profil Teknologji Agroushqimore"</i> .  <i>GVJ nuk ishte njoftuar për këto mungesa dhe ndryshime.</i>
11 <sup>30</sup> – 12 <sup>30</sup>	Takim me stafin akademik të programit të studimit	Takimi u realizua me Stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëmpërkëtë program studimi.
12 <sup>30</sup> – 13 <sup>30</sup>	Pushim	
13 <sup>30</sup> – 14 <sup>30</sup>	Vizitë në sekretarinë mësimore	Takimi u realizua me Punonjësen e sekretarisë për programin e studimit: <i>Bachelor në "Inxhinieri Agroushqimore me profil Teknologji Agroushqimore"</i>
14 <sup>30</sup> – 15 <sup>00</sup>	Takim me Qendrën e Karrierës dhe ALUMNI	Takimi u realizua me Përfaqësues të Qendrës
15 <sup>00</sup> – 15 <sup>30</sup>	Mbyllja e ditës së parë të vizites	Ky takim u realizua midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe Koordinatorit Teknik të ASCAL

Datë 18.06.2019

Ora	Veprimtaria e Planifikuar	Pjesmarrësit në takim
08 <sup>30</sup> – 09 <sup>00</sup>	Takim i shkurtër i Grupit të vlerësimit të jashtëm	Ky takim u realizua midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe Koordinatorit Teknik të ASCAL)
09 <sup>00</sup> – 10 <sup>00</sup>	Takim me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Mësimit dhe Kurrikulave	Takimi u realizua me Përfaqësues të zyrave përkatëse
10 <sup>05</sup> – 11 <sup>00</sup>	Takim me studentët e programit të studimit	Ky takim u realizua me Studentët e vitit të parë dhe të dytë të këtij programi. Studentët e vitit të tretë nuk ishin të pranishëm, sepse ishin në praktika mësimore.
11 <sup>00</sup> – 12 <sup>00</sup>	Vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore	Takimi u realizua me personin përgjegjës për këtë zyrë.
12 <sup>00</sup> – 13 <sup>00</sup>	Takim me Zyrën e Studimeve dhe Studentëve	Takimi u realizua me personin përgjegjës për këtë zyrë.
13 <sup>00</sup> – 13 <sup>30</sup>	Pushim	
13 <sup>35</sup> – 14 <sup>30</sup>	Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.)  Vizitë në Bibliotekë	Vëzhgimi i mjediseve u krye nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, Koordinatorit Teknik të ASCAL dhe përfaqësues (Profesor, ndihmës akademik shkencor) përgjegjës për sektorë të ndryshëm.  Vizita në Bibliotekë nuk u krye, sepse personi përgjegjës ishte njoftuar për një takim jo të parashikuar në Akademinë e Shkencave.
14 <sup>30</sup> – 15 <sup>00</sup>	Takimi përmbyllës me Përgjegjës të Departamentit	Ky takim u realizua me Përgjegjës të Departamentit të Teknologjisë Agrorëshqimore.

Më datë 17.09.2019 është dërguar në Institucion Draft RVJ nëpërmjet sistemit AMS por edhe me shkresë zyrtare. Më datë 24.09.2019 vjen përgjigja/oponenca nga UBT në lidhje me këtë Draft. Oponenca e UBT i dërgohet GVJ nëpërmjet email. GVJ i pa me kujdes përgjigjet e UBT në lidhje me Standardet dhe kriteret e këtij Drafti duke marrë parasysh disa prej tyre dhe duke bërë edhe ndryshimin përkatës në Raportin përfundimtar. Për pikat që nuk janë ndryshuar, GVJ ka dhënë shpjegimin përkatës. Për shkak të numrit të konsiderueshëm të këtij materiali, përgjigja e GVJ, gjëndet në Aneks, në fund të Raportit përfundimtar.

## LISTA E SHKURTIMEVE

<b>AKU-</b>	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	<b>ISUV-</b>	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
<b>AL-</b>	Arsimi i Lartë	<b>IU-</b>	Inxhinieria Ushqimore
<b>ASCAL-</b>	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë	<b>MASR</b>	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise
<b>AU-</b>	Analizat e Ushqimeve	<b>MSH-</b>	Master Shkencor
<b>BCH-</b>	Bachelor	<b>PA-</b>	Personel Akademik
<b>BU-</b>	Bioteknologjia Ushqimore	<b>PS-</b>	Program Studimi
<b>CSU-</b>	Cilesia dhe Siguria Ushqimore	<b>QKU-</b>	Qendra e Kërkimeve të Ushqimit
<b>DBNJ-</b>	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	<b>RVB-</b>	Raporti i Vlerësimit të Brendshëm
<b>DIOKS-</b>	Dega e Informimit, Orientimit dhe Karrierës së Studentëve	<b>RVV-</b>	Raporti i Vetëvlerësimit
<b>DK-</b>	Departamenti i Kimisë	<b>SHU-</b>	Shkencat e Ushqimit
<b>DSHUB-</b>	Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë	<b>TAU-</b>	Teknologji Agroushqimore
<b>DTA-</b>	Departamenti i Teknologjise Agroushqimore	<b>TEEA L-</b>	The Essential Electronic Agricultural Library
<b>ECTS-</b>	European Credit Transfer System	<b>TU-</b>	Teknologjite Ushqimore
<b>FBU-</b>	Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	<b>UBT-</b>	Universiteti Bujqësor i Tiranës
<b>GMK-</b>	Grup mësues kërkimor	<b>VE-</b>	Vreshtari – Enologji
<b>GVB-</b>	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm	<b>VKM-</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>IAL-</b>	Institucioni i Arsimit të Lartë	<b>ZKS-</b>	Zyra e Karrierës dhe Studenteve
<b>IAU-</b>	Inxhinieri Agroushqimore	<b>ZSS-</b>	Zyra e Studimeve dhe Studentëve

### Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor Inxhinieri Agroushqimore me profil Teknologji Agroushqimore




**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Në bazë të raportit të GVB, programi i studimit BCH IAU në profilin TAU, si pjesë e programeve të Universitetit Bujqësor të Tiranës është në përputhje me strategjinë kombëtare të bujqësisë nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar nr. 3. Ky PS ka në fokus zhvillimin ekonomik të vendit dhe ka si qëllim dhe synon aftësimin e studentëve për përgatitjen profesionale bazë për tu punësuar në sektorin e përpunimit të industrisë agroushqimore dhe përmbushjes së qëllimeve dhe prioritetëve kombëtare. Kjo tregohet në dokumentin nr.7, neni 2. Në bazë të dokumentit nr. 6, Rregullore e FBU, neni 22/b dhe dokumentit nr. 7, neni 11/b, thuhet se "Programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit. Konstatohet tek dokumenti nr. 4.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Mbështetur në objektivat e studimit PS BCH IAU-TAU synon ruajtjen e vlerave akademike e kulturore dhe jep kontribut në sektorët e prodhimit bujqësor dhe blegtoral dhe teknologjitë e përpunimit të ushqimit si dhe në zhvillimin ekonomik kombëtar. Kjo tregohet në dokumentat nr. 1 dhe nr. 7, neni 2.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në Statutin e institucionit Programi i Studimit BCH në IAU-TAU është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e FBU. Programi i studimit BCH në profilin TAU synon nxjerrjen e të diplomuarve me ide krijuese dhe inovative, të aftë për të punuar në sektorë të teknologjisë agroushqimore të përpunimit të lëndëve të para; të aftë për të zhvilluar sisteme të manaxhimit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Kjo tregohet në dokumentin nr. 1,. Ky program i ofruar hartohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të UBT-së dhe në përputhje me misionin dhe vizionin e FBU-së, i cili mundëson përgatitjen e specialistëve dhe shkencëtarëve në fushën IAU me njohuritë bazë në profilin përkatës TAU. Kjo tregohet në dokumentat nr. 6, neni 22/d dhe nr. 7, neni 11/a.
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Sipas raportit të GVB, Hartimi dhe realizimi i PS është udhëhequr nga nevojat e biznesit dhe fleksibiliteti, për t'iu përgjigjur përfituesëve (tregut të punës). Është hartuar në përputhje me njohuritë shkencore, teknologjitë bashkohore për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar nr. 3, pika 4.1.1. Sipas RVB, programi i studimit të ciklit të parë "BCH" në profilin TAU, është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës për të nxitur zhvillimin ekonomik të vendit.Kjo tregohet në dokumentat nr. 6, neni 22/d dhe nr. 7, neni 11/a. Rritja e vazhdueshme e ndërmarjeve të agropërpunimit, ngritja e laboratorëve të kontrollit në rajone të ndryshme të vendit, ndërmarjet e shërbimit katering si dhe rrjetet e supermarketeve, tregon nevojën

	e tregut të punës për tu diplomuar në IAU, në profilin TAU. Dokumenti nr. 16, Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit 2005.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				√

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Hartimi i programit të studimit të ciklit të parë BCH në IAU në profilin TAU, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UBT dhe në përputhje me parimet e deklaratës së Bolonjës. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar nr. 3, pika 4.1.1; dokumentin nr. 3.2, pika 3.1 dhe pika 4.1; në dokumentin nr. 3.3, Kreu I,3. Në dokumentin nr. 3, në pikën 4.1, tregohet se PS BCH në TAU, ka disiplina të formimit të përgjithshëm 36, formimi bazë 10, fomuese integruese 23 dhe formuese si gjuhe e huaj etj. 3. Megjithatë, në dokumentin 14.2, Kurrikula e BSC në IAU 2018-2019, tregohet se janë gjithsej 33 disiplina të formimit të përgjithshëm. PS ka në fokus fuqizimin e kompetencave profesionale në përputhje me zhvillimin strategjik të institucionit. Mbarvajtja e programit të studimit është e lidhur edhe me rifreskimin e stafit akademik dhe kualifikimin e stafit të ri, të cilat ndihmojnë që programi të mbart njohuri dhe përvoja të transferuara dhe kërkimeve nga jashtë vendit.
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti i FBU dhe rregullorja e DTAU përcaktojnë drejtimit prioritar akademike dhe tregon se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me këto prioritete.  FBU ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në fushat e agropërpunimit dhe ushqimit, drejtimit të përcaktuara specifiku në Rregulloren e Departamentit të Teknologjisë Agrorshqimore, i cili fokusohet në fushën e zhvillimit rural dhe në fushën e politikave agrare, nëpërmjet hartimit dhe ofrimit të programit të studimit BCH në profilin "Teknologji Agrorshqimore" me objektiva të qarta të formimit (shprehur në rregulloren e PS) Kjo tregohet në dokumentin nr. 7, neni 2.
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Në bazë të RVB, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit bëhet me qëllim formimin e profesionistëve të përshtirë në administrimin, vlerësimin dhe procesin e transformimit të lëndëve të para dhe ushqimit. Emërtimi i programit të studimit BCH në profilin "Teknologji Agrorshqimore" është bazuar në ligjin e arsimit të lartë, dhe bazuar në VKM Dt 12.08.2005, ku janë miratur 240 kuota për fillimin e studimeve në këtë program. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar nr. 31.1 dhe në dokumentin nr. 7, neni 1. Gjithmonë në RVB dhe dokumentat ku Institucioni (Rektorati i UBT, dokumenti nr. 1.4, Aplikim për akreditim programi) i drejtohet ASCAL për akreditimin e këtij PS, përdoret emërtimi BCH në profilin "Teknologji Agrorshqimore". Mendojmë se është emërtim i përshtatshëm që



	përputhet me përmbajtjen dhe tërësinë e moduleve që zhvillohen në këtë program, duke i dhënë atij karakterin e një programi studimi që jep njohuritë bazë në fushën e teknologjive të përpunimit agrorëshqimor, dhe vlerësimit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Ky PS u krijon mundësi studentëve të vazhdojnë studime të thelluara ose të avancuara në disa drejtime të shkencave të ushqimit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			✓

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Programi i studimit BCH në IAU në profilin TAU ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këtë program, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit, këto reflektohen në përmbajtjen e planit mësimor dhe syllabuset e moduleve për programin e studimit në profiling "TAU" Këto objektiva dhe aftësi u bëhen të njohur studentëve nga pedagogët në fillim të çdo moduli mësimor, të përcaktuara qartë në programet mësimore të çdo moduli, në rubrikën "përmbledhje dhe rezultate të nxënimit". Gjatë vizitës së GVJ u konfirmuan që të gjitha Syllabuset ndodhen në departament dhe në dokumentat onile.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Sipas RVB, një nga pikat e forta në të cilat është mbështetur hapja e programit të studimit BCH në IAU me profil TAU është nevoja e tregut të punës për këtë profesion të kërkuar në fushën e agropërpunimit. Sipas të dhënave statistikore të vitit 2000 numëri i përgjithshëm i ndërmarrjeve përpunuese ishte 1841, ato shtohen me një rritje afërsisht 2% në vit. Ligji i Ushqimit (2008), përcakton me detyrim vendosjen e një drejtuesi teknik në këto ndërmarrje të agropërpunimit ku te diplomuarit në këtë PS kanë prioritet. Kjo tregohet në dokumentin nr. 16, Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit 2005. Pranë Zyrës së Karrierës në FBU studentët plotësojnë skedën e punësimit, duke dhënë informacione në lidhje me punësimin aktual dhe kjo shërben për të gjurmuar e punësuar ata në 5 vitet në vazhdim. Dokumenti i dorëzuar nr. 17, tregon Skedën e punësimit të plotësuar për student që kanë mbaruar PS Master Shkencor. Një pjesë e studentëve të nivelit BCH në IAU në profilin TAU punojnë me kohë të pjesshme ose me orar të reduktuar gjatë kohës së studimeve dhe me kohë të plotë gjatë sezonit të verës. Nga përpunimi statistikor i të dhënave të marra nga plotësimi i skedave të punësimit rezultojnë se 80% e studentëve që përfundojnë studimet e nivelit BCH -TAU, vazhdojnë studimet më të thelluara në nivelin Master në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit, dhe vetëm 5% punësohen në sektorin e industrisë ushqimore ose shërbimeve të tjera. Dokumenti i dorëzuar nr. 17.1.

<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formues të programit të studimit BCH në profilin “TAU” janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Programit të Studimit (dokumenti nr. 7, neni 2). Ato specifikohen dhe përshkruhen qartë në seksionin: “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit” në çdo program mësimor të modulit. Këto objektiva janë me karakter profesional, njohuritë që ofrohen të cilat karakterizojnë profilin e programit janë në përputhje me nivelin e studimeve të ciklit të parë dhe ndihmojnë në përgatitjen e studentëve për nevojat e tregut të punës duke lehtësuar punësimin tyre. Dokumenti i dorëzuar nr. 17.1.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>

<p><b>Standardi I.4</b>  <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë në profilin “TAU” realizohet pranë Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit dhe DTAU është përgjegjës për zbatimin e këtij programi. Kjo tregohet në dokumentin nr. 6, neni 6, pika 1. Këto njësi kanë kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike të Teknologjisë Agrorshqimore, për të ofruar një program të tillë studimi. Personeli FBU përbëhet: sipas dokumentit nr. 23.1, Tabela nr. 1.1 Numri i punonjësve në FBU, tregon 32 personel akademik dhe 6 punonjës kërkimor, gjithsej 38 personel akademik. Dokumenti nr. 23.2, Tabela 1.2 tregon 19 punonjës ndihmës pra 57 personel në total. Sipas dokumentit nr. 43.1, Tabelë Kualifikimesh për PA të Programit të Studimit BCH në TAU departamenti ka gjithsej 38 pedagogë . Staf i pedagogjik i këtij programi studimi përbëhet nga 9 pedagogë me titullin Profesorë, dhe 7 me titull MSc. Gjithashtu, dokumenti nr. 23, Tabela nr. 1 Numri i punonjësve në FBU, tregon 38 staf pedagogjik (personel akademik dhe punonjës kërkimor).</p> <p>Në funksion të përmbushjes së programit të studimit, nga stafi i përgjithshëm i FBU, 9 janë pjesë e stafit akademik dhe 4 e stafit ndihmës akademik të Departamentit të Teknologjisë Agrorshqimore. Kjo tregohet në dokumentin nr. 23.1 dhe 23.2. Gjithashtu merr pjesë staf akademik angazhuar në mësimdhënien e moduleve ndërfakultetore duke ndarë ngarkesën mësimore. Bazuar në të dhënat tabelore të stafit të angazhuar në programin e studimit BCH TAU, sipas dokumentit nr 24 rezulton se ka një promovim të stafit në titujt akademik të fituar ndër vite. Nga ky dokument stafi i këtij PS rezulton: 2016-2017 janë gjithsej 34 personel akademik nga të cilët: me titull Prof. Dr 12; Prof. Asc 3; Dr 14; Msc 5.</p>

	<p>2017-2018 janë gjithësej 32 personel akademik nga të cilët: me titull Prof. Dr 10; Prof Asc 3; Dr 15; Msc 4.</p> <p>Ndërsa për vitin akademik 2018-2019 rezulton 38 personel akademik nga të cilët: me titull Prof. Dr. 9; Prof Asc 6; Dr 16, Msc 7.</p> <p>Nga këto të dhëna tregohet se stafi është i kualifikuar dhe ka burimet e duhura në fushën akademike për të ofruar eksperiencën e tyre në këtë PS. Gjithashtu, sipas dokumentit nr. 43.1, Tabelë Kualifikimesh për PA të Programit të Studimit BSc në TAU departamenti ka gjithësej 38 pedagogë. Stafi akademik ka bërë përpjekje të vazhdueshme për kualifikimin e tij. Stafi akademik ka marrë pjesë aktive në Projekte të ndryshme, si, ERASMUS, Netchem. Kjo tregohet në dokumentin nr. 43.2.</p>								
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit BCH në IAU në profilin TAU është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, FBU. Në thelb fusha e studimit të FBU, në gjithë programet e studimit lidhet me: Karakterin modifikues të ushqimeve me origjinë bimore e shtazore, kontrollin e cilësisë në proceset teknologjike të krijimit, manipulimit, transformimit, ambalazhimit, ruajtjes dhe tregtimit të produkteve ushqimore; Garantimin e cilësisë së proceseve e të produkteve, me anën e zbatimit të sistemeve të sigurimit të cilësisë dhe administrimit të saj. Kjo tregohet në dokumentin nr. 3.2, pika 1.2 dhe 1.3. Kodifikimi i programit të studimit të ciklit BCH në IAU, në profilin "TAU" bëhet bazuar në Ligjin e Arsimit të lartë 80/2015, Neni 86; UBT ka bërë kërkesën pranë MAS për kodifikimin e Programeve të Studimit, por nuk ka marrë ende konfirmim të këtij kodifikimi.</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e PS BCH në IAU, Profili TAU, është DTA. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit BCH në IAU në profilin TAU është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të DTAU: studime e kërkime në fushën e Teknologjisë Agroushqimore. Pritet kodifikimi i programit të studimit të ciklit BCH në IAU, në profilin "TAU" nga MAS bazuar në Ligjin e Arsimit të lartë 80/2015, Neni 86.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>√</td> </tr> </tbody> </table>	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				√
Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			√						

<p><b>Standardi I.5</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit</p>	<p>Mbikëqyrjen, mbarëvajtjen dhe drejtimin e programit të studimit të ciklit BCH në profilin "Teknologji Agroushqimore", e bën</p>

<p>nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>përgjegjësi Departamentit të Teknologjisë Agroushqimore. Në dokumentin e dorëzuar nr. 6.1 Në bazë të RVB, në përbërje të këtij Departamenti janë grupet mësimore e kërkimore. Krijimi dhe organizimi i tyre bëhet me vendim të mbledhjes së përgjithshme të Departamentit dhe me miratim të Dekanit të FBU. Grupet mësimore e kërkimore në DTA janë dy: GMK i Teknologjisë Agroushqimore; GMK i Inxhinierisë se Proçeseve të Përpunimit të Ushqimeve. Dokumenti i dorëzuar nr. 43.3, thuhet GMK i Teknologjisë Ushqimore (6 anëtarë) dhe GMK i Inxhinierisë Ushqimore (5 anëtarë). Veprimtaria e GMK-ve monitorohet nga Përgjegjësi i DTA dhe një herë në vit kryhet analiza e punës mësimore e kërkimore e tyre. Dokumentat nr. 43.4 dhe 43.5, janë vetëm për vitin 2017-2018, dhe jo për 5 vitet e fundit, sic theksohet në indeksat 63 dhe 64.</p>
	<p>Përgjegjësi i departamentit si përgjegjës për hartimin, propozimin e PS dhe të kërkimit shkencor, zhvillon analizën e vazhdueshme të punës së personelit, përgjegjësisive dhe plotësimin e detyrave të tyre të cilat i monitoron nëpërmjet analizës periodike vjetore të veprimtarisë mësimore –kërkimore. Dokumenti nr. 38.1, Analiza Mësimore DTA 2017-2018.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, FBU ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me 16 institucione dhe operatorë biznesi sipas marrveshjeve të nënshkuara. Nëpërmjet tyre synon nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe shkencore, organizimin e trajnimeve dhe seminareve, vizitave, kryerjen e praktikave profesionale, shkëmbimin e literaturës shkencore, ndër të cilat dhe marrëveshje bashkëpunimi për studentët e programit të studimit BCH në IAU në profilin “TAU”. Në dokumentin nr. 34.3 jepen qartë Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës me institucionet Homologe brenda dhe/ose jashtë vendit (Institucione të Arsimit të Lartë nga vende të ndryshme në Europë, Azi, Kosovë dhe Shqipëri (44 marrëveshje), aktorët e Biznesit vendas dhe/ose të huaj (43 biznese) për të realizuar me sukses objektivat e lidhura me procesin e mësimdhënies në mënyrë cilësore. Ndërsa në dokumentin nr. 32.1 jepet Marrëveshja e Fakultetit FBU me institucionet, gjithsej 16. Në lidhje me bashkëpunimin me institucione janë dorëzuar: Marrëveshja UBT me Carrefour (32.2), Marrëveshja UBT me MBZHRAU (32.2), Marrëveshja UBT me AKU, Marrëveshja FBU me Univ. Milano, Lektor në Giessen, Kontratë FBU me Univ. e Mitrovicës, Marrëveshje FBU me Univ. e Varshavës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga raporti GVB, nëpërmjet analizës vjetore të çdo fundviti akademik, DTA, raporton lidhur me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve. Në bazë të dokumentit të dorëzuar nr. 38.1, 2.8 Praktikrat profesionale pika 4 citohet se: <i>“Zhvillimi i praktikave profesionale pranë njësisive prodhuese, duke shfrytëzuar maksimalisht mundësitë e negociimit për hartimin e disa marrveshjeve të bashkëpunimit me sipërmarrjet private të sektorit agroushqimor. Mbetet detyrë të rregullohen marrveshjet institucionale ndërmjet Fakultetit dhe bizneseve</i></p>

	<i>të Agropërpunimit dhe kontrollit të cilësisë së produkteve ushqimore, për kryerjen e praktikës profesionale të studentëve, intershipit dhe një punësimi të mundshëm të tyre.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Sipas raportit RVB, programi i studimit BCH në IAU në profilin Teknologji Agoushqimore, ofron programin e praktikave profesionale, të cilat realizohen nëpërmjet vendosjes së marrëdhënieve zyrtare bashkëpunimi midis FBU dhe institucioneve bashkëpunuese. Këto institucione janë aktorë të biznesit në industrinë ushqimore, në përputhje me programin e studimit. (listë me 40 aktorë biznesi etj, por nuk ka dokument të marrëveshjeve të nënshkruara konkretisht, egziston një dokument formular marrëveshje). Në bazë të dokumentit 34.1, Formati i marrëveshjes së bashkëpunimit, nuk janë dorëzuar nga GVB marrëveshje të nënshkruara midis Fakultetit FBU dhe Bizneseve, është dorëzuar vetëm një tabelë përmbledhëse nr. 32.1.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Sipas RVB, FBU ofron aktivitete trajnuese profesionale me studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. Këto trajnime realizohen në kuadër të specializimit të mëtejshëm profesional. Në dokumentin nr. 33, paraqitet një tabelë përmbledhëse me aktivitetet trajnuese profesionale 2018-2019, gjithsej 7 aktivitete.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Sipas RVB, programi i studimit në ciklin e parë BCH në IAU, profili TAU është i organizuar në lëndë dhe module, ku vlerësimi i krediteve realizohet në përputhje me legjislacionin, Ligji Arsimit Lartë 80/2015 si dhe sistemit (ECTS). Numri total i krediteve për ciklin e parë të studimeve BCH në IAU, profili TAU është 180 ECTS. Kreditet e lëndëve janë të paraqitura në çdo syllabus sipas VKM 41/2018, shtojca A, dhe e përmbledhur në kurrikulën dhe planin mësimor të çdo viti. Në bazë të dokumentit nr. 36.2, neni 70 thuhet se: Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). 2. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite. Në dokumentin nr. 14.1, VKM 41/2.1, nuk jepet shtojca A, por mendojmë se i referohet shtojcës Nr.2.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>PS të ciklit të parë BCH në IAU, profili TAU synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. PS synon përgatitjen e specialistëve teknologë agroushqimorë, specialistë për ushqimin dhe sigurinë ushqimore, të aftë të kontribuojnë në të gjitha etapat e zinxhirit ushqimor (manipulimin e transformimin e lëndëve të para me origjine bimore, shtazore; ambalazhimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve ushqimore). Dokumenti i dorëzuar nr. 7, neni 2. Aftësitë e duhura profesionale që fitohen në përfundimin e çdo moduli të ofruar në programin studimit të ciklit të parë shprehen në syllabusin e depozituar nga çdo pedagog i modulit në departament, përkatësisht në seksionin “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxëniet” Gjatë vizitës së GVJ u konfirmuan që të gjitha Syllabuset ndodhen në departament, dhe në dokumentat on line.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Sipas RVB, programi i studimit të ciklit të parë BCH në IAU, profili TAU ka përmbajtje që u ofron studentëve njohuritë bazë që do të jenë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit dhe njëkohësisht u përgjigjet kërkesave me të cilat përballen studentët gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Kjo tregohet në dokumentin nr. 7, neni 11, pika e. Të kuptuarit të teorive dhe parimeve të fushës mbështetet në veprimtaritë formuese siç janë mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale) dhe studim individual (studim e punim relacionesh detyrash apo projektesh etj). Të gjitha këto veprimtari janë të shprehura në programin mësimor të çdo disipline të programit të studimit, të cilat gjenden pranë departamentit.</p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Sipas RVB, në përfundim të programit të studimit, studentët zotërojnë kompetenca dhe kapacitete analitike të nevojshme për të trajtuar problematikat teorike dhe praktike në fushën e ndjekur. Kjo tregohet në dokumentin nr. 7, neni 11, pika f. Programi Studimit siguron zhvillimin e kompetencave profesionale nëpërmjet koncepteve themelore të cilat trajtohen nga secili modul dhe shprehen mjaft qartë në syllabuset e moduleve përkatës Seksioni “Temat që zhvillohen”. Gjithashtu sigurohet që zhvillimi i kompetencave profesionale të mbeshetur në literaturën bashkohore edhe të perditesuar në vazhdimësi. Kjo paraqitet në Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite 2014-2019 Hardcopy ne departament dhe online.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Sipas RVB, programi i studimit BCH në IAU, profili TAU ka si dokument të rëndësishëm planin mësimor me karakter të gjerë informativ, në të cilin jepen në mënyrë të përmbledhur tërësia e veprimtarive formuese dhe është konform akteve ligjore e nënligjore të IAL 2015. Në këto plane mësimore paraqiten: emërtimi i programit të studimit, objektivat formuese, kohëzgjatja normale e studimeve. (dokumenti nr. 7, neni 3). Gjithashtu paraqiten tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave ose module), që përbëjnë programin e studimit, të grupuara në semestra (dokumenti nr. 7, neni 12). c. Kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarja e oreve brenda një disipline, sipas veprimtarive formuese të saj (leksione/ ushtrime/ seminare/ laboratorë/ detyra/ projekte, ngarkesa në auditor, ngarkesa javore në auditor (dokumenti nr. 7, neni 3).</p> <p>Sipas RVJ: Programi i studimit të ciklit të parë BCH në IAU, profili TAU zhvillohet ne 6 semestra, ka 180 kredite gjithesej, ka 31 disiplina formuese ose module te detyruara ku përfshihet edhe: Praktika profesionale” modul me 9 kredite në semestrin e VI. Studenti duhet të zgjedhë edhe 2-3 lëndë me zgjedhje në semestrin VI të cilat në total të kenë 9 kredite, nga një listë prej 12 disiplinash ose modulesh.(kurrikula 2018-2019)</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Numri total i krediteve 180, në programin e studimit është i shpërndarë sipas veprimtarive formuese, të kërkuara në VKM Nr. 41, e cila shpreh qartë përqindjen që duhet të zërë specifikisht çdo veprimtari formuese. Përqindja totale e lëndëve të kategorive bazë dhe karakterizuese (Tipologjia A dhe B) ne rastin e këtij programi BCH është më shumë se 70%, perkatësisht është 77%. Dokumenti i dorëzuar nr. 7, neni 12. Në dokumentin nr. 14.1, VKM 41/2.1, nuk jepet shtojca A, por mendojmë se i referohet shtojcës Nr.2. Gjithashtu të gjitha veprimtaritë formuese në veçanti janë në përputhje të plotë me VKM 41 për programin BCH.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">√</p>

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>FBU është i organizuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 «Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë», si dhe në përputhje me Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës. Dokumenti i dorëzuar nr.2 neni 25 pika 1/c. FBU funksionon dhe realizon misionin e tij duke u mbështetur në aktivitetin mësimor dhe kërkimor të katër njësive bazë departamenteve të ngritura pranë tij: DTA, DSHUB, DK, QKU. Dokumenti i dorëzuar nr.3.2 raporti vetëvlerësimi FBU 2018, organigrama, faqe 20. UBT ka marrë konfirmimin nga ASCAL për akreditimin e Programit të Studimit ciklin e parë BCH në IAU, Profili TAU si dhe ka kryer pagesën për këtë shërbim. Dokumenti i dorëzuar nr.1.2 Konfirmim Aplikim ASCAL (nr 9 BA Teknologji Agroushqimore) dhe Dokumenti i dorëzuar nr 1.3 Pagesa e Akreditimit PS në UBT.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në FBU u konstatua që në programin e studimit cikli i parë BCH në IAU, pofili TAU koordinatori i Programit të Studimit është në të njëjtën kohë dhe përgjegjës DTA. Ai është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit që ofron FBU. Rregullorja e studimeve të FBU (Ref. dokumenti nr 6_1) përcakton qartë detyrat dhe rolin e Përgjegjësit të departamentit njëkohësisht dhe koordinatori i programit të studimit; konkretisht në Nenin 16, pika 6, pika 8 dhe pika 14. Koordinator i programit BCH, mban titullin Prof. Asc. Në dokumentin e dorëzuar nr 36.2 L80/2015 neni 25.3. Koordinator i programit harton një raport mbi ecurinë e programit të studimit ku janë të specifikuara ecuritë dhe problematikat e shfaqura gjatë vitit akademik. Dokumenti i dorëzuar nr 38.1, 38.2 Analiza e punës mësimore dhe kërkimore 2017-2018. Përmirësime në programet dhe planet mësimore të programeve të studimit janë kryer çdo vit, duke synuar një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FBU përmbush detyrimet ligjore si njësi e UBT, ka të punësuar staf akademik, staf mbështetës dhe administrativ. Dokumenti i dorëzuar nr 36.2 Ligji Nr. 80/2015 neni 25, Pika 4; DTA plotëson standardin numerik (mbi 7 personel akademik) për të qenë njësi bazë, pasi ka në përbërje të tij 9 anëtarë lektorë me kohë të plotë, si Personel Akademik, nga të cilët 3 (tre) mbajnë titullin akademik “Profesor” dhe Prof Asc; 4 (katër) kanë gradën shkencore Doktor i Shkencave dhe 2 (dy) asistentë lektorë kanë gradën MSc. Dokumenti i dorëzuar nr 23.1 (të dhëna tabelore për PA). DTA ka në përbërje dhe 4 (katër) anëtarë personel ndihmës akademik. Dokumenti i dorëzuar nr 23.2.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Njësoj si më sipër Kriter 3. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë BCH në IAU profili TAU përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, rreth 77 % të të gjithë stafit akademik efektiv të njësisë bazë ka tituj akademikë dhe grada shkencore, Dokumenti i dorëzuar</p>



	nr 23.1. Ndërsa 23 % e stafit nuk ka filluar ende procesin e kualifikimit kjo pasi pritet hapja e studimeve të Ciklit të Tretë pranë IAL.			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësoj si më sipër Kriter 3 DTA plotëson standardin numerik (mbi 7 personel akademik) për të qenë njësi bazë, pasi ka në përbërje të tij 9 anëtarë lektorë me kohë të plotë, si Personel Akademik, nga të cilët tre mbajnë titullin akademik "Profesor" dhe Prof Asc; katër kanë gradën shkencore Doktor i Shkencave dhe dy asistentë lektorë kanë gradën MSc. Dokumenti i dorëzuar nr 23.1 (te dhena tabelore per PA). DTA ka në përbërje dhe katër anëtarë personel ndihmës akademik. Dokumenti i dorëzuar nr 23.2.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				√

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Tërësia e veprimtarive formuese shprehet në planin mësimor. Dokumenti i dorëzuar nr 14.5. Në planin mësimor të programit të studimit BSc në TAU përcaktohen: lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra me kreditet përkatëse. Aty tregohet shpërndarja e krediteve për çdo modul, gjithashtu ato pasqyrohen në programet e lëndëve. Veprimtaritë formuese janë në përputhje me rregulloren e njësisë bazë. Dokumenti i dorëzuar nr 6 neni 23. Raportet ndërmjet veprimtarive formuese të programit të studimit të ciklit të parë BCH janë në përputhje me specifikimet në VKM nr 41. Dokumenti i dorëzuar nr 14.1 pika 2.4 a, b. Konkretisht për PS BSc në TAU veprimtaritë formuese janë: mësim në auditor, (si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë), forma të kontrollit të vazhdueshëm; studim individual, (si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektsh; përgatitje për provime) përgatitje e provimit të diplomës. Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë. Dokumenti i dorëzuar nr 14.5. dhe Dokumenti i dorëzuar nr 6 neni 23.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Program i studimit të ciklit të parë në TAU është në përputhje me legjislacionin në fuqi VKM nr 41 është e organizuar në lëndë, module, (Dokument i dorëzuar nr 14.1 pika 2.3); gjithashtu ka praktikë profesionale në përmblyllje të ciklit e cila ka 90 kredite dhe 90 orë në ngarkesën totale si dhe praktikave dhe aktiviteteve formuese që secili pedagog i lëndës organizon gjatë zhvillimit të modulit, përcaktuar në Rregullore e programit studimit Dokumenti i dorëzuar nr 7 neni 12 pika 1.

<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë BCH në IAU profili TAU është i organizuar në lëndë module (31 module të detyruara dhe tre module me zgjedhje) të cilat janë të vlerësuara në total me 180 kredite ECTS, të ndara në gjashtë semestra. Çdo semester ka 30 kredite. Në semestrin e gjashtë përgatitet Provimi Formimi ose temë diplome që vlerësohet me 6 kredite. Dokumenti i dorëzuar nr 7 neni 12 pika 1 dhe pika 4. Numri total i krediteve në programin e studimit të teknologjisë ushqimore, është i shpërndarë sipas veprimtarive formuese, të kërkuara. Për programin e studimit të ciklit të parë BCH në IAU profile TAU, veprimtaritë formuese të lëndëve të kategorisë A janë 7 module që përbëjnë 22%; lëndë të veprimtarisë formuese të kategorisë B janë 18 dhe përbëjnë 55 %; të kategorisë C janë 3 module të cilat bëjnë 8% nga (12% -15%); të kategorisë D është 10% nga (10-15%) të cilat janë 2-3 module me zgjedhje dhe detyrimet përmbyllëse 3%. Kjo rezulton sipas dokumentit të dorëzuar nr 14.7-tipologjia e veprimtarive formuese.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>PS përmban planin mësimor, në të cilin përfshihen informacionet e nevojshme për modulet e zhvilluara si: ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Bazuar në dokumentat e dorëzuar 14.5 rezulton se në këtë PS plani mësimor ka të pasqyruar ngarkesën mësimore për çdo modul të ndarë në orë leksion: orë seminar, nuk del qartë ngarkesa në orë laborator për ato module që zhvillojnë praktika laboratorike. Studenti vlerësohet deri 30% - 40% gjatë vitit për frekuentim, aktivizim sipas veprimtarive formuese të specifikuar në planin mësimor dhe syllabus. Mënyra e vlerësimit përfundimtar të dijeve është me provim me shkrim (pak module aplikojnë provim me gojë ose shkrim /gojë ). Dokumenti i dorëzuar nr 14.5.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informimi i studentëve në lidhje me programin e studimit dhe kurrikulën përkatëse realizohet përmes veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë së studentëve. Përgjigjëse për këtë mision është ZKS në FBU e cila jep kontributin kryesor në informimin e studentëve për programet e studimit, rezultatet e provimeve, detyrimeve, grafikët e provimeve dhe njoftimeve të tjera që lidhen me kriteret e pranimit të studentëve, rregullat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kjo bazuar në dokumentin e dorëzuar nr 12 dhe 13 Rregullore e DZHKKVI neni 15 dhe 16; dhe në rregulloren e programit të studimit. Dokumenti i dorëzuar nr 7 neni 14.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (c e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Personeli Akademik i cili është pjesë e programit të studimit të ciklit të parë BCH TAU, duhet të dorëzojë çdo fillim viti akademik, programin lëndor (syllabus-in) për modulën që mbulon, në formatin e përcaktuar në VKM 41/2018. (përshkrimi, objektivat e të nxënit, temat e leksioneve ngarkesën në auditor, literaturë etj.) Sipas dokumentit të dorëzuar 14.1 pika 2.8 dhe shtojca nr 2. GVJ konstatoi se secili titullar lënde duhet të paraqesë në departament, planin kalendar ku ka të specifikuar me orë dhe përqindje, informacionin e nevojshëm për organizimin e lëndës, leksione dhe seminare ose ushtrime /laboratore. Sipas modelit të dokumentit të dorëzuar nr 35.1 GVJ: Mendojmë që këto elemente duhet të jenë në</p>

	<p>të njëjtin format syllabusi ose programi lënde duke specifikuar ngarkesën javore në auditor për veprimtarinë formuese (leksion: seminar/ushtrime: laboratore) me temat përkatëse të leksioneve dhe më pas për tematikat e laboratoreve; ashtu si e parashikon VKM Nr 41 dt 24.01 2018. (dokumentit të dorëzuar nr 14.1 pika 2.8 dhe shtojca nr 2.) Nuk është e nevojshme që krahas programit të lëndëve të jenë dhe planet kalendarike të lëndëve thjesht për të treguar tematikat e seminareve ose praktikave laboratorike. Dokumenti i dorëzuar nr 35.1.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është objekt rishikimi dhe vlerësimi periodik. Ndryshimet propozohen nga DTAU, Dekanati, deri në miratimin përfundimtar nga Senati Akademik i UBT-së, në rastin kur masa e ndryshimit të kërkuar nuk e kalon nivelin 20%. Dokumentit të dorëzuar nr 6 neni 23 pika 3. GVJ konstatoi se këto ndryshime shihen sipas dokumentit të dorëzuar nr 14.3 dhe 14.2 (kurrikula të PS në vite 2014-2019). Modalitetet për ndryshime të rëndësishme të planit mësimor përcaktohen në rregulloren e FBU dokumentit të dorëzuar nr 6 neni 23 dhe konkretizohen në vendimin përkatës të dekanit pasi ky i fundit shqyrton me kujdes Analizën Mësimore të DTA, Raportin e Analizës Mësimore të FBU dhe të Raportit vjetor të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave. Sipas dokumentit të dorëzuar nr 52.2; 52.3; 52.4.</p> <p>GVJ mendon që përmbajtja e PS duhet të përmirësohet: në drejtim të zvogëlimit të numrit të disiplinave ose moduleve, nëpërmjet grupimit të moduleve të afërta në të cilat është konstatuar edhe përsëritje të temave që trajtojnë. Kjo është vënë re në modulet me detyrim të lëndëve të tipologjisë A të formimit bazë Biologji, Gjenetikë dhe Mikrobiologji e përgjithëshme. E njëjta gjë është edhe për modulet Kimia e ushqimit, Biokimia, Ushqimi dhe të ushqyerit tek njeriu. Rekomandojmë të shikohet mundësia e integritit dhe kombinimit të tyre sepse trajtojnë pothuaj elemente të njëjtë. Sygjerohet që të shihet mundësia e grupimit të tyre në një disiplinë të vetme. Në këtë mënyrë pakësohet dhe numri i disiplinave (30 module teorike mendojmë se janë shumë, ose të eliminohen temat që përsëriten në këto module sepse në mënyrë artificiale rritet ngarkesa e studentit). Gjithashtu, duhet të kenë më shumë module që lidhen me fushën e Inxhinierisë, meqë studentët në fund fitojnë titull Inxhinier. Mendojmë se moduli Kontrolli Automatik, që është lëndë kryesore në fushën e Inxhinierisë është futur me vonesë në PS dhe duhet të kalojë në lëndë bazë jo me zgjedhje. Mendime për përmirësim të PS jepen edhe në kriteret e mëposhtme.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		✓		

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa në programin e studimit të ciklit të parë BCH në IAU profile TAU, është i organizuar në tre vite akademike. Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti është 60 kredite. Sipas dokumentit të dorëzuar nr 7 neni 3 rregullore e programit të studimit, orët fizike të zhvilluara janë 625 orë leksion 450 orë seminare. GVJ konstaton se ka mos përputhje me ngarkesën të treguar sipas dokumentit të dorëzuar 14. 2 kurrikula 2018-2019. Ku tregohet se orët fizike për këtë PS janë: 795 orë leksione; 855 orë seminare/ushtrime ose laboratore; praktika profesionale 90 orë, provim formimi 60 orë. Në total për tre vite 1800 orë për 180 kredite.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Programi e studimit të ciklit të parë BCH në IAU profile TAU ka përmbajtje që u ofron studentëve njohuritë bazë që janë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të studimit, dhe t'u përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Pas përfundimit të studimeve të ciklit të parë, studentët anketohen në lidhje me punësimin e tyre, një pjesë e vogël 5%rezulton se kanë gjetur punë në fushën e studimit të tyre. Dhe pjesa më e madhe 80% vazhdon ciklin e dytë të studimit. Dokumenti i dorëzuar nr. 17.1.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional.</p>	<p>Programi i studimit të diplomës së nivelit të parë BCH në IAU profile TAU, zhvillohet në tre viteve akademike, gjashtë semestre formimi akademik dhe në fund të vitit të tretë provimi formimi për diplomim. Çdo vit, koordinatori i programit harton një raport në lidhje me ecurinë e programit të studimit ku paraqiten arritjet e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxenit dhe aftësimi profesional. GVJ nga shqyrtimi i dokumenteve sidomos planeve mësimore të dy viteve të fundit, konstaton që në listën e 12 moduleve me zgjedhje janë tre disiplina të rëndësishme për formimin profesional dhe arritjen e objektivave të të nxënit: Teknologjia e drithërave dhe produkteve të tyre, Teknologjia e vajit, Teknologjitë e pas vjeljes. Mendojmë që këto module të zhvillohen si disiplina të detyrueshme. Gjithashtu në modulet me zgjedhje është dhe disiplina: Paisjet matëse dhe të kontrollit, e cila mund të zhvillohet si lëndë e detyruar në Bachelor ose më mirë në Programin Master Shkencor IAU-TAU duke e përmirësuar kurrikulën e këtij programi me lëndë të karakterit inxhinierik. Dokumentit të dorëzuar 14. 2 kurrikula 2018-2019</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Në RVB thuhet “<i>Programi i studimit të diplomës së nivelit të parë BCH në IAU profile TAU, ka strukturë në përputhje me profilin e studimeve BCH ku orët fizike të zhvilluara janë si më poshtë: 625 orë leksione; 450 orë seminare, ushtrime, punë laborator, 375 orëteza e diplomes, pergatitja e një materiali të shkruar në fund të kryerjes së saj dhe provim formimi që përmbyll ciklin e studimeve të këtij niveli.</i>”</p>

	<p>Nga GVJ konstatohet se këto të dhëna janë të gabuara, në fakt ngarkesa është: orët fizike për këtë PS janë: 795 orë leksione; 855 ore seminare/ushtrime ose laboratore; praktika profesionale 90 orë, provim formimi 60 orë. Në total për tre vite 1800 orë për 180 kredite. Raporti teori/ praktikë është 0,9:1 pra afërsisht 1;1. Konstatohet që programi studimit të ciklit të parë BCH në IAU profile TAU ka përputhshmëri me Programe analoge në Universitete Europiane, me të cilat FBU ka shkëmbime në kuadër të Erasmus+. Nga krahasimi më të njëjtin PS që zhvillohet në Universitetin e Molise, Itali rezulton që 88% e moduleve janë pothuajse ose krejtësisht të njëjta. Programi Italian i studimit ka 6 module të disiplinave me detyrim më pak se programi BCH në IAU profil TAU. Kjo sipas dokumentit të dorëzuar nr 14.8.1.</p> <p>Nga krahasimi me PS me Universitetin e Milanos rezulton se përputhshmëria e moduleve për të treja vitet, midis dy programeve të Studimit të ciklit të parë BCH në IAU profile TAU në FBU dhe Universitetin e Milanos është 74%. Edhe në këtë rast PS BCH në IAU profil TAU në FBU ka më shumë module. Kjo tregohet sipas dokumentit të dorëzuar nr 14.8.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Konceptimi dhe përcaktimi i krediteve në FBU është ndërtuar në bazë të parimeve të Deklaratës së Bolonjës, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, me qëllim mundësimin e mobilitetit dhe të transferimit të krediteve nga njëri institucion i arsimit të lartë tek tjetri, brenda dhe jashtë vendit. Në llogaritjen e një krediti, FBU është mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe në VKM 41/2018. Një kredit është i barazvlershëm me 25 orë pune, nga të cilat orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të orëve mësimore vjetore. Në UBT me vendim senati është përcaktuar konvertimi i një krediti leksion/seminar/laborator/detyra, etj në orë fizike në auditor. Me këtë vendim është bërë një unifikim në shpërndarje të krediteve dhe ndihmon në mobilitetet e studentëve, të cilët kryejnë orë mësimore apo përgatitje diplome në Universitete të tjera me të cilat UBT/FBU ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e moduleve që realizohen në ciklin e parë të studimeve BCH përditësohen vazhdimisht në aspektin shkencor të përmbajtjes dhe në përputhje me legjislacionin përkatës. Disa syllabuse janë modifikuar në mënyrë të pjesshme, disa të tjera në mënyrë rrënjësore. Mënyra e përzgjedhjes dhe përdorimit të literaturës është një aspekt shumë i rëndësishëm i aktivitetit akademik. Literatura ndahet në disa kategori: literaturë bazë; literaturë plotësuese; literaturë e rekomanduar (dokumente të dorëzuar nr rendor 23-91 shembuj syllabus). Për të siguruar transmetimin sa më të mirë të njohurive bashkëkohore tek studentët, përzgjedhja e literaturës në FBU është bërë mbi bazën e përdorimit si tekste bazë të librave të botuar në shtëpi botuese, nga stafi akademik i Fakultetit. Në mbështetje të literaturës bazë të lëndëve të ndryshme sugjerohen edhe botime të specialitetit, të botuara nga universitetet perëndimorë. Në PS BCH në IAU me profil TAU, shumica e moduleve janë mbuluar me tekste mësimore në shqip.</p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi i studimit ciklit të parë BCH për plotësimin edhe më të mirë të kërkesave të studentëve gjatë zhvillimit dhe përmirësimit në vite ka krijuar mundësi për futjen e lëndëve me zgjedhje të drejtimit profesional në bazë të aftësive dhe preferencave të tyre. Mënyra e organizimit të ciklit të parë të studimeve është e përshtatshme për studentët të cilët në fund të këtij cikli studimi janë në gjendje të aktivizojnë dhe mbështesin procese të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë të zbatojnë sisteme dhe procese teknologjike për prodhimin e produkteve sipas standarteve të tregut dhe eksportit. Sipas dokumentit të dorëzuar nr 14.2 dhe 14.3 kurrikula e PS BCH</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>PS të ciklit të parë " BCH " ka përmbajtje që i pais studentët me njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimiti dhe u përgjigjet kërkesave me të cilat përballen studentët gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Gjatë tre viteve të studimit, studenti mer njohuri më të hollësishme në lidhje me shumë aspekte të teknologjisë (Ref: sillabuset e lëndëve), projektimin dhe zbatimin e proceseve teknologjike, hartimin dhe implementimin e sistemeve të sigurisë ushqimore etj. Që në hapjen e këtij programi studimi është realizuar një studim i tregut mbi nevojat e të rinjve për të thelluar njohuritë në këtë fushë. Gjithashtu programi studimit është formuar në mënyrë të tillë që garantojnë transferim të vazhduar dhe në zhvillim të njohurive tek studentët, nëpërmjet një gërshetimi ndër-lëndor.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Në përcaktimin e objektivave të formimit për programin e studimit të ciklit të parë, janë marrë në konsideratë qëndrimi i komunitetit, sidomos biznesit, duke dëgjuar zërin e tyre për kërkesat që ekonomia paraqet në krijimin e këtyre profesionistëve. Kështu objektivat e studimit mbështetën edhe në strukturën ekonomike të vendit që karakterizohet nga ndërmarrje të industrisë ushqimore. FBU bashkëpunon në mënyrë të vazhduar me biznesin. Bazuar dokumentit të dorëzuar nr 32.1 dhe 32.2. dhe 34.2 (listë biznesesh bashkëpunuese). Në funksion të nevojave për zhvillimin e procesit mësimor dhe realizimin e programit kërkimor e shkencor në fushën e ushqimit, palët në bashkëpunim me njëra tjetrën shprehin gadishmerinë që të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për realizimin e shërbimeve dhe ofrimin e konsulencës shkencore FBU ka pasur dhe ka si qëllim të vet përafrimin e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës. Shpërndarja e pyetësorëve në kompani të ndryshme të prodhimit, përpunimit dhe tregëtimit të ushqimit me kontakte të drejtpërdrejta me sipërmarrës individualë dhe me shoqata të tyre ka bërë të mundur përmirësimin e programit mësimor.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		✓		

**Standardi II.5**

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie në Programin e Studimit BCH përmbush kërkesat ligjore në fuqi pasi gjithë stafi duhet ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Rekrutimi i stafit akademik kryhet në përputhje me kategoritë e personelit akademik sipas LAL 2015 neni 59, si dhe në përputhje me Statutin e UBT. (sipas dokumentit të dorëzuar nr 2 neni 36).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit BCH në TAU kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e moduleve mësimore të programit të studimit. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga departamenti, bazuar në nevojat e këtij të fundit, dhe miratohen nga Rektori. Gjithashtu performancë e PA vlerësohet periodikisht të paktën njëherë në vit nëpërmjet formularit të Performancës, sipas dokumentit 38.4 dhe 38.5. Në përbërje të stafit mësimdhënës janë 9 lektorë që mbajnë titullin “Profesor”, 6 lektorë mbajnë titullin ”Profesor i Asociuar”, 16 lektorë mbajnë gradën “Doktori i Shkencave” dhe 7 asistentë lektorë të angazhuar në program janë MSc. Kjo sipas dokumentit nr 24 (tabelë e stafit akademik programi bachelor). Të gjithë lektorët bëjnë përpjekje të vazhdueshme për kualifikimin e tyre, duke zhvilluar punë kërkimore shkencore, botojnë artikuj dhe marrin pjesë në trajnime, projekte e konferenca të ndryshme shkencore, duke rritur kështu kualifikimin shkencor për Programin e Studimit. Bazuar në dokumentin 43.1.(tabelë kualifikimi dhe kërkim shkencor të stafit..)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>PA i cili mbulon programin e studimit ciklit të parë ka një background në përputhje me specifikën e modulit të cilin ai mbulon si dhe është në kualifikim të vazhdueshëm. FBU ka kushtuar rëndësi të veçantë cilësisë së stafit drejtues mësimdhënës dhe mbështetës. Synohet garantimi i një shërbimi cilësor bashkëkohor ndaj studentëve nga të gjitha njësitë përbërëse. Kujdesi fillon me procesin e vendosjes së kriterëve për të kandiduar në postet drejtuese, si dhe për rekrutimin e stafit mësimdhënës efektiv dhe të ftuar, mbështetës dhe administrative. CV akademike të stafit të cilat dorëzohen çdo vit pranëdepartamentit tregojnë edhe dinamikën e kualifikimeve në vazhdimësi. Dokumentat me nr rendor 107-170.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Pjesë e rëndësishme e aktiviteteve akademike të studentëve janë vizitat studimore në institucione publike e qeveritare, qendra kërkimore-shkencore, universitete dhe qendra të mëdha akademike etj. Në këtë kuadër janë realizuar vizita në stabilimente prodhuese dhe kompani të prodhimit dhe përpunimit të ushqimit në Tiranë, Shkodër, Fier, Lezhë, Korçë, Gjorokastër, etj. FBU bashkëpunon ngushtësisht me agjenci qeveritare, Univeristet homologe brenda dhe jashtë vendit, shoqata që operojnë në fushën e biznesit. Praktika profesionale zhvillohet në semestrin e fundit të vitit të tretë dhe udhëhiqet dhe organizohet nga të paktën tre anëtarë të PA.</p>

	Dokumenti dorëzuar nr 7 neni 18 pika c dhe dokumenti dorëzuar nr 35 dhe 35.1. Rregullorja e studimeve të ciklit të parë BCH përcakton se diplomimi në këtë cikël realizohet me provim formimi. Studenti ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë dhe udhëheqësin e tij, kur mesatarja e notave të tre-viteve të studimit është 8 e lart. Sipas Dokumentit dorëzuar nr 7 neni 19 pika c.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjedisëve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Stafi i FBU sipas kategorizimeve të vendit të punës është: PA efektiv, Personel ndihmës akademik, i cili ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor dhe ndihmës akademik me karakter administrative. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor (laborante, teknike) ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Përkatesisht FBU ka në përbërje 12 staf ndihmës akademik, 10 janë ndihmës akademik mësimor dhe dy ndihmës akademik administrative. Sipas Dokumentit dorëzuar nr 22.3. Gjithashtu në mbështetje të programit të studimit angazhohet edhe stafi ndihmës akademik i fakulteteve të tjera të disiplinave të formimit bazë në PS.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	






### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>GVJ nga shqyrimi i dokumentave dhe nga takimi me studentët konstatoi se FBU përdor metodat inovative të mësimdhënies. Dokumenti dorëzuar nr 39. E-learning është një prej tyre që përfshin format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimimit me ndihmën e paisjeve elektronike. Shpesh leksionet e shtypura janë shoqëruar ose zëvendësuar me versione elektronike si dokumente, prezantime poëerpoint, etj. Në procesin e mësimdhënies janë përdorur teknikat audiovizive, ka disiplina ku këto teknika kanë përparësi. Për të bërë të mundur realizimin e këtyre teknikave, në department janë ngritur disa auditorë dhe laboratorë të pajisur me kompjutera, retroprojektorë, etj. Metodrat e mësimimit elektronik ndihmojnë stafet akademike të krijojnë forma më të qëndrueshme dhe të standardizuara të shpërndarjes së të nxënit, por nga takimi me studentët jo të gjithë dhe gjithmonë preferojnë këto metoda, prandaj krahas këtyre përdoret dhe shpjegimi me shkrim në tabelë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Monitorimi për mësimdhënien kryhet në nivel Fakulteti nga Dekanati dhe Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Kjo sipas dokumentit të dorëzuar nr 14.6 neni 15 pika 6 dhe dokumentit nr 16.8 pika 3.3. Nga takime me studentët, këto kontrolle janë të rralla, më shpesh bëhen për të evidentuar kryerjen e mësimimit dhe respektimin kohor të orëve mësimore dhe shumë pak janë kontrolle tematike për të parë zhvillimin cilësor të mësimimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Institucioni garanton edhe marrjen e vlerësimit nga ana e studentëve për metodat e mësimdhënies nëpërmjet organizimit të anketimeve. Dokumenti dorëzuar nr 40,40.1 Në fund të çdo semestri studentët bëhen pjesë e anketimeve, në të cilat ata vlerësojnë procesin në gjithë parametrat e tij. Rezultatet e anketimeve përpunohen nga Zv. Dekani për mësimin dhe pasqyrohen në Raportin e Analizës Vjetore Mësimore. Dokumenti nr 38.1 dhe 38.3.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Grupi i punës për përpunimin e të dhënave të anketimeve mbledh, analizon informacionet e anketimit dhe ja dorëzon Zv. dekanit për mësimin, i cili bën interpretimin dhe përfshin në raport e analizes vjetore rezultatet e anketimit dhe ngre problematikat në rastet kur ka të tilla. Në Raportin e Analizës vjetore për mësimin dhe kërkimin shkencor pasqyrohen të dhënat e anketimeve dhe të monitorimit nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë. Dokumenti dorëzuar nr 38.1 dhe 38.3.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik</p>	<p>Fakulteti dhe DTAU nxit personelin akademik për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Një rast i promovimit të praktikave të mira është përfshirja në projektin NETCHEM, nëpërmjet së cilit stafi akademik është trajnuar në mënyrë të vazhdueshme për</p>

për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	metodat innovative të mësimdhënies në përputhje me profilin e programit të studimit. Projekte të tjera që ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim janë: ERASMUS ku shkëmbimi i stafit për mësimdhënie apo trainim ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin të cilësisë së aktivitetit mësimor shkencor të stafit akademik. Lëvizjet e stafit të PA në këtë drejtim pasqyrohen në dokumentin e dorëzuar nr 43.1 dhe 43.2.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e kryesore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në këtë PS janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit, vizitat në institucione shkencore, për të njohur metodat dhe aparaturat analitike të sofistikuara që mungojnë në auditor. Orët fizike për secilën formë të mësimdhënies janë: 795 orë leksion; 855 orë seminare, ushtrime, punë laborator. Provimi i formimit ose diplome 60 orë. Një formë efektive e mësimdhënies dhe nxënies së njohurive është edhe praktika profesionale pranë subjekteve agropërpunuese e cila është modul i veçantë i PS me 90 orë mësimore, 9 kredite, që zhillohet në semestrin e fundit ku studenti njihet me teknologjitë konkrete, por edhe shikon zbatimin e njohurive në praktikë. Këto të dhëna sipas dokumentave të dorëzuar 14.2 (kurrikula PS 2018-19) dhe dokumentit nr 14.5. GVJ konstatoi që laboratorët janë pjesë e veprimtarisë formuese për 50 % të lëndëve që zhvillon programi i studimit BCH në IAU me profil TAU, ato zhvillohen në grupe prej 20 studentësh.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Programi Studimit dhe stafi akademik mundohet të sigurojë një raport të drejtë mes formimit teorik dhe formimit praktik, ky raport për PS në tërësi nuk është 1:1; më shumë janë orët leksion dhe seminare, në krahasim me orët e seancave laboratorike dhe ushtrime. Për disiplina të veçanta janë parashikuar forma të ndryshme të veprimtarive formuese si detyra, projekte, apo edhe praktika të lëndës me qëllimin e aftësimit të studentit në zbatime praktike të njohurive teorike të dhëna në leksione. Dokumenti dorëzuar 14.5. Një pjesë e tyre bëhen nën asistencën e pedagogut, siç janë ushtrimet apo laboratorët, ndërsa një pjesë tjetër zhvillohen si punime të pavarura të studentit nën konsulencën e pedagogut, siç janë detyrat, projekte. Për këto aktivitete formuese studenti arrin të sigurojë sipas performancës deri në 40% të vlerësimit total. Dokumenti dorëzuar nr 14.5.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson	FBU mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në

<p>përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. Kualifikimi në vazhdimësi i stafit të ri pedagogjik është një nga prioritetet për faktin se moshë e personelit në fakultet është e re dhe nevoja për kualifikim specifik, është e lartë. Mobiliteti i stafit akademik për qëllime specializimi për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, në kuadër të marrveshjeve me institucione arsimore, qendra kërkimi jashë vendit dhe ri-integrimi i tyre në rradhët e personelit akademik është një formë për rritjen e kapaciteteve akademike dhe nivelit të profesionalizmit. Dokumenti dorëzuar nr 43.1</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Rekrutimi i personelit synon përzgjedhjen e personelit akademik të kualifikuar dhe kompetent në fushën e tij. Për këtë qëllim është ndjekur procedura e shpalljes publike të pozicionit të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike si dhe në website e UBT. Dokumenti dorëzuar nr 11.1 dhe 44.2/4/5. Oferta e punës dhe kriteret e punësimit. Kriteret janë specifike dhe vlerësohen kandidatët që kanë një background në lidhje me profilin e mësimdhënies që kërkohet si dhe experiencë pedagogjike; përparësi kanë kandidatët që janë kualifikuar jashtë vendit. Mënyra e vlerësimit të tyre bëhet publike në çdo konkurs. Dokumenti dorëzuar nr 44.8.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Një nga format e përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe të elementëve të procesit mësimor, është bërë e mundur nëpërmjet anketimeve. Studentët përfshihen në këtë proces duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve, në fund të çdo semestri për modulet që mbyllin. Dokumenti dorëzuar nr 40. Në shpërndarjen/grumbullimin e pyetësorëve si dhe në nxjerrjen e tabelave përmbledhëse angazhohen edhe përfaqësues të “Këshillit studentor” të FBU. Dokumenti dorëzuar nr 65. Rezultatet e anketimit përfshihen në Raportin Mësimor të çdo viti, dhe diskutohet për përmirësimet e mundëshme.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Bazuar në kualifikimet sipas mobiliteteve të stafit në universitetet e tjera jashtë vendit, duke sjellë eksperiencat bashkëkohore të mësimdhënies, por edhe në përgjigjet e anketimeve dhe pyetësorëve (të kyer si më sipër në kriterin 5), personeli akademik reflekton dhe përdor metodat e reja në leksione e seminare. Dokumenti dorëzuar nr 40 pika 1 dhe 4. Të tilla si metodat interaktive të të menduarit kritik, ku kërkohet pjesëmarrja më e gjerë dhe diskutimi nga ana e studentëve. Në këtë qëllim stafi akademik e ka reflektuar këtë në rritjen e masës së vlerësimit gjatë vitit përkundrejt notës finale, deri në 40%. Dokumenti dorëzuar nr 14.5. Kjo gjë ka inkurajuar studentet që të jenë me aktive gjatë kohës së mësimit, të thellojnë arsyetimin kritik dhe aftësinë për të diskutuar, duke u përgatitur më mirë për tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Mbështetur në metodat interaktive të mësimdhënies (si në kriterin më sipër kriterin 6) ku mundohet të rritet aktivizimi i studentëve në procesin mësimor duke shprehur idetë dhe mendimet e tyre, realizohet njëkohësisht dhe pjesërisht sensi i autonomisë së veprimit tek studentit. Kjo ndikon në përfshirjen e më shumë</p>

	studenteve në kërkimet shkencore (dokumenti dorëzuar nr 43.7 dhe 73) dhe në vendimarrje.(dokumenti dorëzuar nr 65)..			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				√

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Programi i Studimit BCH IAU profili TAU zhvillon aktivitetin e tij mësimor dhe shkencor në mjediset e Godinës së Laboratorit të Kimisë, Bibliotekës së UBT, Kantina e Verës dhe Qendra e Kërkimit të Ushqimit me sipërfaqe të shfrytëzueshme ndërtimi rreth 5454 m<sup>2</sup>. Kjo tregohet në dokumentin nr. 42.1, Të dhënat për infrastrukturën BCH TAU, ku për çdo objekt të shfrytëzuar nga Fakulteti janë treguar vendodhja, kodi, gjatësia, gjerësia dhe sipërfaqja, shumë e detajuar. Në këto ambiente përfshihen auditorë mësimi, ambiente për laboratorë, ambiente për personelin akademik, ambiente për personelin administrativ, ambiente teknike, ambiente për bibliotekën e universitetit, disa salla konferencash apo leksionesh të pajisura me teknikë audiovizive, disa salla kompjuterësh dhe mjedise të pajisuar me mjete audiovizive. Sipas RVB, FBU plotëson normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme prej 3,8–4.m<sup>2</sup>/student (minimumi) dhe 7.5–8. m<sup>2</sup>/student (maksimumi) të përcaktuara nga standartet shtetërore të cilësisë. Hapësira totale e vënë në dispozicion për procesin mësimor kërkimor është 4.4 m<sup>2</sup>/ student. Këto normativa plotësohen edhe në bashkërendim me ambientet e programeve të tjera të studimit apo edhe fakulteteve të tjera. Megjithëse shumë prej ambienteve janë jo shumë të mëdha për të mirëpritur 20/25 studentë. Kjo shprehet edhe në raportin 2017-2018: Mbetet problem hapësira e kufizuar e ambjentëve të mësimdhënies, në veçanti e laboratorëve, të cilët kanë sipërfaqe të vogla në krahasim me numrin e studentëve në një grup, mesatarisht 20/25</p> <p>Mirëmbajtja e ambienteve kryhet në mënyrë të përditëshme nga stafi i shërbimeve numri i të cilëve është 5 në FBU dhe bëjnë një shpërndarje të punës në raport me sipërfaqen në mënyrë që të jetë e mbuluar plotësisht. Përmirësimi i vazhdueshëm i këtyre hapësirave bëhet në përputhje me kërkesat e studentëve dhe personelit akademik, rezultuar nga procesi i anketimit.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Mjediset për zhvillimin e procesit mësimor janë sallat e leksioneve, seminareve, seancave laboratorike si edhe linjat pilot për kryerjen e praktikave profesionale. Këto linja kanë sipërfaqe të mjaftueshme dhe aparaturat e nevojshme për aplikimin e nohurive teorike në përpunimin dhe fabrikimin e disa produkteve agroushqimore. Dokumenti dorëzuar nr 60.1- 60.9. Nga vizita e GVJ në institucion u vu re se: sallat e leksioneve dhe seminareve janë të paisura kryesisht me tavolina dhe karrige me kapacitet pothuaj në përputhje me numrin e studenteve që

	<p>kanë kurset nga viti i parë deri viti i tretë. Në disa prej tyre janë instaluar aparatet e retroprojektimit. Numri i studentëve në grupin mësimor është në përputhje me VKM 41 përkatësisht deri në 100 studentë për zhvillimin e leksioneve dhe 25 student për çdo grup seminaresh. Jo të gjitha sallat janë pajisur me kondicioner për të krijuar kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të mësimin, si një nga problematikat kryesore rezultuar nga anketimi studentëve. Gjithashtu laboratorët janë pajisur me pajisje, sipas specifikës së secilit laborator por disa kanë siperfaqe të vogël për grupe laboratorit me 20-25 studentë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Interneti në kampus realizohet nëpërmjet rrjetit fish LAN dhe wireless "Campus UBT" dhe është i aksesueshëm nga stafi akademik dhe nga studentet nga çdo laptop dhe smartphone dhe kompjuter. Biblioteka e re (FEA-s) ka një kapacitet rreth 100 vendesh dhe gjenden të instaluar rreth 12 kompjutera të lidhura me internetin dhe funksion sipas fondit online.katalogu on-line, për kërkime literature për projekte kursi dhe .punë të pavarur, Dokumenti i dorëzuar nr 45.5.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB: Libraria Universitare shërben dhe plotëson nevojat bazë për tekstet e domosdoshëm mësimorë të botuara nga shtëpi botuese në vend, cikle të leksioneve që secili pedagog përgatit për modulën përkatës. Në fillim të çdo viti akademik secili nga pedagogët dorëzon pranë Librarisë Universitare materialin bazë për modulën që zhvillon Studentëve u vihet në dispozicion edhe materiale të tjera të përkthyer në shqip, leksione të shkruara, prezantime në poëer-point, të cilat shpërndahen në format elektronike (email), ose shfaqen në site-n e pedagogut, ose si kopje e printuar. Këto të dhëna janë dhe në dokumentat e dorëzuar 42.5; nr 45.1 materiale didaktike për PS dhe dokumenti dorëzuar nr 45.3 (libraria elektronike).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Sipas RVB stafi akademik, ai ndihmës dhe studentët shfrytëzojnë Bibliotekën Shkencore "Mentor Permeti". Kjo bibliotekë ka në dispozicion 5 salla studimi, ndër të cilat dy salla studimi janë të pajisura me kompjutera, ku studentët mund të shfrytëzojnë literaturën on line ose të përpusojnë detyra e projekte. Sipas të dhenave të institucionit, këto dy salla frekuentohen nga 2300 studentë në muaj. Këto të dhëna janë në dokumentin e dorëzuar nr 42.5 Në pesë vitet e fundit Biblioteka ka marrë një fond të librit tekniko shkencor për Fakultetin e Bioteknologjisë &amp; Ushqimit prej 111 titujsh prej të cilëve 44 janë në gjuhën shqipe dhe 67 në gjuhë të huaj. Kjo e dhënë është sipas RVB, dhe dokumentit të dorëzuar nr 45.2(evidenca e bibliotekës për FBU). GVJ i këtij programi studimi nuk pati mundësinë të kontaktojë me punonjësit e bibliotekës. Ato nuk ndodheshin aty edhe pse institucioni ishte lajmëruar më parë për vizitën sipas agjendes me orare fikse, zyra dhe grupet e takimit. Pavaresisht nga kjo ambjentet e sallat e bibliotekës janë vizituar nga një prej anëtarëve të GVJ (i cili është njëkohësisht anëtar i GVJ të PS Master në IAU profil TAU, gjatë vizitës në kuadër të këtij PS)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Përdorimi i librarive on-line nga stafi akademik dhe studentët në funksion të procesit mësimor është një përparësi, (stafi akademik plotëson boshllëkun për sigurimin e periodikëve në fushat e kërkimit shkencor, ndërsa studentët mund të shkarkojnë materialet nëpërmjet teknologjisë smartphone). Biblioteka Shkencore disponon koleksion periodikësh shkencorë në fusha të ndryshme, në shqip dhe në gjuhë të</p>

	<p>huaj, një pjesë e të cilëve janë siguruar përmes abonimit vjetor. Biblioteka ofron informacione online nga burimet elektronike (me abonim ose free nga projekte të ndryshme, aktualisht Research4life me pesë programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI, GOALI). Kjo sipas dokumentit të dorëzuar nr 45.5 (katalogu online, libraria elektronike). Kjo është krijuar në kuadër të Projektit Erasmus+ "Library Network Support Services". Nëpërmjet rrjetit akademik shqiptar (RASH) TEEAL, studentët kanë akses për kërkimin dhe shkarkimin e litaraturave të huaja dhe shqiptare. Ky akses ju ofrohet të gjithë studentëve të FBU-së të cilët janë të pajisur me një llogari nëpërmjet sistemit ESSE3. Ky aplikacion është pa pagesë. Sipas dokumentit të dorëzuar nr 39.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, në dispozicion të këtij Programi janë 4 godina, në të cilën përfshihen 9 salla leksionesh, 18 laboratorë, 5 linja eksperimentale të teknologjisë së përpunimit ushqimor. Në dokumentin 42.1 të dhëna për infrastrukturën për të gjithë FBU: Laboratore mësimore 748.8 m<sup>2</sup>, Salla leksionesh 883.74 m<sup>2</sup>, Hapësira linja pilot përpunimi 234.75 m<sup>2</sup>, Hapësira linja e prodhimit të verës / pije 300.34 m<sup>2</sup>, Hapësira ndihmëse dhe shërbime 727.93 m<sup>2</sup>, Zyra 756.34 m<sup>2</sup>, Biblioteka 1300 m<sup>2</sup>. Gjithsej 5046.38 m<sup>2</sup>.</p> <p>Në dokumentin nr. 42.2, Raporti mesatar sipërfaqe/student është 4,4m<sup>2</sup> për programin e studimit Bachelor me profil TAU, i cili ka 404 student. Është Brenda standardeve, por në disa laboratore veçmas sipërfaqja është e vogël për grupe me 20-25 studentë.</p> <p>Në dokumentat 42.1 dhe 42.2, tregohet se FBU ka 21 salla Laboratori, por tregohet se ky program shfrytëzon 18 laboratore. Nga një sipërfaqe totale 5046 m<sup>2</sup> që i takon programit të studimit, 1280 m<sup>2</sup> (25,4%) janë në dispozicion vetëm për ambiente laboratorike dhe zhvillimit të praktikave mësimore.</p> <p>Për realizimin e seancave eksperimentale laboratorike dhe punëve praktike, laboratorët e FBU-së janë të pajisura me mjetet dhe aparaturat sipas specifikave të programit, të cilat mundësojnë realizimin e seancave praktike. Për këtë qëllim përdoren edhe linjat e qumështit, të vajit të ullirit, qendra studimore e verës. Sipas dokumenteve të dorëzuar 60.1- 60.26 (inventare)</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Metoda e-learning është një metodë inovative në të cilën forma e të mësuarit dhe mësimdhënies zhvillohen nëpërmjet pajisjeve elektronike. (shiko standart III 1. Kriteri 1). Dokumenti dorëzuar nr 39.</p> <p>Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor edhe platformen on-line Google Site; është një tjetër aplikacion online që ndihmon në krijimin e një projekti në ëeb ose të një website. Me anë të këtij aplikacioni mund të mblidhen lehtësisht një sërë informacionesh në një site të vetëm. Dokumenti dorëzuar nr 47.5</p> <p>Moodle LMS (Learning management system) janë aplikacione në web, të cilat mundësojnë menaxhimin e materialit mësimor dhe administrimin e procesit mësimor. Një prej tyre është MOODLE, i njohur edhe si Mjedisi Virtual i të Mësuarit (Virtual Learning Environment).</p>

	Gjithashtu FBU realizon trajnime të stafit akademik nëpërmjet projekteve: Projektit Netchem (ICT Networking for Overcoming Technical and Social Barriers in Instrumental Analytical Chemistry education), dhe TEMPUS-JPHES, "Zhvillimi i njohurisë për informacionin për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe një ekonomi të bazuar mbi dijen në vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas Dokumenti dorëzuar nr 43.6			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Sipas RVB, por edhe dokumenteve dhe takimeve gjate vizites në institucion me punonjesit e zyrës ZSS: Komunikimi i brendshëm ndërmjet stafit akademik, studenteve dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet platformes esse3. Përkatesisht pedagogu dhe student kanë gjithësecili një account personal në esse3. Kjo edhe sipas dokumentave të dorëzuar nr 47.1 dhe 47.3. Çdo veprimtari e pedagogut që ka lidhje me studentin (plotësimi i pikëve gjatë vitit, shpallja e datës së provimeve, vendosja e notës) bën të mundur dërgimin e një emaili lajmërues në account-in e studentit, i cili në kohë reale merr informacione në lidhje me procesin mësimor. Gjithashtu çdo pedagog disponon një site personal në faqen zyrtare të UBT-së në të cilin bën transparent Syllabusin për modul in/et që mbulon si dhe leksione të ndryshme. Ky site është i arritshëm nga të gjithë. Dokumenti dorëzuar nr 47.2			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Stafi akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. Në programin e studimit të ciklit të parë BCH në IAU, profile TAU, perfundimi i studimeve realizohet nëpërmjet provimit të formimit. Programi i provimit të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore, që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga personeli akademik i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit. Programi shpallet, në website-in e FBU-së dhe u bëhet i ditur studentëve Dokumenti dorëzuar nr 7 neni 21. Studenti ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë dhe udhëheqësin e tij, kur mesatarja e notave të tre-viteve të studimit është 8 e lart. Ai mund të propozojë edhe vetë një tezë tjetër diplome së bashku me udhëheqësin përkatës. DTA shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i bashkërenduar me kushtet dhe mundësitë e departamentit. Dokumenti dorëzuar nr 7 neni 19 pika c.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies,

Këtë rol në UBT e kryejnë disa struktura ose zyrave në përbërje të Rektoratit:

<p>koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, sipas rregullores në dokumentin e dorëzuar nr 12-13. Zyra e Studimeve dhe Studentëve sipas rregullores në dokumentin e dorëzuar nr 9.</p> <p>Të cilat funksionojnë në përputhje me Udhëzimi nr.27, Dt.29.12.2017: kjo sipas dokumentit të dorëzuar nr 2- Statuti i IAL pika 3, g. dhe koordinimit të veprimtarisë së tyre me njësitë kryesore në procesin e kontrollit dhe përmirësimit të cilësisë. kjo sipas dokumentit të dorëzuar nr 8. (Manuali Cilësisë) pika 3.1, 10,11</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar çdo vit njësia kryesore, FBU, bën analizën e punës mësimore me kryefjalë cilësia e mësimdhënies. Për marrjen e këtij informacioni shfrytëzohen raporte të analizës mësimore të departamenteve edhe pyetsorët e realizuar me studentët.</p> <p>Kjo pasqyrohet në dokumentet e dorëzuar nr rendor 210,211 (analizat mësimore në FBU 2016-2017 dhe miratimi nga Dekanati). Gjithashtu në dokumentin e dorëzuar nr rendor 214,215 Analizat mësimore në FBU 2017-2018 dhe miratimi nga Dekanati). Në vazhdim dokumentin e dorëzuar nr rendor 216,217 Raporte nga KSC në FBU dhe nga dokumenti dorëzuar nr 38.1 Analiza mësimore DTA 2017-2018.</p> <p>DTA ploteson formularin e performances akademike ku një nga elementet është mësimdhënia dhe matet nëpërmjet ngarkesës që ka secili pedagog. Kjo sipas dokumentit të dorëzuar 38.5 template performance akademike.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ nga shqyrimi i dokumentave dhe nga takimi me studentët konstatoi se FBU përdor metodat inovative të mësimdhënies, E larning. E-learning është një prej tyre që përfshin format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimimit me ndihmën e paisjeve elektronike. Dokumenti dorëzuar nr 39. Gjithashtu përfshirja ne projektin Netchem ka bërë të mundur që stafi të trajnohet për metodat inovative të mësimdhënies sipas profilit të PS</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik i PS dhe personeli ndihmës bëjnë përpjekje të vazhdueshme për kualifikim, jo vetëm në procesin e mësimdhënies, por edhe atë të kërkimit shkencor. Një formë është mobiliteti i stafit akademik në kuadër të marrveshjeve me institucione arsimore, qendra kërkimi jashtë vendit dhe ri-integrimi i tyre në rradhët e personelit akademik për rritjen e kapaciteteve akademike dhe nivelit të profesionalizmit. Gjithashtu pjesëmarrja e stafit në shumë projekte. Kjo pasqyrohet ne dokumenti dorëzuar nr 43.1 dhe 43.2 (Levizje e stafit akademik) Nga ana tjetër angazhimi në veprimtarinë kërkimore-shkencore bën të mundur që personeli akademik dhe studentët të fitojnë aftësi për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të karrierës akademike dhe përmirësimit të procesit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të</p>	<p>Promovimi i stafit akademik për kryerjen e kualifikimeve të vazhdueshme, ka krijuar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri në cilësinë e mësimdhënies. FBU dhe DTA mbështet stafin nëpërmjet mobiliteteve në kuadër të Projekte me BE Erasmus + Project</p>



mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	NETCHEM. etj Kjo sipas dokumenti dorëzuar nr 43.1 dhe 43.2. Në dokumentin nr. 34.3 jepen Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit (Institucione të Arsimit të Lartë nga vende të ndryshme me të cilat FBU ka shkëmbim eksperiencë të stafit akademik dhe ndihmes.			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Për realizim të procesit mësimor vihen në dispozicion të gjitha mjediset e departamentit dhe fakultetit. Në fillim të çdo semestri shpallet orari mësimor në të cilin pasqyrohen mjediset ku do të zhvillohen leksionet, praktikat laboratorike, seminarët, etj. Në procesin mësimor angazhohet stafi akademik dhe stafi ndihmës mësimor – shkencor, i cili ka detyra të mirë përcaktuara në përshkrimin e punës, kjo sipas dokumentit të dorëzuar nr 22.2 dhe 22.3. Mbështetur në Rregulloren e studimeve por edhe sa më sipër synohet të realizohet me korektësi procesi mësimor. Kjo sipas dokumentit të dorëzuar nr 2 Statuti UBT neni 29,30,31,42. Dhe dokumentit të dorëzuar nr 6.1 Rregullore e brendëshmeDTA.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Sipas RVB <i>Janë bërë përpjekje të vazhdueshme nga personeli akademik në përmirësimin e metodave të reja të mësimdhënies por kjo ngelet kryesisht në nivel personal dhe nuk është se raportohen në njësinë bazë. Ndërsa metodat e reja dhe të përmirësuara të aplikuara gjatë seancave praktike dhe me praninë e stafit ndihmës akademik pasqyrohen në përmirësimin e programit mësimor në vitet në vazhdim.</i> GVJ konstaton se janë bërë disa përmirësime në kurrikulat ndër vite dhe mendon se këto ndryshime janë rrjedhojë e aplikimit dhe testimit të metodave të reja të mësimdhënies duke pasuruar programin mësimor me tema të reja bashkohore. Kjo pasqyrohet në dokumentin e dorëzuar nr 14.2 Kurrikula e PS 2018-2019 dhe në dokumentin e dorëzuar nr 14.3 Kurrikula e PS në vite 2014-2018. Gjithashtu ndryshimet dhe përmirësimin e kurrikulave pasqyrohen në dokumentat e dorëzuar nr 52.1- 52.4			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				√

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kontrolli i dijeve dhe aftësive profesionale shërbën për të vlerësuar progresin e studentit gjatë periudhës së studimit në auditor dhe studimit individual. Kontrolli i dijeve për çdo modul bëhet nëpërmjet formave të ndryshme si vlerësimi të punimit dhe prezantimit të detyrave të kursit, punëve në grup, kolegiumeve, pjesëmarrjes dhe aktivizimit në seminar dhe laborator. Ky vlerësim i vazhduar gjatë vitit plotësohet me vlerësimin në provimin përfundimtar. Mënyra e vlerësimit dhe ndarjes së pikëve për vlerësimet e sipër përmendura janë të shprehura në në syllabusin e

	<p>çdo moduli, "Elementet e vlerësimit" dokumentin e dorëzuar nr 14.1 pika 2.2- VKM nr 41, forma e syllabusit; dhe dokumentat e dorëzuar me numer rendor 23-91që tregojnë shembuj të sylabuseve përkatëse te moduleve te PS. Gjithashtu këto elemente të mënyrës dhe kriterëve të testimit dhe vlerësimit të njohurive pasqyrohen edhe tek Planet mësimore të çdo viti akademik, sipas dokumentit të dorëzuar nr 14.5.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët njihen me mënyrat e kriteret e vlerësimit në fillim të çdo semestri nga pedagogu -titullari i lëndës. Studenti njihet me metodologjinë e testimit gjatë vitit dhe merr informacion për formën e provimit përfundimtar (me shkrim apo me gojë); numrin e kontrolleve të ndërmjetme që do të realizojë gjatë vitit, të parashikuara në planin kalendar; tema të detyrave të kursit etj. Pedagogu i lëndës paraqet tek studentët, strukturën e lëndës, në bazë të syllabusit dhe planit kalendar, ku përfshihen temat që do të trajtohen gjatë modulit, mënyra e vlerësimit të studentëve. Ky është një detyrim i përcaktuar në rregulloren e FBU dhe të departamentit përgjegjës për programin e studimit. Dokumentit të dorëzuar nr 6, 6.1 dhe nr 7</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi përfundimtar për studentin për të treguar nivelin e njohurive të fituara kryhet me provim me shkrim ose shkrim dhe me gojë, sipas përshkrimit në Syllabusin përkatës dhe planet mësimorë. Gjatë vitit testimi kryhet nëpërmjet kolegiume, nëpërmjet punëve në grup, ose me anë të detyrës së kursit që studentit e ka përgatitur nga punë të pavarur individuale me mbështetjen e pedagogut. Provimi me shkrim mund të jetë me pyetje alternative ose shtjelluese. Tezat e provimit përfundimtar zakonisht riformulohen dhe çdo vit. Tezat e provimit final hartohen nga titullari i lëndës dhe firmosen nga përgjegjësi i departamentit. Sipas dokumentit të dorëzuar nr 71.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓
<p><b>Standardi III.6</b>  <b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b></p>				
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>			
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Sic është përmendur edhe në kriteret më sipër testimi i dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe kjo reflektohet me një përqindje të caktuar nga 30%-40% në vlerësimin përfundimtar të studentit. Kjo ndarje respektohet dhe është paraqitur në Syllabuset e çdo moduli, në seksionin "Elementet e vlerësimit" sipas dokumentit të dorëzuar nr 14.1 dhe dokumentin e dorëzuar nr 14.5 forma e syllabusit; dhe dokumentat e dorëzuar me numer rendor 23-91që tregojnë shembuj të sylabuseve përkatëse.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe nga takimet me studentë dhe pedagogë gjatë vizitës në institucion u konstatua që: Institucioni nuk aplikon sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat do të eliminojnë abuzimin në marrjen e notave të pa merituar. Keto sisteme rrisin transparencën në vlerësim dhe minimizojnë korrupsionin. Sic është përmendur dhe në kriteret më sipër testimi</p>			

	<p>i studenteve në vlerësimin përfundimtar bëhet me teza të printuara ose me fletore jo në formë elektronike. Tezat e provimit përfundimtar riformulohen dhe azhurnohen çdo vit. Ato përgatiten nga titullari i lëndës dhe firmosen nga përgjegjësi i departamentit. Dokumentit të dorëzuar nr 71.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi përfundimtar i njohurive të fituara gjatë procesit mësimor realizohet nga komisioni me të paktën dy pedagoge i caktuar nga Zv. Dekani për mësimin, ku njëri prej anëtarëve është edhe titullar i lëndës. Kjo në bazë të rregullores së njësisë bazë, dokumenti i dorëzuar nr 6 neni 61.a. Gjithashtu kjo pasqyrohet dhe në dokumentin e dorëzuar 72 Shembull proces verbal provimi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Nga takimi me studentë GVJ konstatoi qe: testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve në provimet me shkrim, nuk zhvillohet në mënyrë anonime, pra nuk bëhet me sekretim ose kodifikim. Kjo të pakten deri për provimet e semestri të parë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Rishikimi i vlerësimit të rezultati të provimit përfundimtar është një e drejtë e studentit, i cili pas shpalljes së rezultateve të provimeve, brenda 48 orëve mund të paraqitet para komisionit për të parë tezën dhe të sqarohet në lidhje me pikët si dhe përgjigjet e sakta. Kjo sipas dokumentit të dorëzuar nr 6 neni 64 pika b.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Siç e kemi përmendur në kriteret më sipër dhe argumentuar sipas dokumentave të dorëzuar të lartë përmendura, gjatë vitit, pedagogu i lëndës kryhen kolegiume të ndërmjetme apo dhe detyra të kursit. Është përgjegjësi e tij të mos lejojë kopjimin, ose plagjiaturën për detyrat e kursit. Në rast të kundert detyra e kursit nuk pranohet dhe studenti vlerësohet negativisht dhe pengohet të hyje ne provimin e radhës. Gjatë provimit përfundimtar, komisioni monitoron studentin për të shmangur kopjimet dhe e paraqet atë mbetës në rastet kur kapet duke kopjuar apo mashtruar me mjete jo të lejueshme. Kjo procedurë sipas dokumentit të dorëzuar nr 6 neni 58.b dhe nr 6 neni 64 pikat 1,3.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e provimeve hidhen në sistem brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda tetë ditëve kalendarike kur provimi është me shkrim, dokumenti i dorezuar nr 6 neni 64 pika a. Vlerësimi i provimeve bëhet me pikë të cilat konvertohen në notë, sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me dhjetë nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Notat nga pesë deri në dhjetë janë kaluese, sipas dokumentit të dorëzuar nr 6 neni 55 pika a.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Institucioni garanton të drejtat e studentit për tu njohur me vlerësimin individualisht dhe kërkesën për rishikim të vlerësimit. Kjo sipas dokumentit të dorëzuar nr 6 neni 64. Pas përfundimit të provimit dhe korrigjimit të tij, studentit nëpërmjet sistemit dhe account-it të tij ESSE3, i shfaqen pikët e marra në provimin përfundimtar, dhe menyra e vlerësimit gjate vitit.</p>

	Brenda 48 orëve nga hedhja e pikëve në sistem, studentit i jepet e drejta të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e provimit. Komisioni i provimit sqaron studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Kjo procedure GVJ ju sqarua edhe nga takimi me titullarin e zyres ZSS, dhe u verifikua duke parë shëmbull konkret të proces verbaleve të provimit.			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Në rast të ankimeve nga ana e studenëve për rezultatet e vlerësimit përfundimtar është komisioni i provimit që e shqyrton dhe jep përgjigje studentit. Kjo është përmendur në kriteret më sipër. Në rastet kur studenti nuk bindet ose ka paqartësi, ai ka të drejtë të ankimohet këtë vlerësim. Kontestimi bëhet me shkrim brenda 24 orëve drejtuar Dekanatit të fakultetit. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Dekani, mund të thërrasë për sqarime, përgjegjësin e departamentit përkatës, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Procedura e ndjekur është transparente dhe e rregullt. Dekani ka të drejtë të vlerësimin përfundimtar për të përcaktuar nëse ankesa është e drejtë apo jo dhe ti japi zgjidhjen përfundimtare. Kjo procedurë sipas dokumentit të dorëzuar nr 6 neni 65 pika a.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.

Programi i studimit të ciklit të parë BCH në IAU profili TAU, mundëson thellimin e njohurive pasi gjatë dy viteve të studimit, studenti do të marrë njohuri bazë në shkencat matematike, biologji, kimi informatike. Në vitin e dytë zhvillohen njohuri në lidhje me shumë aspekte të teknologjisë dhe zbatimin e proceseve teknologjike, në linjat pilot të përpunimit të qumështit, prodhimit të djathit, linja e prodhimit të verës, e përpunimit të mishit, fruta perime. Ndërsa teknologjinë e drithit, prodhimit të bukës dhe produkteve konditor dhe teknologjitë e vajit janë parashikuar lëndë me zgjedhje kështu nuk janë me detyrim për të gjithë studentët. Gjithashtu përveç teknologjive bazë të cilat shërbejnë për të zhvilluar në këtë mënyrë dhe aftësitë e tyre profesionale; studentët paisen me njohuri për implementimin e sistemeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Kjo pasqyrohet në kurrikulat e programit të studimit BCH sipas dokumentit të dorëzuar 14.2.

**Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).

Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, nëpërmjet moduleve bazë si informatika, statistika. Në shkencat humane ka module me detyrim: Ushqimi dhe të ushqyerit tek njeriu, Biokimia, dhe module me zgjedhje: Fiziologjia bimore, Fiziologjia shtazore. Kjo pasqyrohet në kurrikulat e programit të studimit BCH sipas

	<p>dokumentit të dorëzuar 14.2. FBU, në kuadër të bashkëpunimeve me projekte ka filluar të aplikojë dhe module të edukimit në distancë, që rrisin potencialin e informimit të studentëve dhe nivelin e fleksibilitetit të programeve të studimit. Mobiliteti i studentëve është një formë për të zhvilluar aftësi të reja, rritja e mundësisë për punësim si dhe fitimi i eksperiencave internacionale duke mundësuar komunikimin dhe ndërveprimin në gjuhë dhe kultura të tjera. Dokumenti dorëzuar nr 73 (Erasmus exchange student) si dhe dokumentave me numër rendor 314,315.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Aftësitë që fiton studenti janë elemente të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës si një shumatore e kontrollit të vazhduar. Elementët e kontrollit të vazhduar janë: diskutimi në seminare, angazhimi në praktikat laboratorike, koleqiumi, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar. Dokumente të dorëzuar 14.1 dhe 14.5</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Sipas përgjegjësiqe që ka personeli akademik referuar Manualit të Cilësisë të Institucionit, dokumenti i dorëzuar nr 8 pika 3,9; në fund të çdo moduli, pedagogu i lëndës bën përsëritje të të gjithë materialit, teorik dhe praktik, duke evidentuar çështjet më të rëndësishme. Gjithashtu ai orienton studentin në lidhje me testimin përfundimtar, mënyrën e organizimit të pyetjeve dhe informacione në lidhje me testimin final.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në ambjentet e FBU realizohen herë pas herë, orë të hapura mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë me tema specifike të cilat kanë interes për studentët dhe për publikun Ftohen profesorë të huaj ose të vendit që kanë akses me teknologjitë e reja inovative. Sipas dokumentit të dorëzuar nr 68 (leksione të hapura nga profesorë të ftuar)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Kompetenca e stafit akademik te moduleve te PS është garancia kryesore për të përcjellë tek studentët njohuri në mënyrë aplikative. Përveç kësaj departamenti ka në strukturë laboratore shkencore, të cilët ndihmojnë në realizimin e seancave laboratorike dhe linja pilot prodhimi që ndihmojnë studentin të zhvillojë njohuritë e marra në leksione. Dokumenti dorëzuar nr 60 1-10. Dokumenti dorëzuar nr 60. 17, 18, 19 (inventare te linjave të ndryshme pilot). Gjithashtu për të fabrikuar produkte të ndryshme ushqimore, GVJ gjatë ditëve të vizitës në institucion assistoi dhe degustoi djathë të njomë të prodhuar nga studentët në linjën pilot të përpunimit të qumështit dhe djathit</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>PA mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të caktuara. Format e përdorura janë: Mbledhja e Asamblesë së Fakultetit, ku diskutohen problematika të ndryshme në lidhje me programet mësimore, kërkimin shkencor, apo dhe problematika të tjera që mund të dalin nga pyetësorët e studentëve dhe stafit akademik Dokumenti dorëzuar nr 75, (thirrje e mbledhjes së Asamblesë) dhe dokumenti dorëzuar nr 76.1 76.2 (vendime të Asamblesë) Në këtë drejtim</p>

	kontribon edhe mbledhjet e Dekanati, ku shyrtohen për miratim Analizat vjetore të mësimit dhe kërkimit dhe shumë problematika të tjera që lidhen me mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Mbledhje Departamenti ku shqyrtohen dhe diskutohen Raportet Vjetore të Mësimit dhe Kërkimit, (dokumenti dorëzuar nr 62; 63) puna e GMK, referohen punimet ndërmjetëse dhe përfundimtare të Doktoraturës, diskutohen çështje të organizimit të punës shkencore dhe mësimdhënies të të gjitha programeve të studimit të Departamentit. Dokumenti dorëzuar nr 43.4, 43.5			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nëpërmjet veprimtarisë kërkimore-shkencore personeli akademik dhe studentët fitojnë aftësi për kërkime të pavarura. Personeli akademik, nxit idetë inovative të studentëve, në lidhje me teknologjitë e reja të prodhimit të produkteve ushqimore, duke ideuar apo projektuar produkte të reja, mbështetur në ato tradicionale autoktone. Personeli akademik mbështet dhe inkurajon zhvillimin e këtyre ideve inovative, të cilat diskutohen në Grupet Mësimore Kërkimore përkatëse, ku aprovohen dhe më pas zbatohen në linjat pilot. Dokumenti dorëzuar nr 43.4, 43.5			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Si më sipër në kriterin 8 në baze të propozimeve dhe ideve të diskutuara dhe aprovuara nga GMK, Institucioni, FBU mbështet financiarisht, (dokumenti dorëzuar nr 70) dhe vë në dispozicion të studentëve, pajisje laboratorike, linja pilot për prodhimin e produkteve të reja të propozuara prej tyre dhe të miratuara. Dokumentat e dorëzuar nr 60 (inventare linja pilot)			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik i DTAU përveç suportit maksimal që ju jep studentëve brenda FBU, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit si dhe biznese me të cilat bashkëpunon për realizimin e pjesës praktike eksperimentale të punimeve të diplomave nga ana e studentëve. Në dokumentin nr. 34.3 janë marrëveshjet e bashkëpunimit të UBT me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit (Institucione të Arsimit të Lartë nga vende të ndryshme në Europë, Azi, Kosovë dhe Shqipëri (44 marrëveshje), UBT ka marrëveshje me biznesit vendas dhe/ose të huaj (43 biznese) për të realizuar me sukses objektivat e lidhura me procesin e mësimdhënies në mënyrë cilësore. Ndërsa në dokumentin nr. 32.1 jepet Marrëveshja e Fakultetit FBU me institucionet, gjithsej 16			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				√

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin	FBU dhe DTAU harton procedurë të posaçme për provimin final para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. Për të patur

<p>final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>një performancë sa më të mirë në provimin final, studenti njihet me programin e provimit të formimit që në fillim të semestrit të fundit. Programi përmban tema që lidhen me modulet karakterizuese të PS, sic janë njohuritë për teknologjitë kryesore të agropëpunimit. Dokumenti dorëzuar nr 7 neni 21.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Sipas rregullores së PS dhe rregullores së FBU Programi i provimit të formimit hartohet nga personeli akademik i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit. Pedagogët titullarë të lëndëve karakterizuese që janë pjesë e programit të provimit të formimit, hartojnë pyetje forumese, të cilat i pasqyrojnë pranë përgjegjësit të departamentit. Ky harton një listë me pyetje të cilat përbëjnë programin orientues për provimin e formimit dhe këto ju bëhen të ditur studentëve. Kjo sipas dokumentit të dorëzuar nr 77. Programi shpallet, në website-in e fakultetit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas dokumentit të dorëzuar nr 6 neni 21 pika.c, (Rregullore e njësisë kryesore), për administrimin e provimit final caktohet dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Komisioni i posaçëm, i cili është i përbërë nga pedagogë të departamentit, të lëndëve që mbulon programi i provimit. Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat që përfshihen në programin e provimit. Komisioni përzgjedh pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe. Dokumenti dorëzuar nr 78( Shembull teza provim formimi në BCH)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Personeli akademik, i orienton studentët për seleksionimin e materialeve të provimit final, duke i ndihmuar dhe vënë në dispozicion materiale, informacione shtesë të nevojshme. Materialet studenti i gjen edhe në librarinë universitare ose në sistemin online. Dokumenti dorëzuar nr 6 neni 21 pika.c.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Programi i studimit BCH IAU profile TAU sipas kurrikulës dhe planeve mësimore finalizohet me provim formimi. Numri i Studentëve të cilët janë pjesë e këtij PS të ciklit të parë është i lartë, dhe për të përmbyllur të gjithë ciklin e studimeve ata paraqiten para komisionit të provimit. Nuk aplikohet mbrojtja e Diplomave Bachelor. Dokumenti dorëzuar nr 6 neni 21 pika.b.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>PS BCH IAU profile TAU parashikon mbylljen e ciklit të studimit me diplomë në rast se mesatarja e studentit për tre vitet e studimit është mbi notën 8. Meqenëse numri studentëve pjesë e programit të studimit të ciklit të parë është shumë i madh, për të përmbyllur studimet ata paraqiten para komisionit për të dhënë provimin final. Dokumenti dorëzuar nr 6 neni 21 pika.b</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të formimit i cili organizohet me gojë, studenti vlerësohet me notë sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Notat nga pesë deri në dhjetë janë kaluese. Kjo sipas rregullores se dokumentit dorëzuar nr 6 neni 55</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e</p>	<p>Pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet përkatëse të cilat ka studenti në baze të PS,( Dokumenti dorëzuar nr 6 neni 41 pika k dhe neni 92 pika.b) ai pajiset me diplome BCH në IAU me profil "TAU" të</p>

diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	firmosur nga Dekani dhe Rektori i UBT. Dokumenti dorëzuar nr 6 neni 41 pika k.1 Formati i diplomës që është shoqëruar me supplementin e diplomës është i paraqitur qartë në rregulloren përkatëse të programit të studimit. Dokumenti dorëzuar nr 6 neni 87.88 dhe Dokumenti dorëzuar 15.1 (diploma suplement TAU BCH)			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Bazuar në rregulloret përkatëse sipas Dokumentit dorëzuar nr 6 neni 103, në përfundim të studimeve, studentit me kërkesën e tij ka të drejtë të paiset me kopje të plotë zyrtare të PS. Afati kohor i vënies në dispozicion nga institucioni është përcaktuar po në këtë rregullore.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Bazuar në Rregulloren e FBU Dokumenti dorëzuar nr 6 neni 44, Institucioni ka për detyrë të mbajë në formë të shkruar dhe elektronike: regjistrin themeltar të studentëve; regjistrin e arritjeve akademike; regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. Regjistrat depozitohen në arkivat e shtetit, (sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat), ndërsa kopja e njësuar me origjinalin rruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Në bazë të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm u konstatua se FBU mbledh dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e plota të stafit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, të dhënat arkivohen dhe ruhen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Pagave dhe jo vetëm Drejtoria e Burimeve Njerëzore.</p> <p>GVB ka dorëzuar rregulloren e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, të miratuar në dhjetor 2018, (nr. 11), ku neni 4 shpreh se të dhënat e stafit arkivohen dhe ruhen pranë kësaj drejtorie. Të dhënat tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (nr. 23.1) tregojnë se në Departamentin e Teknologjisë Agroushqimore janë Profesor (1), Profesor i Asociuar (2), Lektor (4) dhe Asistent lektor (2). Gjithsej 9 numri i personelit Akademik.</p> <p>Në bazë të Raportit të Vlerësimit të brendshëm u konstatua se ruajta e dokumentacionit të personelit bëhet pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, zyrës së Burimeve Njerëzore. Personi përgjegjës administron dhe plotëson dokumentacionin personal të çdo punonjësi (librezën e punës), me anën e të cilit vërtetohet ekzistenca e marrëdhënieve të punës dhe vjetërsia në punë. Kjo është në përputhje me rregulloren e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, të miratuar në dhjetor 2018, (nr. 11), neni 6.</p> <p>Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e stafit akademik, duke pasuruar dosjet e tyre me dëshmitë e kualifikimeve dhe trajnime vetë tyre shkencore, në përputhje me rregulloren, neni 6. Pranë kësaj drejtorie gjendet dosja personale e stafit akademik sipas formatit të përcaktuar nga kjo drejtori. Formatit i dosjes personale të Stafit (dokumenti i dorëzuar nr. 44.1) përmban disa dokumenta që duhet të ketë çdo punonjës, por gjatë shqyrtimit të disa dosjeve u konstatuan parregullsi në lidhje me dokumentacionin, si mungesa e dokumentit të marrjes së titullit Doktor i Shkencave, Dëshmi penaliteti, Raportit mjekësor për aftësinë në punë, Kontrata e punës për këtë vit akademik. Sipas dokumentit nr. 11.2, Urdhër nr. 102 për paraqitjen e dëshmisë së penalitetit në dosjen për konkurim, tregon se ky dokument duhet të jetë në dosjen personale të personelit akademik. Në dokumentat nr. 44.6 dhe 44.7, paraqiten Kontrata e punës për personel Akademik FBU dhe Kontrata Pune Staf Ndihmës FBU, ku shpjegohen të drejtat dhe detyrat për çdo individ.</p> <p>Në bazë të raportit të Vlerësimit të Brendshëm në çdo fillim simestri Njësia bazë dhe Njësia kryesore përpilojnë organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër</p>

	<p>dhe vit akademik. Kjo paraqitet në dokumentin nr. 14.3 të dorëzuar, Kurrikula e PS në vitet 2014-2018. Kurrikula ka pësuar ndryshime nga viti 2014 deri në 2019, dhe procedura për ndryshimin e tyre tregohet në dokumentat nr. 52. 1 – 4. Në dokumentin nr. 52.1, Ndryshimi i Kurrikulës BSC 2014-2019, nuk cilësohet tek tabela Ndryshimet në programin e vitit akademik 2017-2018 tek 2018 – 2019, se moduli Biokimi &amp; Gjenetikë është ndarë në dy module Gjenetikë dhe Biokimi; është shtuar moduli Bioteknologji Ushqimore; Mikrobiologji e përgjithshme &amp; Ushqimore është ndarë në dy module Mikrobiologji e Përgjithshme dhe Mikrobiologji Ushqimore, të cilat ndikojnë përbëjnë jo vetëm 7% ndryshim. Dokumentat nr. 52. 2-4 paraqesin vetëm vendimet që janë marrë gjatë një mbledhje të anëtarëve të dekanatit. Sipas raportit të Vlerësimit të Brendshëm, njësia bazë përgatit në mënyrë paralele edhe listën e stafit ndihmës dhe administrative. Dokumenti i dorëzuar (nr. 23.2), paraqet tabelën e personelit ndihmës akademik, ku personeli ndihmës akademik përbëhet nga 3 specialist (Msc) dhe 1 laborant; ndërsa administrata e fakultetit përbëhet nga 1 administrator, 1 punëtor dhe 4 pastrues. Dokumenti (nr. 22.3) Lista e Stafit ndihmës akademik për programin e BCH TAU, nuk është për Bachelorin por për Masterin.</p> <p>CV e personelit ndihmës akademik dhe përshkrimi i punës për Departamentin Teknologji Agroushqimore, nuk janë dorëzuar të gjitha nga GVB, sepse në bazë të dokumentit (nr. 23.2) janë 4 punonjës, mungojnë të dhënat e dy punonjësve të fundit (M. R dhe A. B). Ndërsa për stafin ndihmës, pranë Qendrës së Kërkimit Ushqimore janë dorëzuar: Tek përshkrimi i punës së E. K, thuhet se është laborant, por nuk shpjegohet se për cilën fushë është përgjegjës. Gjithashtu, formati i përshkrimit të punës, nuk është i njëjtë për të gjithë stafin ndihmës akademik. Tek Përshkrimi i punës për stafin ndihmës, shpjegohen detyrat dhe angazhimin në realizimin e orëve laboratorike të cilët kujdesen edhe për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe pajisjeve përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në bazë të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti përfshihet në procesin e rekrutimit të stafit akademik (i saktë, dokument i dorëzuar nr. 2, Statuti i UBT, neni 36/1), i cili bëhet në disa faza si më poshtë: departamenti parashtron në përputhje me ngarkesën mësimore vendet e lira dhe harton kriteret bazë specifikisht për këto vende (i saktë, dokument i dorëzuar nr. 11.1, Rregullore për rekrutimin e Stafit Akademik, neni 3).</p> <p>Në bazë të dokumentit nr. 36.2 (Ligji nr. 80-2015, neni 64/1), tregohet se Institucioni zbaton ligjin e arsimit të Lartë për rekrutimin e punonjësve akademikë. Në dokumentin nr. 44.2, Format i Publikimit të Kritereve paraqet se Senati Akademik i UBT ka vendosur kriteret bazë për rekrutimin e personelit, të cilat janë bërë publike në çdo konkurs. Në kriteret e vendosura për rekrutim personeli, përparësi kanë ata që janë kualifikuar jashtë vendit të cilët kanë patur vlerësim të diferencuar (i saktë, dokument i dorëzuar nr. 11.1, Rregullore për rekrutimin e Stafit Akademik, Aneksi A, B, C mbështur në: Ligjin Nr. 80/2015 «Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit</p>

	të Lartë në Republikën e Shqipërisë» neni 33). Megjithatë, kandidatët që kanë pikë të barabarta duhet të vlerësohen në të gjitha fushat, dhe jo të preferohet kandidati që ka kryer studimet jashtë shtetit. Në këtë mënyrë, mund të vlerësohet mësimdhënia dhe kërkimi shkencor në fakultetet brenda vendit.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Në bazë të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm tregohet se Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë aktive rregullatore dhe i bën ato publike. Pas miratimit nga titullari i institucionit, ndiqet procedura e shpalljes publike të pozicionit të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në websitin e institucionit UBT, ku qëndron e hapur deri në mbylljen e konkursit dhe shpalljen e fituesit. Kjo paraqitet në dokumentin nr. 44.5, Oferta e punës dhe kriteret e punësimit, e dorëzuar nga GVB. Dokumenti i dorëzuar nr. 44.2 paraqet formatin e publikimit të vendit të lirë të punës dhe jo të kriterëve. Në bazë të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm paraqitet se një vëmendje të veçantë në procesin e rekrutimit është kushti për paraqitjen e dëshmisë së penaltetit. Kjo paraqitet në dokumentin nr. 11.2, Urdhër nr. 102 për paraqitjen e dëshmisë së penaltetit në dosjen për konkurim, por në dosjen personale nuk e kishin të gjithë. Dokumenti nr. 44.3, Shembull Kriteret e pranimit në FBU, duhet të ishte për departamentin e Teknologjisë Agrorshqimore. GVB ka dorëzuar dokumentin nr. 44.2 paraqet formatin e publikimit të kriterëve. Ndërsa dokumenti i dorëzuar nr. 11.1, Rregullore për rekrutimin e Stafit Akademik, Aneksi A, B, C mbështur në: Ligjin Nr. 80/2015, paraqet kriterin ku me kualifikimet jashtë vendit kanë patur vlerësim të diferencuar.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga raporti i GVB thuhet se dosjet e paraqitura nga çdo kandidat i nënshtrohen një seleksionimi paraprak nga komisionet e ngritura për këtë qëllim, duke propozuar kandidatët më cilësorë. Kandidatët e seleksionuar i nënshtrohen një procesi konkurrimi dhe intervistimi nga një komision. Komisioni përzgjedhës përbëhet nga: a. Dekani i Fakultetit Kryetar b. Përgj. Departamentit Anëtar c. Zv. Rektori për mësimin Anëtar d. Përgj. burimeve njerzore Anëtar, e. Përgj. GMK Anëtar. Kjo tregohet nga dokumenti i dorëzuar nr. 11.1, Rregullore e rekrutimit UBT, neni 3/9.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

**Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.

GVB deklaroi se FBU si pjesë e UBT ka një sipërfaqe totale prej 5454 m<sup>2</sup>. Kjo tregohet në dokumentin nr. 42.1, Të dhënat për infrastrukturën BCH TAU, ku për çdo objekt të shfrytëzuar nga Fakulteti janë treguar vendodhja, kodi, gjatësia, gjerësia dhe sipërfaqja, shumë e detajuar.

Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit është i ndarë në katër godina. Kjo tregohet në dokumentin nr. 42.3, Ambjentet e FBU, Shërbimet që kërkohen.

Kjo njësi bazë është angazhuar për krijimin e mjedisëve të përshtatshme për mësimdhënien, stafin akademik, stafi ndihmës dhe stafi teknik. Kjo tregohet në dokumentin nr. 42.3, Ambjentet e FBU, Shërbimet që kërkohen, ku për çdo ambient tregohen baza materiale (orenditë dhe mënyra e ngrohjes). Në dokument shprehen shifra reale dhe teorike.

Gjatë Vlerësimit të jashtëm, stafi akademik mësimdhënës ka kushte të përshtatshme dhe funksionale për dhënien e informacionit, dijeve në mënyrë sa më profesionale dhe bashkëkohore. Auditorët e mësimdhënies janë të pajisura me mjetet e domosdoshme të mësimdhënies. Sipas RVB, Pedagogët kanë zyrën e tyre 756.34 m<sup>2</sup>, janë të pajisur me kompjuter, internet free (kampus UBT), printer, skaner etj. Kjo tregohet në dokumentin nr. 42.1, Të dhënat për infrastrukturën BCH në IAU me profil TAU. Megjithatë, në Raportet Vjetore, tek përmbledhja e problematikave theksohet vazhdimisht për mangësi në pajisje. (Raporti 2017-2018: Mbetet detyrë pajisja e klasave dhe sallave të leksioneve me projektorë, Mbetet nevojë e paplotësuar sigurimi i pajisjeve të rëndësishme për zyrat e pedagogëve, si kompjutera dhe printera.

Për krijimin e mjedisëve dhe mundësive të barabarta është përgjegjës Drejtuesi i njësisë bazë, i cili është autoriteti drejtues akademik i departamentit. Kjo paraqitet në dokumentin e dorëzuar nr. 6 (Rregullore e FBU) dhe në nr. 6.1 (Rregullore e Brendshme e DTAU).

Në bazë të dokumentave të dorëzuara Drejtuesi i njësisë bazë zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të departamentit. Detyrat: Drejton të gjithë veprimtarinë mësimore dhe shkencore në departament; Garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe mundësive të barabarta, të lirisë akademike e të kërkimit, si dhe të drejtat e studentëve të departamentit; Përgatit dhe propozon kurrikulat e studimeve të departamentit, drejtime e profile të reja studimesh, projekte për programe të studimeve dhe të kërkimit shkencor etj.; Thërret dhe kryeson mbledhjet e departamentit; Realizon bashkëveprimin ndërmjet grupeve mësimore-kërkimore; Miraton programet mësimore të moduleve; Miraton komisionet e provimeve universitare. Informohet nga të gjithë anëtarët e departamentit rreth veprimtarive që ata kryejnë, si dhe ushtron kontroll rreth kësaj veprimtarie; Përfaqëson departamentin në marrëdhëniet e bashkëpunimit me persona dhe institucione të vendit dhe të huaja.

Nga raporti i GVB thuhet se në çdo fund viti akademik fakulteti realizon pyetësorin e personelit akademik dhe ndihmës akademik, të cilët ndihmojnë për përmirësimin e kushteve të

	<p>personelit. Pyetësoi i stafit akademik dhe ndihmës akademik (dokumenti nr. 41) është dorëzuar.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Raporti i GVB shpreh se FBU-ja për rritjen e profesionale të stafit akademik ndjek politikën integruese të UBT-së e cila është e fokusuar kryesisht në ofrimin e mundësive për trajnime dhe kualifikime të ndryshme në përputhje me fushat e studimit.</p> <p>Raporti i GVB shpreh se në programin e Inxhinierisë Agroushqimore profili Teknologji Agroushqimore angazhohen gjithsej 37 pedagogë, 23 prej tyre i përkasin stafit të brendshëm efektivë të FBU-së, 13 janë nga fakulteteve të tjera të UBT-së dhe 1 pedagog është i ftuar. Stafi pedagogjik i këtij programi studimi përbëhet nga 8 pedagogë me titullin Profesorë, 6 me titull Profesor i Asociuar, 16 me gradën Doktor Shkencash dhe 6 me MSh. Megjithatë, sipas dokumentit nr. 43.1, Tabelë Kualifikimesh për PA të Programit të Studimit BSc në TAU departamenti ka gjithsej 38 pedagogë dhe jo 37. Stafi pedagogjik i këtij programi studimi përbëhet nga 9 dhe jo 8 pedagogë me titullin Profesorë, dhe 7 me titullin MSc dhe jo 6. Gjithashtu, dokumenti nr. 23, Tabela nr. 1 Numri i punonjësve në FBU, tregon 38 staf pedagogjik (6 personel akademik dhe 6 punonjës kërkimor).</p> <p>Sipas raportit të GVB, FBU-ja integron stafin sipas fushave të kërkimit në projekte dhe veprimtari kërkimore shkencore. Projektet pranë fakultetit me koordinatoren përkatës, tregohen në dokumentin 43.6 (në anglisht), që nga viti 2014. Në dokumentin nr. 43.2, tregohen Lëvizjet e stafit akademik të FBU 2014-2018, i cili është një tregues i rëndësishëm i kualifikimit të stafit, por titulli është Programi i studimit Msc në Inxhinieri Agroushqimore Profili Teknologji Agroushqimore dhe jo për Bachelorin.</p> <p>Në raport GVB shpreh se një rëndësi të veçantë për kualifikimin e stafit është motivimi i personelit akademik të ri për fitimin e gradëve (Dr.) dhe titujve (Profesor dhe Profesor i Asociuar). Gjatë periudhës 2014-2019 nga stafi i FBU-së i cili është përfshirë në programin e Inxhinierisë Agroushqimore janë fituar 2 tituj Profesor i Asociuar, 10 grada doktor shkencash nga të cilat 2 janë marrë jashtë vendit. Megjithëse, sipas dokumentit nr. 43.1, Tabelë Kualifikimesh për PA të Programit të Studimit BSc në TAU 10 pedagogë kanë gradën doktor i shkencave.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Në raportin e GVB thuhet se në FBU prej kohësh përdoren metodat inovative të mësimdhënies. Metodot që përdoren janë: e-learning, google site, Moduli online "Njohuria mbi informacion", Moodle, TEEAL, Sistemi ESSE3. Për përdorimin e këtyre metodave vihen në dispozicion udhëzuesi i përdorimit ku janë të bashkëngjitur edhe adresat e faqes web për çdo program. Të gjithë studentët janë të përfshirë në faqen e sistemit ESSE3.</p> <p>Në dokumentin e dorëzuar nr. 39, Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve,</p>

	<p>lëndëve/ moduleve paraqiten përshkruhen në mënyrë të përmbledhur metodat inovative të mësimdhënies përmes teknologjive të reja (dokumenta shtesë 45.5, 47.1, 47.2), si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Metoda e-learning është një metodë inovative e cila zhvillohet nëpërmjet paisjeve elektronike, ku materialet zëvendësohen me versione elektronike si dokumente, materiale të bashkëngjitura, prezantime poëerpoint, audio, video, etj.</li> <li>- Google Site është një tjetër aplikacion online që ndihmon në krijimin e një projekti në ëeb ose të një ëeb-site.</li> <li>- Moodle LMS (Learning management system) janë aplikacione në ëeb, të cilat mundësojnë menaxhimin e materialit mësimor dhe administrimin e procesit mësimor.</li> <li>- TEEAL (TEEAL) është një bibliotekë online e aplikuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës, më shumë se 450 revista kërkimore.</li> </ul> <p>Projektet pranë fakultetit me koordinatoren përkatës, tregohen në dokumentin 43.6 (në anglisht), që nga viti 2014, si për shembull Netchem (ICT Networking for Overcoming Technical and Social Barriers in Instrumental Analytical Chemistry education), dhe TEMPUS 517117-1-2011-1-IETEMPUS-JPHES, “Zhvillimi i njohurisë për informacionin për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe një ekonomi të bazuar mbi dijen në vendet e Ballkanit Perëndimor”.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Në bazë të raportit të GVB, FBU-ja ka arritur një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të parë. Duke u mbështetur në Statusin e UBT kreu 6, FBU-ja i ka ndarë përgjegjësit e stafit akademik, ndihmës akademik dhe teknik sipas funksioneve të gjithë secilit. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar nr. 2, Statuti i UBT. Funksionet dhe detyrat janë të pasqyruar në kontratën e punës të çdo punonjësi. Në dokumentat nr. 44.6 dhe 44.7, paraqiten Kontrata e punës për personel Akademik FBU dhe Kontrata Pune Staf Ndihmës FBU, ku shpjegohen të drejtat dhe detyrat për çdo individ. Kontrata për profesor të ftuar është dorëzuar.</p> <p>Në dokumentin nr. 34.3 jepen qartë Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës me institucionet Homologe brenda dhe/ose jashtë vendit (Institucione të Arsimit të Lartë nga vende të ndryshme në Europë, Azi, Kosovë dhe Shqipëri (44 marrëveshje), aktorët e Biznesit vendas dhe/ose të huaj (43 biznese) për të realizuar me sukses objektivat e lidhura me procesin e mësimdhënies në mënyrë cilësore. Ndërsa në dokumentin nr. 32.1 jepet Marrëveshja e Fakultetit FBU me institucionet, gjithsej 16. Në lidhje me bashkëpunimin me institucione janë dorëzuar: Marrëveshja UBT me Carrefour (32.2), Marrëveshja UBT me MBZHRAU (32.2), Marrëveshja UBT me AKU, Marrëveshja FBU me Univ. Milano, Lektor në Giessen, Kontratë FBU me Univ. e Mitrovicës, Marrëveshje FBU me Univ. e Varshavës.</p>

	<p>Megjithatë, në bazë të dokumentit 34.1, Formati i marrëveshjes së bashkëpunimit, nga GVB marrëveshje të nënshkruara midis Fakultetit FBU dhe Bizneseve, është dorëzuar tabelë përmbledhëse nr. 32.1 dhe shembull.</p> <p>Në bazë të raportit të GVB, për monitorimin e mbarëvajtjes sa më të mirë të procesit mësimor, në çdo fund simestri organizohen anketime me studentët ku, ata kanë shprehur mendimin e tyre në lidhje me cilësinë e procesit mësimor. Kjo tregohet në dokumentin nr. 40, Pyetësor për studentët Format Tip, por duhet të ishte vetëm për Bachelor profilin Teknologji Agroushqimore dhe jo profilin Enologji dhe masterin.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përkrahja</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Në bazë të raportit GVB, FBU-ja disponon mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore të Programit të cilkit të parë në IAU Profili TAU. Mësimdhënia realizohet në godinat e FBU-së.</p> <p>Në dokumentin 42.1 të dhëna për infrastrukturën për të gjithë FBU: Laboratore mësimore 748.8 m<sup>2</sup>, Salla leksionesh 883.74 m<sup>2</sup>, Hapësira linja pilot përpunimi 234.75 m<sup>2</sup>, Hapësira linja e prodhimit të verës / pije 300.34 m<sup>2</sup>, Hapësira ndihmëse dhe shërbime 727.93 m<sup>2</sup>, Zyra 756.34 m<sup>2</sup>, Biblioteka 1300 m<sup>2</sup>. Gjithsej 5046.38 m<sup>2</sup>.</p> <p>Kjo tregohet shumë mire në dokumentat nr. 42.1 / 2/ 3, për të gjithë fakultetin, por që të krijohet një pasqyrë më e qartë duhet një dokument për raportin pedagog dhe student në lidhje me ambientet përkatëse për Bachelorin me profil TAU. Në dokumentin nr. 42.2, Raporti sipërfaqe/student për programin e studimit Bachelor me profil TAU, paraqet se llogaritjet janë bërë për 838 student duke përfshirë të gjitha programet, ndërsa Bachelori TAU ka 404 student. Në dokumentat 42.1 dhe 42.2, tregohet se FBU ka 21 salla Laboratori, por në kriterin 3 të këtij standardi ka 20 salla Laboratori dhe më poshtë tregohet se ky program shfrytëzon 18 laboratore. Sipas raportit të GVB, në dispozicion të këtij Programi janë 4 godina, në të cilën përfshihen 9 salla leksionesh, 18 laboratorë, 5 linja eksperimentale të teknologjisë së përpunimit ushqimor.</p> <p>Sipas RVB, Mjediset e FBU-së për Programin e cilkit të parë në IAU Profili TAU llogariten në 4.4 m<sup>2</sup>/student, duke plotësuar normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme prej 3,8–4.0 m<sup>2</sup>/student (minimumi) dhe 7.5–8.0 m<sup>2</sup>/student (maksimumi) të përcaktuara nga standartet shtetërore të cilësisë. Megjithëse</p>

	<p>shumë prej ambienteve janë jo shumë të mëdha për të mirëpritur 20/25 studentë. Kjo shprehet edhe në raportin 2017-2018: Mbetet problem hapësira e kufizuar e ambienteve të mësimdhënies, në veçanti e laboratorevë, të cilët kanë sipërfaqe të vogla në krahasim me numrin e studentëve në një grup, mesatarisht 20/25 studentë. Kjo vështirëson lëvizjen dhe punën nëpër laboratore.</p> <p>Sipas raportit të GVB, lartësitë e sallave të leksionit janë më të madhe se 3.0 m (tavan - dysheme), të cilat bëjnë të mundur plotësimin e normativës teknike të ndricimit natyral, sallat janë të orientuara nga krahu i majtë i studentevë pjesërisht me orientim juglindje. Këto ambiente janë vëzhguar edhe gjatë vizitës së GVJ, por shifrat duhet të paraqiten edhe në dokumenta. Sipas raportit të GVB, në të gjitha mjediset e mësimdhënies janë të instaluar sistemet e ngrohjes, si dhe të pajisura me karrike dhe tavolina. Kjo njësi bazë është angazhuar për krijimin e mjediseve të pershtatshme për mësimdhënien, stafin akademik, stafi ndihmës dhe stafi teknik. Kjo tregohet në dokumentin nr. 42.3, Ambientet e FBU, Shërbimet që kërkohen, ku për çdo ambient tregohen baza materiale (orenditë dhe mënyra e ngrohjes). Në dokument shprehen shifra reale dhe teorike. Megjithatë, në raportin 2017-2018 një nga problematikat ëshë sigurimi i ngrohjes në të gjitha ambientet e studimit, si dhe disa zyrave.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Sipas raporti të GVB, sallat ku zhvillohen leksionet janë të pajisura me videoprojektorë që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies. Pjesa më e madhe e auditorëve janë të lidhura me rrjetin e internetit, lidhja me rrjetin e internetit bëhet ose me lidhjen direkte të fishës lan ose nëpërmjet wireless. Gjatë vizitës së GVJ u konstatua se pjesa më e madhe e ambienteve janë të pajisur dhe në bazë të dokumentit nr. 39.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, për realizimin e seancave eksperimentale laboratorike, laboratorët e FBU-së janë të pajisura me mjetet dhe aparaturat sipas specifikave të programit. Dokumenti i dorëzuar nr. 53, paraqet Rregjistrin e Administrimit të mjeteve dhe pajisjeve kryesore laboratorike, ku çdo zë është i plotësuar përveç zërit "Blerë në kuadër të projektit/Fondit Titulli dhe numri. Gjithashtu, fotot e mjeteve dhe pajisjeve laboratorike, inventaret e linjave të prodhimit janë dhënë në dokumentat nga nr. 60.1 deri në 60.26.</p> <p>Sipas vëzhgimeve dhe dokumentave të dorëzuara të gjitha këto laboratore janë të mobiluara dhe të pajisura sipas specifikës së laboratorit, në të gjenden reagentë, mjete ndihmëse aparatura etj, të cilat mundësojnë realizimin e seancave praktike. Në dokumenti nr. 53.1 (nuk figuron në referencat), jep në mënyrë përmbledhëse inventarin e imët dhe materiale për çdo personel akademik, ndihmës akademik dhe administrata, por në grupin e administratës rezultojnë dhe tre pedagogë.</p> <p>Sipas raportit të GVB, Laboratorët e FBU-së janë :</p> <p>1. Laborator Fruta Perime</p>



	<p>2. Laborator vaji  3. Laborator Sensorial  4. Laborator Enologjisë  5. Laborator Drithërave  6. Laborator i Shkencave Biologjike  7. Laborator i Kimisë Analitike  8. Laborator i Kimisë (Absorberi)  9. Laboratori i Analizave Sensoriale (S.Degustimi)  10. Laboratori i produkteve me origjinë shtazore  11. Laborator i Kimisë së Përgjithshme 1  12. Laborator i Kimisë së Përgjithshme 2  13. Laboratori i Kimisë Organike 1  14. Laborator i Kimisë Organike 2  15. Laboratori i Enzimologjisë  16. Laboratori i Kimisë Ushqimore  17. Laborator i Biologjisë (1)  18. Laborator i Biologjisë (2)  19. Laboratori i Mikrobiologjisë Ushqimore  20. Laboratori i Mikrobiologjisë së Përgjithshme</p> <p>Duhet të specifikohet se këto laboratore shfrytëzohen për Bachelor në IAU me profil TAU.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, në cilkin e parë të studimeve, në programin e Inxhinierisë Agroushqimore nuk parashikohet e domosdoshme përdorimi i teknologjisë informatike për shkak të fushës specifike që ajo përmban. Studentët pajisen me njohuritë bazë në fushën e informatikës në modulën e vitit të parë “Informatika”, në ciklet pasardhëse pasi janë formuar në disiplinat bazë jepet mundësia e laboratorëve të informatikës. Megjithatë, meqë fusha e studimit është Inxhinieri Agroushqimore, që studenti të kompletohet nga ana inxhinierike, programi duhet të pasurohet me lëndë mbi modelimin, projektimin, simulimin e teknologjive të ndryshme agroushqimore, duke përdorur programe të ndryshme inxhinierike.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, për realizimin e praktikave mësimore dhe ato profesionale FBU përdor linjat teknologjike të përpunimit ushqimor. Këto janë linja të vogla pilote të përpunimit të ushqimit. Kjo tregohet në dokumentin nr. 42.1. Përvec se u vëzhguan nga GVJ, mjetet dhe pajisjet laboratorike, linjat e prodhimit janë dhënë në dokumentat nga nr. 60.1 deri në 60.26. Këto linja kanë hapësira të mjaftueshme për realizimin e seancat mësimore dhe ato praktike.</p> <p>Linjat kryesore që disponon FBU-ja dhe që shfrytëzohen nga studentët e Bachelor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Linja e përpunimit termik të qumështit dhe nënprodukteve të tij,</li> <li>- Linja e prodhimit të djathit</li> <li>- Laboratori i drithrave dhe reologjia</li> <li>- Kantina eksperimentale e verës dhe pijeve alkooolike</li> <li>- Linja e përpunimit të vajit të ullirit.</li> </ul> <p>Sipas raportit të GVB, për realizimin e praktikave profesionale studentët ju drejtohen edhe institucioneve dhe operatorëve të</p>

	biznesit me të cilët FBU ka bashkëpunime. Megjithatë, në bazë të dokumentit 34.1, Formati i marrëveshjes së bashkëpunimit, dorëzuar nga GVB marrëveshje të nënshkruara midis Fakultetit FBU dhe Bizneseve, me një tabelë përmbledhëse nr. 32.1 (shembull) dhe nr. 34.2.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Sipas raportit të GVB, për nevojat studimore të studentëve, FBU ndjek politikat e institucionit kryesor (UBT-së) duke vënë në dispozicion mjediset e bibliotekave të kampusit, bibliotekën shkencore “Mentor Përmeti” dhe Bibliotekën që ndodhet pranë Fakultetit të Ekonomisë Agrare. Sallat e literaturës janë të organizuara me fonde të hapura të ndara sipas degëve të shkencës. Grupi i Vlerësimit të jashtëm nuk pati mundësi të shikoj dhe të njihet me sallat dhe mënyrën e organizimit të bibliotekës, për shkak të një takimi të papritur të përgjegjësës së bibliotekës në Akademinë e Shkencave. GVJ nuk e ka marë në konsideratë, meqë një nga ekspertët e jashtëm ishte pjesë e një grupi tjetër akreditimi në këtë fakultet dhe i kishte parë ambientet dhe ishte e informuar më parë. Ky vendim u mor në prani të GVJ, specialistes së ASCAL dhe përgjegjësës së departamentit. Burimi kryesor i informacionit është kryesisht bibliografik (libra, postera, harta, CD-Rom), sikundër edhe shërbim në version online. ( <a href="http://www.librariaubt.com/kategoria-produktit/bioteknologji-ushqimi/">http://www.librariaubt.com/kategoria-produktit/bioteknologji-ushqimi/</a> )
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Në dokumentin e dorëzuar nr. 45.2, paraqet se në bibliotekën e UBT-së “Mentor Përmeti”, gjenden literaturë (libra tekniko-shkencore) në gjuhën shqipe (44 libra) dhe në gjuhë të huaj (67 libra), të cilat i perkasin fushës së Bioteknologjisë dhe ushqimit. Sipas raportit të GVB, Biblioteka e UBT-së është biblioteka e vetme nga institucionet publike e cila është dixhitalizuar dhe studentët mund të shfrytëzojnë gjithë informacionet kërkimore shkencore në gjuhë të huaj. Rjeti Akademik Shqiptar ka mundësuar dixhitalizimin në bashkëpunim me EBSKOn, një motor kërkimi për për grumbullimin e informacionit dhe aksesim në të gjitha librat, revistat ndërkombëtare më të mira, të botuara në gjuhën angleze. Në dokumentin e dorëzuar nr. 45.5, tregohet me foto pamja e faqes së Katalogut online, Libraria Elektronike. Për të kërkuar në katalogun online duhet të klikohet <a href="http://www.al.cobiss.net">www.al.cobiss.net</a> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat	Bibliotekat janë të pajisuara me salla studimi dhe salla kompjuterike ku studentët kanë akses përdorimi. Rjeti

<p>on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>kompjuterik dhe shërbimi i internetit është i pa ndërprerë dhe pa pagesë.  Në bazë të dokumentit nr. 45.6, biblioteka ofron informacione online nga burimet elektronike Research4life me pesë programet AGORA, ARDI, GOALI, HINARI, OARE.  Sipas raportit të GVB, në kuadër të Projektit Erasmus+ “Library Network Support Services” (LNSS), jemi pjesë e platformës Springshare LNSS, një platformë online, me burime shumë të pasura informacioni (199), por kjo nuk ndodhet në referencën përfundimtare, në listën e citimeve në fund të RVB  Në dokumentin e dorëzuar nr. 39, Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve paraqiten përshkruhen në mënyrë të përmbledhur metodat inovative të mësimdhënies përmes teknologjive të reja si:  - TEEAL është një bibliotekë online e aplikuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës, më shumë se 450 revista kërkimore.  Sipas raportit GVB, shpreh se janë hapat e parë, drejt implementimit të platformës RASH, ku stafi akademik dhe studentet nëpërmjet sistemit ESS3 do të kenë akses në mijra punime shkencore, libra apo revista të botuara në të gjitha fushat e studimit, por nuk ka asnjë dokument shoqëruar.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, Biblioteka “Mentor Përmeti” ka vënë në dispozicion një sallë për kompjutera ku gjenden rreth 10 të tillë të cilët kanë akses për përdorim nga studentët. Bibliotekën e re (FEA-s) e cila ka një kapacitet rreth 100 vendesh, është një bibliotekë moderne, dhe gjenden të instaluar rreth 12 kompjutra të lidhura me internetin dhe funksion sipas fondit on-line TEEAL.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, FBU-ja çdo vit harton një plan të detajuar për shtimin e zërave në bibliotekë, të cilën ja percjell UBT-së. Sipas plan buxhetit UBT-ja planifikon abonimin e përvitshëm në TEEAL. Shtimi i zërave të bibliotekës bëhet nga buxheti, por dhe nga projektet e ndryshme që ka fituar universitetit. Dokumenti 49-50 të dorëzuar për këto plane të detajuara, duhet të shënohet edhe tek referencat.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, Biblioteka qëndron e hapur nga e hënë në të premte 8.00 – 16.00, oraret e saj janë publike dhe funksionon sigurisht përmes kartelave të regjistrimit. Sipërfaqja e ambienteve të bibliotekës është rreth 1300 m<sup>2</sup> (dokumenti i dorëzuar nr. 42.1). Biblioteka Shkencore “Mentor Përmeti” ka 4 salla, Salla e librit tekniko-shkencor “Vasfi Samimi”, i cili ka një kapacitet prej 35 poste, janë të anëtarësuar rreth 862 student, 208 pedagogë dhe 76 staf ndihmës akademik dhe administrati. Frekuentimi mujori kesaj salle është rreth 400-500 përdorues në muaj. (dokumenti i dorëzuar nr. 42.5)  Salla e librit artistik dhe periodiku: Ka një kapacitet prej 40 poste; gjithësej janë anëtarësuar rreth 358 student, 63 pedagogë dhe 62 staf ndihmës akademik dhe administrativ. Frekuentimi mujor rreth 350-540 përdorues. (dokumenti i dorëzuar nr. 42.5)</p>

	Sallë studimi dhe kompjuterash për studentët: Ka një kapacitet 50 poste. Ka 10 kompjutera në gjendje të mirë pune. Frekuentohet nga rreth 300 studentë në muaj. (dokumenti i dorëzuar nr. 42.5) Salla e pedagogëve dhe eventeve: Ka një kapacitet 35 poste, 6 kompjutera, një skaner me fotokopje dhe printer, një videoprojektor. (dokumenti i dorëzuar nr. 42.5)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Sipas raportit të GVB, FBU ka ngritur një sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit përcakton standartet që kanë në lidhje me përgatitjen, organizimin dhe administrimin e informacionit që lidhet me studentet dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Kështu në Rregulloren e UBT si dhe në Rregulloren e Studimeve Bsc janë përcaktuar qartë kushtet dhe procedurat e pranimit të studenteve në këtë PS. Kjo paraqitet në dokumentin nr. 6, Rregullore e FBU, kreu IV (Studimet e Ciklit të parë në FBU); në dokumentin nr. 9, Rregullore e ZSS, pika 2; në dokumentin nr. 7, Rregullore e programit të studimit Bachelor, neni 5, 6, 7 (numri 293 tek referencat mungon). Dokumenti nr. 5, Rregullore e Studimeve Universitare i dorëzuar online.</p> <p>Sipas dokumentit nr. 9, Rregullore e ZSS, Zyra e studimeve dhe studentëve kryen dhe ndjek çdo procedure të studentit, që nga regjistrimi i tij deri në diplomim. ZSS është pjesë përbërëse e strukturës organizative e UBT-së, miratuar si e tillë në mbledhjen e SENATIT me vendimin nr. 14, datë 28.12.2001.</p> <p>Në bazë të dokumentit nr. 9.1, përveç ZSS, pranë FBU funksionon edhe ZKS (Zyra e Karrierës dhe Studentëve), detyrat e të cilit përcaktohen qartë.</p> <p>Në bazë të takimit me Specialistin e ZKS dhe dokumentit nr. 9.1, Rregullore e DIOKS detyrat e tij janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në fillim të çdo viti mësimor, përgatit një paketë informacioni orientues veçanërisht për studentët e vitit të parë, duke instaluar në hyrje të çdo godine fakulteti, instalon një tavolinë me informacionin më të domosdoshëm për një student të vitit të parë;</li> <li>- Realizon një komunikim me studentet që kërkojnë të orientohen dhe të informohen në zgjidhjen e kërkesave të tyre</li> <li>- Ka marrëdhënie të drejtpërdrejta (elektronike) me ZSS dhe dekanin; koordinon operacionet me sekretaritetë e departamenteve</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkëpunon për hedhjen e të dhënave në sistemin ESSE3 të sekretarisë (në lidhje me pagesën e tarifës së regjistrimit dhe taksës së shkollimit të studentëve);</li> <li>- Hedh në sistemin ESSE3 planet mësimore, datat dhe komisionet e provimeve, dhe përditëson ndryshimet e herëpashershme;</li> <li>- Shpërndan fletëpagesat për tarifat e shkollimit, mbledh dhe ruan mandat pagesat e studentëve;</li> <li>- Çdo muaj kontrollon prezencën e studentëve të trajtuar me bursë dhe informon me shkrim për këtë problem kancelarin e universiteti</li> <li>- Pranon kërkesat dhe jep përgjigje për miratim apo ndryshim dege, brenda fakultetit.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në bazë të raportit të GVB, sistemi i brendshëm i menaxhimit në rang FBU realizohet nëpërmjet Komisionit të Sigurimit të cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor i zgjedhur me zgjedhje të drejtpërdrejta nga Asambleja e Fakultetit. Kjo tregohet nëdokumentin e dorëzuar nr. 30.1 dhe nr. 30.2, ku nga zgjedhjet e mbajtura në datë 20.04.2016, komisioni u përbë nga 5 anëtarë fitues (4 pedagog dhe 1 student). Gjithashtu, në kuadër të Vlerësimit të Brendshëm të FBU, është ngritur një Grup Pune që ka realizuar Vlerësimin e Brendshëm të FBU në 2018. Kjo tregohet në dokumentin nr. 3.2, ku grupi i punës përbëhet nga 10 anëtarë: 1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc. Dr. (kryetar), 6 Dr, Kancelare e FBU dhe Specialistja e Zyrës së Karrierës dhe Studentëve.</p> <p>Megjithatë, është dorëzuar dhe një dokument tjetër 30.3, Grupi i punës për vlerësimin e brendshëm në FBU 2014, me 10 anëtarë: 1 Prof. Dr. (kryetar), 1 Prof. Asoc. Dr., 2 Dr, 4 MSc, Kancelarja e FBU dhe Specialistja e Zyrës së Karrierës dhe Studentëve. Në grupin e vitit 2014, anëtarët janë nga të gjithë departamentet, ndërsa në 2018, departamenti i Kimisë mungon. Duke marrë parasysh që PS i vitit të parë, pjesa më e madhe e lëndëve i përkasin fushës së Kimisë, duhet të ishin pjesë e grupit të punës për vlerësimin e brendshëm. Në bazë të raportit të GVB, këto komisione mbajnë lidhje të drejtpërdrejta me Dekanatin, zv. Dekanin për mësimin, zv. Dekanin për Shkencën dhe Përgjegjësin e Departamentit ku zhvillohet Programi i Studimit, detyrat e të cileve, lidhet me administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnereve të angazhuar në realizimin e programit. Këto detyra janë përcaktuar në Rregulloren e FBU. Kjo tregohet në dokumentin nr. 6, Rregulloren e FBU, neni 9, 15 dhe 16. Megjithatë, në rregulloren e FBU, neni 11 për Komisionin e Sigurimit të cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor është e paplotësuar (Kreu II, Organizimi dhe drejtimi në FBU).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të raportit të GVB, FBU-ja ju ofron akses në gjetjen e dokumentave të nevojshëm të gjithë stafit akademik dhe studentor.</p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Informimi i studentëve në lidhje me programet e studimit dhe kurrikulat, datat e provimeve, regjistrimet në provime, rezultatet e provimeve, kreditet e përftuara dhe të gjitha detyrimet e tjera realizohet nëpërmjet sistemit të brendshëm online ESSE3, kontaktit të tyre me stafin akademik dhe administrativ të FBU-se, gjatë procesit mësimor, përmes faqes së internetit të UBT, përmes njoftimeve të vazhdueshme që shpallen nga ZSS, ZKS ose Dekanati.</p> <p>Kjo paraqitet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- në dokumentin e dorëzuar nr. 39, Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve paraqiten përshkruhen në mënyrë të përmbledhur metodat inovative të mësimdhënies përmes teknologjive të reja;</li> <li>- në dokumentin nr. 46 dhe 47.2, ku në foto tregohet mënyra e marrjes e të dhënave nga studentët (Site i pedagogut);</li> <li>- në dokumentin 47.1 Esse3 account pedagogu, e cila shërben si mjet komunikim pedagogun. Mund të shikojë materialet mësimore të hedhura aty nga pedagogu, si leksione të shkruara, paraqitje poëerpoint i leksioneve të ndryshme, literaturë e rekomanduar, etj</li> </ul> <p>Për stafin akademik, institucioni ka hapur një adresë individuale në sistemit ESSE3, nëpërmjet të cili realizohet komunikimi midis studentit dhe pedagogut, pedagogut dhe sekretarisë, lidhur me vlerësimet gjatë vitit, vlerësimet përfundimtare, proces-verbalet e notave etj. Kjo paraqitet në dokumentin 47.1 Esse3 account pedagogu, e cila shërben si mjet komunikimi për pedagogun.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, në FBU ka një sistem që garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Mbarëvajtja e aktivitetit mësimor dhe aktivitetit shkencor është detyrë prioritare e stafit akademik dhe atij ndihmës mësimor. Kështu, si formë raportimi në kohë reale për ecurinë e mësimit përdoret regjistri i pedagogut, Plani Kalendar i mesimdhënies, axhendat javore dhe mujore të prezencës dhe aktivitetit të stafit akademik, Publikimet e artikujve/kongrese dhe konferenca, të cilat vihen në dispozicion online në CV akademike në site e pedagogut.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, rregjistri i pedagogut nuk është nr. 58, por nr. 61.1 (e para)/2/3. Ndërsa në dokumentin 61.1 (i dyti) nuk ka lidhje me regjistrin e pedagogut. Në dokumentat nr. 61.1/2/3, paraqiten foto të kapakut, faqes së parë, në brendësitë rregjistrin është në rregull.</p> <p>Plani kalendar i mësimdhënies, në referimet tregohet nr. 14.6. Nuk ka një plan të përgjithshëm, por plane kalendare për secilën lëndë të pa specifikuar, thjesht emri i pedagogut. Gjithashtu, planet kalendare nuk janë të unifikuara dhe në disa prej tyre percaktimi seminare, laboratore, praktika nuk janë në pozicionin e duhur.</p>

	<p>Axhenda javore, tregohet ne dokumentin nr. 55, ku për muajin nëntor 2018, janë treguar vendodhja dhe aktiviteti i disa prej pedagogëve.</p> <p>Gjithashtu, janë dorëzuar CV e pedagogëve, ku mund të shikohen edhe online (+ dokumenti nr. 47.2)</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në bazë të raportit të GVB, FBU si burim informacioni orientues për studentet përdoret faqja e website-it të FBU (dokumenti nr. 47, nuk është dorëzuar), ose website personale të pedagogëve (dokumenti nr. 47.2, Site i pedagogut).</p> <p>Në bazë të GVB, në këto website gjendet i gjithë informacioni i detajuar mbi Fakultetin, Programin e studimit, misionin dhe vizionin e programit të studimit, kurrikula e programit, pedagoget mesimdhënës, drejtuesit e Fakultetit, Departamentit, programet e shkëmbimeve në kuadër të projekteve Erasmus apo projekte të tjera me pjesëmarrje të studenteve, njoftimeve të ndryshme, etj. Kjo tregohet në dokumentin 47.1 Esse3 account pedagogu.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Jo përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

**Standardi IV.6**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, në çdo fund viti FBU harton një plan buxheti financiar të kostove për vitin në vazhdim. Në këtë plan financiar pasqyrohet parashikimi i të ardhurave nga buxheti i shtetit (70%, mbulojnë paga, sigurime dhe pagesat e bursave të studentave), si dhe parashikimi i të ardhurave dytësore që mblidhen nga tarifat e shkollimit (planifikohen për mallra dhe shërbime, pagesat e orëve mbingarkesë të pedagogëve, pagesat e pedagogëve të ftuar, shtesat e funksionit, si dhe investime). Deri me sot planifikimi i buxhetit është bërë në rang Fakulteti dhe jo për çdo PS. Kostoja financiare e llogaritur për PS IAU në IAU-TAU është llogaritur proporcionalisht me numrin e studentëve që ndjekin këtë program. <i>Mendojme se jemi të saktë në këtë llogaritje, edhe për faktin se të ardhurat dytësore të shpenzuara në mallra dhe shërbime, investime e pagesa mbingarkesë pedagogesh apo pedagogë të ftuar janë të shpërndara pothuajse proporcionalisht midis gjithë programeve të studimit që mbulon FBU-ja.</i></p> <p><i>Bazuar në Planin Financiar të Vitit 2018, kostoja mesatare e Programit të ciklit të parë të Studimit IAU, Profili TAU është 47,771,180 lekë.</i></p> <p>Dokumenti i dorëzuar nr. 49-50, Pasqyrat analitike të planit financiar dhe shpenzimeve faktike për FBU viti 2018-2019, është për të gjithë fakultetin.</p> <p>Plani financiar përpilohet nga Administratori i FBU-së (Ref. Rreg FBU, Neni 17, 5 TAU) dhe dërgohet për miratim në degën e Financës në Rektorat (dokumenti i dorëzuar nr.6).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, plani i financimit për FBU-në është përpiluar duke mbajtur parasysh nevojat e realizimit të punës mësimore dhe kërkimore për çdo PS, sipas Strategjisë së Zhvillimit të PS (dokumenti nr. 4 sipas referimeve nuk është dorëzuar).</p> <p>Sipas raportit të GVB, financimi i kërkimit shkencor është realizuar edhe përmes projekteve të përbashkëta apo financimeve nga projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare: Projekte IPA (Linja e prodhimit të djathrave), Projekte me BE (Linja e vazhduar e përpunimit të qumështit), Erasmus + Project NETCHEM (Laboratori i Inxhinjerisë Ushqimore); donacione nga Miell Tirana Shpk (Pajisjet pilot të përpunimit të drithërave dhe produkteve konditore – donacion nga). Në dokumentin nr. 34.3 jepen qartë Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës me institucionet Homologe brenda dhe/ose jashtë vendit (Institucione të Arsimit të Lartë nga vende të ndryshme në Europë, Azi, Kosovë dhe Shqipëri (44 marrëveshje), aktorët e Biznesit vendas dhe/ose të huaj (43 biznese) për të realizuar me sukses objektivat e lidhura me procesin e mësimdhënies në mënyrë cilësore. Ndërsa në</p>



	<p>dokumentin nr. 32.1 jepet Marrëveshja e Fakultetit FBU me institucionet, gjithsej 16. Në lidhje me bashkëpunimin me institucione janë dorëzuar: Marrëveshja UBT me Carrefour (32.2), Marrëveshja UBT me MBZHRAU (32.2), Marrëveshja UBT me AKU, Marrëveshja FBU me Univ. Milano, Lektor në Giessen, Kontratë FBU me Univ. e Mitrovicës, Marrëveshje FBU me Univ. e Varshavës. Gjatë vizitës së GVJ, u konstatuan të gjitha pajisjet, linjat pilot + inventare (dokumenti i dorëzuar është nga 60.1 deri 60.26, jo nr. 57 si tek referencat). Në bazë të dokumentit 34.1, Formatit i marrëveshjes së bashkëpunimit, të dorëzuar nga GVB marrëveshje të nënshkruara midis Fakultetit FBU dhe Bizneseve, është tabelë përmbledhëse nr. 32.1 plus një shembull.</p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, FBU si njësi kryesore nuk ka zyrë auditim, por i nënshtrohet një Auditimi financiar i cili realizohet nga Auditimi Brendshëm i UBT. Administratori i UBT harton projekt buxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të fakulteteve dhe të departamenteve, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të universitetit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij dhe propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre. Kjo shpjegohet në dokumentin e dorëzuar nr. 2, Statuti i IAL, Statuti i UBT, Neni 22.</p> <p>Pas ardhjes së Planit të detajuar financiar nga Rektorati, Administratori i FBU është përgjegjës për zbatimin rigoroz të tij. Kjo shpjegohet në dokumentin e dorëzuar nr. 2, Statuti i IAL, Statuti i UBT, Neni 24 dhe dokumentin nr. 6, Rregullore e FBU, neni 17.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, FBU-ja dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p>Analizat financiare dhe raportet e institucionit realizohen nga zyra e financave të UBT-së, FBU-ja i përcjell prashikimin e planit financiar për të gjithë institucionin. Analizat dhe Raportet financiare raportohen në rektorat, senat akademik, dhe miratimi përfundimtar bëhet në Bordin e Administrimit. Kjo shpjegohet në dokumentin e dorëzuar nr. 2, Statuti i IAL, Statuti i UBT, Neni 24 dhe dokumentin nr. 6, Rregullore e FBU, neni 17.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, FBU-ja në këto tre vitet ka pasur një rritje në të ardhurat e saj si nga ato të miratuar nga buxheti i shtetit por edhe nga ato të krijuar nga vetë institucioni.</p>				
	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="595 1832 742 1888">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="746 1832 949 1888">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="954 1832 1157 1888">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1161 1832 1367 1888">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>				✓
--	--	--	--	---

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (DZHKKVI), dhe Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive (DITNJ), ndjekin procesin mësimor dhe zhvillimin e karrierës për ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Kjo tregohet në dokumentin nr 12, Rregullore e DZHKKVI (e cila është përsëritur dy herë në referenca), neni 3. Sipas Rregullores së Studimeve universitare të FBU neni 19 i cili mbeshtetet tek Ligjit i arsimit të lartë, Nr. 80/2015, neni 69 pika 1, studentet ndjekin studime me kohë të plotë në programin e studimit IAU në Departamentin e Teknologjisë Agrorshqimore. Këto studime, në bazë të vitit akademik ndahen në dy semestra me 15 javë secili. Data e fillimit të vitit akademik caktohet nga MASR. Kjo tregohet në dokumentin nr.6, Rregullore e FBU, neni 19 dhe 20. ZSS merret me Administrimin e dokumentacionit lidhur me pikët minimale dhe maksimale për pranimin e studentëve në programin e studimit Bachelor, si dhe informacionin lidhur me studimet, procesin mësimor ecurinë e tij deri në diplomim (dokumenti nr. 9). Në bazë të dokumentit nr. 15, studentët pajisen me suplementin e diplomës i cili është bazuar mbi modelin e hartuar nga Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës dhe UNESCO/CEPES.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në zbatim të Ligjit 80/2015, neni 74, FBU-ja ndjek procedurat për informimin e maturantëve të cilët duan të ndjekin studimet në programin e studimit IAU në DTU. Po sipas këtij Ligji 80/2015, neni 74, UBT-ja me vendim rektorati dhe miratim Senati Akademik vendos kriteret e pranimit të studentëve. Strukturat që ndjekin zbatimin e vendimit janë Zv/Rektori për Mësimin, DZHKKVI, ZSS dhe QKA. Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), qëllimi kryesor i së cilës është mbështetja dhe orientimi i studentëve lidhur me karrierën e tyre. Në bazë të dokumentit nr. 6, neni 25/1, programi i studimit mund të ndiqet nga shtetas shqiptarë, shqiptarë etnike jashtë kufijve shtetërore si dhe nga çdo shtetas i huaj, në bazë të kritereve të përcaktuar nga MASR, statuti i UBTs dhe rregullorja e studimeve të FBU-së.</p> <p>Kandidatët fitues regjistrohen në sekretarinë mësimore të fakultetit, pasi kanë dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm juridik, dhe mandat pagesën e tarifës së regjistrimit në UBT (dokumenti nr. 6, neni 26/2/4).</p> <p>Studentët regjistrohen në sistemin elektronik të sekretarisë, që do t'u shërbejnë atyre për të parë të gjithë informacionin në lidhje me procesin mësimor dhe rezultatet e arritura (dokumenti nr. 9 dhe nr. 47.3).</p> <p>Studentët kanë të drejtë të përdorimit të librarisë online dhe websitet e pedagogëve (dokumenti nr. 47.2).</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, senati i UBT, sipas propozimeve të departamenteve dhe fakulteteve, konfirmon kriteret e pranimit për të gjitha programet dhe ciklet e studimeve, si dhe kuotat përkatëse dhe ja propozon MAS. Bazuar në Rreg. BCH (Ref. 7-3 neni 5) sipas Rreg UBT neni 47 pranimi në programin e studimit IAU DTU është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar gjimnazin e përgjithshëm apo të profilizuar (profilet: Teknologji ushqimore, hoteleri turizëm), apo dhe gjimnazë të profilit shkencore dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara. Kjo tregohet në dokumentin nr.7, Rregullore e Programit te studimit bachelor neni 5 dhe jo 7. Kriteret e pranimit në një PS të ciklit të parë janë (dokumenti i dorëzuar nr. 7, neni 7):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kriteri i mesatares</li> <li>- përparësi do kenë studentët që kanë mbaruar gjimnaze të profilit teknologji ushqimore apo hoteleri turizëm,</li> <li>- përzgjedhja do të bëhet mbi bazën e mesatares së gjimnazit dhe provimeve të maturë.</li> </ul> <p>Studentët dhe të interesuarit për vlerësimin e dijeve deri në diplomim mund të aksesojnë informacionin e kërkuar në dhe website UBT dhe në llogarinë personale të secilit student ne sistemin online ESSE3 (dokumenti i dorëzuar nr. 39).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Në çdo vit akademik Senati i UBT, i propozon për miratim MAS kriteret e pranimeve të aplikantëve/maturantëve për të vijuar studimet në UBT. Në këtë kuadër, pranë shkollave të mesme promovohet njësia, programet e studimit që njësia ofron si edhe jepet informacion rreth kriterëve të pranimit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Në rregulloren e FBU, si edhe në rregulloren e studimeve të DTAU, parashikohen dhe përshkruhen në mënyrë të qartë, procedurat e pranimit të studentëve. Kjo tregohet në dokumentat nr. 6, nr. 7 dhe Shembull kriteret e pranimit në FBU, nr. 44.3. Gjithashtu, Njësia bazë në koordinim me QKA, si edhe Zyrën e Karrierës së Studentëve (ZKS) pranë FBU-së, në mënyrë të përvitshme përgatit paketën e informacionit orientues, publikon: - broshurën e programit të studimit,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- fletpalosjen e FBU,</li> <li>- fletpalosjen e Qendrës së Karrierës,</li> <li>- letpalosjen e UBT,</li> <li>- guida e studimeve në FBUetj.</li> </ul>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Këto materiale u vëzhguan gjatë vizitës së GVJ. FBU-ja në bashkëpunim me QKA, çdo vit përgatit paketën e informacionit orientues për aplikantët/maturantët të interesuar për të aplikuar në programin e studimit DTAU. Në portalin e U-Albania edhe në ëebsite të UBTsë janë të publikuara programet e studimit, kuotat si edhe kriterëve të pranimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>✓</p>
<p><b>Standardi V.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b></p>				

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në dokumentet e dorëzuara Rregullore e FBU (nr. 6, neni 27 Kohëzgjatja e studimeve dhe neni 28 Kushtet e kalimit në vitin pasardhës) dhe Rregullore e Programit të studimit Bachelor (nr. 7, neni 17).</p> <p>Institucioni informon të gjithë studentëve që ndjekin programin e studimit në DTAU, për të dhënat e nevojshme rreth modulit, kreditet, mënyra e vlerësimit, elementet e vlerësimit, përmbajtja e lëndës, etj. Studentët mund të marrin informacion ose nëpërmjet faqes së website të UBT-së, ose nëpërmjet ZSS. ZSS ka për detyrë të kujdesen për informimin e studentëve mbi shërbimet dhe dokumentacionin e nevojshëm si edhe informimin e studentëve për diplomim.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit bën ekuivalentimin e pjesëve ose programeve të plota të studimit ose diplomave të marra në Institucione të tjera të vendit ose të huaja, mbas paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm nga të interesuarit. FBU ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UBT apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta, ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar Rregullore e FBU, nr. 6, neni 68.</p> <p>FBU ofron mundësi për transferime të studentëve në vite të ndërmjetme midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitetet të tjera, sipas procedurave të parashikuara. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar Rregullore e FBU, nr. 6, neni 69.</p> <p>Studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve apo të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre nëpërmjet ZSS në nivel universiteti dhe nga ZKS në nivel Fakulteti. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar Rregullore e ZSS, kreu V dhe VI.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, studentit i lind e drejta e hyrjes në provim, pasi pedagogu i disiplinës ia ka komunikuar atij këtë të drejtë në orën e fundit të mësimin. Format e kontrollit janë provimi dhe kologiumi. Vlerësimet negative në projektet dhe detyrat e kursit janë penguese për hyrjen e studentit në provimin e radhës. Vlerësimet negative për veprimtaritë e tjera formuese para provimit nuk janë penguese për futjen e studentëve në provim. Emrat e studenteve që kanë fituar të drejtën për të hyrë në provimin e disiplinës pasqyrohen në Pasqyrën e Rezultateve të Detyrimeve dhe Provimit, një kopje të së cilës e dorëzon në sekretarinë e ZKS që nënshkruhet nga sekretarja përkatëse e ZSS-së, Përgjegjësi i ZSS-së, përgjegjësi i departamentit dhe pedagogët që përbëjnë komisionin e provimit. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar Rregullore e ZSS, nr. 9, neni 55 – 59. Kjo pasqyrë mban vulën e ZSS-së (dokumenti nr. 9, Aneksi 4). Studentët që nuk kanë hyrë në provim për shkak të mos realizimit të detyrës apo projektit</p>

	<p>të kursit kanë të drejtë të bëjnë shlyerjet e tyre në javën e parë të shtatorit. Informimi i studentëve lidhur me vlerësimin e dijeve bëhet nëpërmjet sistemit ESSE3, ku studentët kryejnë veprimet dhe marrin informacion në llogaritë e tyre. Kjo tregohet në dokumentat e dorëzuar nr. 47.1 dhe 47.2.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Sipas raporti të GVB, në rregulloren e FBU dhe rregulloren e DTAU paraqiten kriteret e nevojshëm që duhet të plotësoj një student para se të hyjë në provimin e formimit. Në këto rregullore pasqyrohen qartë procedurat dhe sanksionet para provimit të formimit. Kjo tregohet në dokumentat e dorëzuar Rregullore e FBU nr. 6 (neni 58 dhe 63) dhe në Rregullore e programit të Studimit Bachelor nr. 7 (neni 19-23).</p> <p>Gjithashtu pasqyrohet informimin që duhet të realizojë departamenti që në muajin e parë të fillimit të vitit akademik i cili nëpërmjet sekretarisë mësimore duhet të informoj studentët e vitit të fundit rreth procesit dhe procedurave të provimit të formimit. Në dokumentin nr. 66, paraqitet një Shembull i Komision Provim Formimi dhe diplomave i aprovuar në 2018, për këtë departament. Në dokumentin nr. 15 jepet urdhëri nga MAS për rregjistrimin e diplomave. Në dokumentin nr. 15.1 jepet shembull Diploma Supplement TU BACH.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Para çdo fillimi viti akademik UBT dhe FBU përdor metoda dhe mjete për të udhëzuar publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të programit të studimit për ciklin e parë të studimit në IAU pranë DTAU. Në çdo vit akademik Senati i UBT, i propozon për miratim MAS kriteret e pranimeve të aplikantëve/maturantëve për të vijuar studimet në UBT. Në këtë kuadër, pranë shkollave të mesme promovohet njësia, programet e studimit që njësia ofron si edhe jepet informacion rreth kriterëve të pranimit. Në çdo fillim viti akademik, drejtuesi i njësisë bazë dhe stafi akademik organizon një takim informues me studentët e kursit të parë, lidhur me vijimin e studimeve të tyre dhe mundësive të zhvillimit të karrierës.</p> <p>Procedura e pranimit të studentëve tregohet në dokumentat Rregullore e FBU nr. 6, Rregullore e programit të studimit Bachelor nr. 7 dhe Shembull kriteret e pranimit në FBU, nr. 44.3. Gjithashtu, Njësia bazë në koordinim me QKA, si edhe Zyrën e Karrierës së Studentëve (ZKS) pranë FBU-së, në mënyrë të përvitshme përgatit paketën e informacionit orientues, publikon: - broshurën e programit të studimit,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- fletpalosjen e FBU,</li> <li>- fletpalosjen e Qendrës së Karrierës,</li> <li>- letpalosjen e UBT,</li> <li>- guida e studimeve në FBUetj.</li> </ul> <p>Këto materiale u vëzhguan gjatë vizitës së GVJ, në dokumentacionin e dorëzuar (dokumenti nr. 51). FBU-ja në bashkëpunim me QKA, çdo vit përgatit paketën e informacionit orientues për aplikantët/maturantët të interesuar për të aplikuar në programin e studimit DTAU. Në portalin e U-Albania edhe në website të UBTsë janë të publikuara programet e studimit, kuotat si edhe kriterëve të pranimit.</p>

	Në ambientet e kampusit, janë të afishuara Banera nëpërmjet të cilave studentët dhe të tjerë të interesuar, mund të informohen në mënyrë të përmbledhur rreth programit të studimit të DTAU. ZKS pranë FBU, ka për detyrë të orientoj, informoj të interesuarave për të vijuar studimet pranë njësisë bazë FBU. Kjo tregohet në dokumentin Rregullore e DSHKKVI, neni 41.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentet mund të marrin informacionin nëpërmjet website të Fakultetit apo UBT ose pranë sekretarive ZSS. Studentët informohen rreth rregullores së programit të studimit, rregullores të fakultetit, me anë të fletëpalosjeve dhe broshurave informohen për strukturën, organizimin dhe programin e studimit, kreditet përkatëse dhe kohëzgjatjen e rregullt të studimeve. Kjo tregohet në dokumentat Rregullore e FBU nr. 6, Rregullore e programit të studimit Bachelor nr. 7.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në çdo fillim viti akademik FBU dhe DTAU ju vë në dispozicion studentëve të programit të studimit IAU, informacionin rreth kurrikulës mësimore, planit mësimor, praktikat profesionale, planit kalendarik, kreditet, semestri kur zhvillohet moduli, orari, etj. Ky informacion mund të gjendet pranë sekretarisë mësimore të departamentit (dokumenti nr. 9, Rrgullore e ZSS), në sitet e stafit (dokumenti nr. 47.1), si dhe në formë elektronike dhe fizike pranë arkivës së departamentit (Dokumenti nr.7).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Informimin e studentëve lidhur me punësimin e ardhshëm të tyre, e kryen ZKS pranë fakultetit. ZKS ndjek punësimin e të diplomuarve në fakultet dhe jep informacion me shkrim pranë dekanit të fakultetit. Kjo zyrë organizon panairt e punës dhe ndihmon në orientimin e studenteve në tregun e punës. Kjo tregohet në Rregulloren e ZSS, nr. 9, neni 7. Në bazë të këtij orientimi qëndron lidhja institucionale që FBU ka me shume biznese dhe institucione, me të cilat ka marrveshje bashkëpunimi. Kjo tregohet në Raportin e fundit periodik analitik i Praktikave 2016-2017, nr. 35.
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në FBU është ngritur një sistem i organizuar informacioni për të transmetuar tek studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor. Kjo tregohet në Rregulloren e FBU, nr. 6, neni 100/a. Gjithashtu, Njësia bazë në koordinim me QKA, si edhe Zyrën e Karrierës së Studentëve (ZKS) pranë FBU-së, në mënyrë të

	<p>përvitshme përgatit paketën e informacionit orientues, publikon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- broshurën e programit të studimit,</li> <li>- fletpalosjen e FBU,</li> <li>- fletpalosjen e Qendrës së Karrierës,</li> <li>- fletpalosjen e UBT,</li> <li>- guida e studimeve në FBUetj.</li> </ul> <p>Këto materiale u vëzhguan gjatë vizitës së GVJ në dokumentacionin e dorëzuar (dokumenti nr. 51). FBU-ja në bashkëpunim me QKA, çdo vit përgatit paketën e informacionit orientues për aplikantët/maturantët të interesuar për të aplikuar në programin e studimit DTAU. Në portalin e U-Albania edhe në ëeb-site të UBTsë janë të publikuara programet e studimit, kuotat si edhe kriteret e pranimit. Kjo tregohet në dokumentat Rregullore e FBU nr. 6, Rregullore e programit të studimit Bachelor nr. 7.</p> <p>Vendimet e rëndësishme të marra nga Senati Akademik, Këshilli i Administrimit, Rektorati dhe dekanati në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, të studentëve, rezultatet e analizave të bëra, etj., u bëhen me dije studentëve në forma të ndryshme si takime të drejtpërdrejta me studentët, shpalljeve në mjediset e caktuara të universitetit, njoftimeve në “website”, etj.</p>			
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance. Kjo mundësohet nëpërmjet website të FBU dhe website i pedagogut, në këto website gjenden: Programit Mësimor përkatës, Programi i Studimit, Përmbajtja e moduleve, ndarja e lëndëve në semestra, kreditet respektive etj. Kjo tregohet në dokumentin nr. 47.1, kurse dokumenti nr. 47 mungon.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	<p>UBT dhe FBU disponon struktura që përgjigjen për ruajtjen e dokumentacionit në letër lidhur me studentët që nga fillimi deri në përfundim të studimeve sikurse janë: Regjistri Themeltar i Studentëve, Regjistri i Arritjeve Akademike, Regjistri i Dhënies së Diplomave dhe Çertifikatave. (Dokumenti nr. 9, Rregullore e ZSS, kreu 6, pika 4)</p> <p>FBU-ja nëpërmjet të dhënave që merr nga ZKS, harton raporte vjetore lidhur me shkallën e kalueshmërisë dhe nr e studentëve të diplomuar. Dokumenti i cituar në referenca nr.37.1, Analizat</p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>mësimore kërkimore FBU 2014-2018, nuk është në dokumentat e dorëzuara, por vetëm viti 2016-2018.</p> <p>Sipas rregullores së sekretarisë mësimore (dokumenti nr. 9), ZSS ka për detyrë të zbatojë plotësimin e evidencave standarte sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara nga MASR dhe UBT. Ky dokumentacion ruhet në regjistrat e sekretarisë mësimore, në bazën e të dhënave të sistemit ESS3 dhe në raportin e analizës mësimore–dokument që përgatitet çdo vit. ZSS disponon regjistra bazë për të dhënat personale të studentëve (që nga krijimi i tij në 1951 në formë shkresore) dhe që nga 2007 i disponon ato në formë shkresore dhe elektronike. Dokumenti nr. 27.2 tregon evidencën e studentëve të regjistruar total në Bachelor TAU:</p> <p>2014-2015 të regjistruar 475 studentë;  2015-2016 të regjistruar 554 studentë;  2016-2017 të regjistruar 455 studentë;  2017-2018 të regjistruar 466 studentë  dhe 2018-2019 të regjistruar 404 studentë.</p> <p>Në dokumentin nr. 27 tregohet numri i Studentëve të Diplomuar në Bachelor nga 2013-2018:</p> <p>në 2013-2014 janë diplomuar 83 studentë;  2014-2015 janë diplomuar 69 studentë;  2015-2016 janë diplomuar 145 studentë;  2016-2017 janë diplomuar 76 studentë  dhe 2017-2018 janë diplomuar 99 studentë me kohë të plotë. Dokumenti nr. 27.1 tregon studentë të regjistruar 2014-2019, 35 studentë gjithsej.</p> <p>GVJ zhvilloi takim në Sekretarinë mësimore dhe pa nga afër Rregjistrin Themeltar të studentëve, Rregjistrin e notave dhe atë të diplomimit.</p> <p>Sipas të dhënave të marra nga Rregjistri themeltar, rezultojnë se: për vitin akademik 2016-2017 – 88 studentë janë regjistruar për herë të parë në vitin e parë; 3 studentë janë larguar; të gjithë janë të matrikulluar. Gjithsej janë 98 studentë së bashku me studentët që janë me Vendim dekanati dhe Rektorati.</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018 - 103 studentë janë regjistruar për herë të parë në vitin e parë; 5 studentë janë larguar; vetëm 1 student është i pamatrikulluar, pasi është regjistruar dhe nuk është paraqitur. Gjithsej janë 117 studentë së bashku me studentët që janë me Vendim dekanati dhe Rektorati.</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 - 104 studentë janë regjistruar për herë të parë në vitin e parë; nuk ka studentë të larguar; vetëm 2 studentë janë të pamatrikulluar.</p>
--	---

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>ZSS ruan informacion për ecurinë e studentit nga njëri vit akademik në tjetrin deri në diplomimin e tyre. ZSS bën regjistrimin e studentëve dhe mbajtjen e bazës së të dhënave mbi studentët dhe rezultatet e tyre, në formë shkresore dhe elektronike; mban dokumentacionin mbi procesin mësimor dhe ndjek ecurinë së procesit mësimor; Plotëson dhe dorëzon diplomat; Plotëson dhe dorëzon diplomat suplement; Lëshon vërtetim me foto si dokument zëvendësues për diplomën; Lëshon vërtetim mbi ciklin e studimeve dhe e shoqëron atë me listën e notave; Harton pasqyrën e rezultateve të detyrimit dhe provimit në bashkëpunim me departamentet; U jep informacion studentëve lidhur me kërkesat e tyre për transferim nga një fakultet në tjetrin. Kjo tregohet në rregulloren e ZSS, kreu i V dhe VI.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sipas Statutit të UBT (dokumenti nr.2), të dhënat statistikore të studentëve menaxhohet nëpërmjet Zyrës së Informacionit dhe Statistikës dhe Zyrës së Studimeve dhe Studentëve. Të dhënat statistikore gjenden në dy forma në atë të shkruar dhe atë të dixhitalizuar. Dokumenti nr. 27.2 tregon evidencën e studentëve të regjistruar total në Bachelor TAU. Në dokumentin nr. 27 tregohet numri i Studentëve të Diplomuar në Bachelor nga 2013-2018. Dokumenti nr. 27.1 tregon studentë të cregjistruar 2014-2019. Njësoj si tek kriteri 2, më lart.</p> <p>ZKS e UBT mban lidhje të rregullta institucionale me MA, me Agjencinë Kombëtare të Provimeve, pranë MAS dhe INSTAT, duke përpiluar evidencat në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- nr. e studentëve të regjistruar për cdo cikël studimi,</li> <li>- nr. e studentëve që trajtohen me bursa,</li> <li>- përfundimet vjetore dhe</li> <li>- diplomimet e studentëve</li> </ul> <p>për çdo cikël dhe formë studimi. Kjo tregohet në Rregulloren e ZSS (dokumenti nr.9, kreu 6) dhe Rregulloren e DIOKS (dokumenti nr. 9.1, neni 6).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti mbledh të gjithë informacion nga ZSS dhe përpilon raportin analitik periodik mësimor dhe atë kërkimor. Në këtë raport paraqiten të detajuar problematikat që lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- studentët e rinj plotësimin e kriterëve sipas vitit akademik (dokumenti nr. 27, në bazë të dokumentit nr. 27.3 (nota mesatare e studentit)),</li> <li>- ecurinë dhe kalueshmërinë e studentëve (Dokumenti i cituar në referenca nr.37.1, Analizat mesimore kerkimore FBU 2014-2018, nuk është në dokumentat e dorëzuara, por vetëm viti 2016-2018),</li> <li>- mundësitë e punësimit sipas kërkesave të tregut për specialistë në fushën e ushqimit,</li> <li>- reflektimin lidhur me problematikat e hasura për realizimin e objektivave të ndërmarra në fillim të vitit akademik dhe marrjen e masave për realizim e tyre në vitin pasardhës.</li> </ul> <p>Këto raporte pasqyrohen në analizën vjetore të FBU-së, informacion që është i aksesueshëm për të gjithë stafin akademik pasi ai kalon për miratimin në Rektorat. Raportet e dorëzuara duhet të jenë në përputhje me RVB.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje të plotë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazur tek Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, cili paraqitet edhe tek statusi i UBT, është ngritur Këshilli i Studentëve (dokumenti nr. 2, kapitulli 9, neni 65). Studentët kanë të drejtë të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në institucionin e arsimit të lartë në kuadër të pjesëmarrjes së tyre në përbërjen e Senatit Akademik në masën 10%. Kjo tregohet në Statutin e UBT, kreu III, Neni 5, por tregohet edhe tek kapitulli 9, neni 64. Njëkohësisht, në përputhje me Statutin e UBT, studentët përfaqësojnë si anëtarë me të drejtë vote në dy komisione: Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, së Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor dhe Komisionit të Etikës, në rang Fakulteti dhe Universiteti. Kjo tregohet në Statutin e UBT, Neni 16. Në dokumentin nr. 30.1, tregohet Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, së Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor i zgjedhur në 2016, ku anëtari i pestë është student E. H. (210 vota, 43 kundër). Ndërsa në Komisionin e Etikës, student K. S. Gjithashtu, lidhur me nismën Pakti për Universitetin të vitit 2019, studentët ju jepet e drejta të përfaqësohen me një antarë të zgjedhur edhe në Bordin e Administrimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në zbatim të ligjit për arsimin e lartë, fakulteti dhe departamenti parashikon të përfshijë studentët në organizimit të zgjedhjeve që realizohen çdo katër vjetë në universitet, gjithashtu studentet angazhohen edhe në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. UBT dhe FBU mbështesin këshillat e tyre duke financuar veprimtarinë e tyre në komisione. Kjo tregohet në Statutin e UBT, Neni 16. Siç e kemi paraqitur edhe në kriterin e mësipërm: në dokumentin nr. 30.1, tregohet Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, së Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor i zgjedhur në 2016. Studentët shprehin opinionin e tyre për planet mësimore, programet mësimore, modulet, përmbajtjen e moduleve, rregulloren e studimeve. Studentët marrin pjesë edhe në procesin e vlerësimit të brendshëm të Fakultetit (dokumenti nr. 3.2 Raporti i vlerësimit të brendshëm FBU 2018, kapitulli 8, 8.7 dhe 8.8) dhe të Universitetit (dokumenti nr. 3.1 Raporti i analizës së veprimtarisë UBT 2018).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në</p>	<p>Bazuar në rregulloren e departamentit, neni 3, dhe neni 8 në procesin e hartimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, departamenti merr parasysh ngarkesën akademike të studentëve.</p>

<p>programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i Studimit IAU në DTAU zhvillohet në harkun kohor të tre viteve akademike, gjashtë semestre dhe në fund të vitit të tretë provim formimi për diplomim. Sipas RVB, ngarkesa akademike për këtë cikël studimi është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 625 orë leksione</li> <li>- 450 orë seminare, ushtrime, punë laborator</li> <li>- 375 orë teza e diplomës</li> <li>- Provim për çdo lëndë</li> </ul> <p>Shpjegimi në standardin II.4, kriteri 4.</p> <p>Shuma e përgjithshme e orëve të mësipërme është 3224 orë, e barabartë me 180 kredite.</p> <p>Vlerësimi i studentit realizohet gjatë semestrit në raportin: 60% vlerësimi i cili përfitohet nga provimi përfundimtar dhe 40% vlerësimi i cili përfitohet nga provimet kolegiumet, detyrat apo projektet e kursit.</p> <p>Për të gjithë studentët që kërkojnë të transferojnë studimet ose kërkojnë të vazhdojnë një program të dytë studimi të njëjtë ose të ngjashëm, FBU bën ekuivalentimin e moduleve ose programeve të plota të studimit ose diplomave të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja mbas paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm nga të interesuarit. Dokumenti nr. 5, Rregullore e Studimeve Universitare.</p> <p>Në Rregulloren e FBU (dokumenti nr. 6, neni 28) përcaktohen kushtet e kalimit në vitin pasardhës brenda programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të dorëzuar nr. 2 (Statuti i UBT, neni 65) dhe nr. 6 (Rregullore FBU, neni 96), Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Sipas rregullores së studimeve, në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi. Kjo tregohet në dokumentin nr. 40, Pyetësor për studentët Format Tip, por duhet të ishte vetëm për Bachelor profilin Teknologji Agroushqimore. Në dokumentin 40.1, paraqiten komisionet e aprovuara nga dekani për kryerjen (4 anëtarë) dhe vlerësimin e tyre (6 anëtarë).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në bazë të raportit të GVB, departamenti ju mundëson studentëve barazinë e vlerësimit dhe kontrollit nëpërmjet: regjistrin të pedagogut, pasqyrën e vlerësimit, hedhjen e pikëve të vlerësimit, të gjitha këto të dhëna pasqyrohen në sistemin ESSE3. Dokumenti i dorëzuar nr. 47.1.</p> <p>Dokumenti i dorëzuar nr. 6, Rregullore e FBU, neni 65, paraqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studenti ka të drejtë të ankohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, ose brenda 24 orëve pas kontestimit të rezultatit dhe i drejtohet dekanit të FBU.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjësin e departamentit përkatës, komisionin e provimit si dhe vetë studentin.</li> <li>- Dekani përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës.</li> <li>- Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studentin është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjësin e Departamentit, që studentin të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve.</li> <li>- Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Sipas raportit të GVB, FBU ka ngritur një sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit përcakton standartet që kanë në lidhje me përgatitjen, organizimin dhe administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Kështu në Rregulloren e UBT si dhe në Rregulloren e Studimeve BCH janë përcaktuar qartë kushtet dhe procedurat e pranimit të studentëve në këtë PS. Kjo paraqitet në dokumentin nr. 6, Rregullore e FBU, kreu IV (Studimet e Ciklit të parë në FBU); në dokumentin nr. 9, Rregullore e ZSS, pika 2; në dokumentin nr. 7, Rregullore e programit të studimit Bachelor, neni 5, 6, 7 (numri 293 tek referencat mungon).</p> <p>Sipas dokumentit nr. 9, Rregullore e ZSS, Zyra e studimeve dhe studentëve kryen dhe ndjek çdo procedurë të studentit, që nga regjistrimi i tij deri në diplomim. ZSS është pjesë përbërëse e strukturës organizative e UBT-së, miratuar si e tillë në mbledhjen e SENATIT me vendimin nr. 14, datë 28.12.2001. Në bazë të dokumentit nr. 9.1, përveç ZSS, pranë FBU funksionon edhe ZKS (Zyra e Karrierës dhe Studentëve), detyrat e të cilit përcaktohen qartë. Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), qëllimi kryesor i së cilës është mbështetja dhe orientimi i studentëve lidhur me karrierën e tyre.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (DZHKKVI), dhe Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive (DITNJ), ndjekin procesin mësimor për ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Kjo tregohet në dokumentin nr 12, Rregullore e DZHKKVI (e cila është përsëritur dy herë në referenca), neni 3. Kjo degë është pjesë përbërëse e

	<p>strukturës organizative të UBT dhe funksionon si njësi ndihmese e rektoratit. Dega, varet nga Rektori i Universitetit dhe ka lidhje të drejtpërdrejta me Zëvendës-rektorin për problemet e mësimi.</p> <p>Sipas Rregullores së Studimeve universitare të FBU neni 19 i cili mbeshtetet tek Ligjit i arsimit të lartë, Nr. 80/2015, neni 69 pika 1, studentet ndjekin studime me kohë të plotë në programin e studimit IAU në Departamentin e Teknologjisë Agroushqimore.</p> <p>Shpjegimi i mëposhtëm mendojmë se duhet në kriterin 2 dhe jo tek 3, sepse lidhet me procesin mësimor dhe programin e studimit. Në varësi të këtyre degëve funksionojnë zyra të veçanta si: ZKS, Veprimtaria e të cilës përfshin studimet, studentët si dhe koordinimin e tyre (Rregullore DZHKKVI, nr. 12-13, neni 14 dhe 15). Zyra e Mësimi dhe Kurrikulave e cila ndjek me përgjegjësi problemet që lidhen me mësimin dhe merret me përgatitjen e programeve të reja të studimit për të gjitha ciklet e studimit, si dhe realizon rishikimin periodik të programeve ekzistuese që ofrohen në UBT (Rregullore DZHKKVI, nr. 12-13, neni 19 dhe 20).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimi Institucional (DZHKKVI), dhe Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive (DITNJ), ndjekin zhvillimin e karrierës për ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Kjo tregohet në dokumentin nr 12, Rregullore e DZHKKVI (e cila është përsëritur dy herë në referenca), neni 3, 5. Sipas nenit 2 të kësaj rregullore degët janë pjesë përbërëse e strukturës organizative të UBT dhe funksionon si njësi ndihmese e rektoratit. Degët, varen nga Rektori i Universitetit dhe ka lidhje të drejtpërdrejta me Zëvendës-rektorin për problemet e mësimi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në bazë të dokumentit nr. 9.1, përveç ZSS, pranë FBU funksionon edhe ZKS (Zyra e Karrierës dhe Studentëve), detyrat e të cilit përcaktohen qartë. Në FBU, ZKS është përgjegjës për ndjekjen e punësimit të diplomuarve në fakultet. Specialisti i ZKS jep informacion me shkrim në dekanatin e fakultetit. Është përgjegjës për marrëdhëniet e fakultetit me studentët e diplomuar në procesin e punësimit si edhe vendos marrëdhëniet me tregun e punës dhe institucionet e punësimit për profilet që përgatit fakulteti. Në drejtim të punësimit të studentëve me shumë vlerë kanë qënë edhe rekomandimet personale të stafit akademik për studentët, si garanci për punësimin e tyre.</p> <p>Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), qëllimi kryesor i së cilës është mbështetja dhe orientimi i studentëve lidhur me karrierën e tyre, duke shërbyer si një nyje ndërlidhëse midis studentëve të UBT dhe tregut të punës. Qendrës së Karrierës dhe Alumni është përgjegjëse për organizimin e Panairin e Karrierës. Bashkëpunon me dekanët dhe Zyrën e Karrierës të Studentëve pranë fakulteteve.</p> <p>Dokumenti i dorëzuar nr. 12-13, Rregullore DZHKKVI, neni 41, përmban pikat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitjen e paketës së informacionit orientues për aplikantët/maturantët e interesuar si edhe për studentët aktiv të UBT.</li> <li>- Organizimin e përvitshëm, pranë shkollave të mesme dhe Fakulteteve, të promovimit të programeve që ofron UBT.</li> </ul>

- Shqyrtimin dhe dhënien zgjidhje ndaj kërkesave të aplikantëve/maturantëve dhe studentëve aktiv të UBT-së.
- Plotësimin dhe përditësimin e Skedës së Punësimit për Studentët e nivelit Bachelor. Krijon një database përmbledhës për këtë informacion.
- Administrimin e web-portalit të punësimit të studentëve.
- Gjurmimin e punësimit të diplomuarve në UBT, për të paktën 3 vite mbas përfundimit të studimeve. Krijon një database përmbledhës për këtë informacion.

Në dokumentin e dorëzuar nr. 17, paraqitet një studim periodik për tregun e punës nga viti 2014-2015 dhe deri në 2018, pas përfundimit të studentëve në programin Bachelor. Nga viti akademik 2014-2015 e deri më sot, rezulton që rreth 80% e studentëve të cilët mbarojnë studimet në nivelin Bachelor vazhdojnë studimet në Master Shkencor ose në Master Profesional, ndërsa pjesa tjetër dalin në tregun e punës. Në vitin akademik 2017-2018, vetëm 17 % e studentëve janë punësuar. Nga këta 5% e studentëve punojnë në profesion si Teknolog apo Enolog dhe 12% në sektorin e shërbimeve. Në dokumentin nr. 17.1, paraqitet një shembull i Skedës së Punësimit.

Në bazë të raport të GVB, Zyra e Marrëdhënies me Biznesin (pjesë e DITNJ, dokumenti i dorëzuar nr. 12-13, neni 7) ndjek në tërësi problemet dhe problematikat e lidhura me marrëdhëniet me biznesin, ofertat për punësimin e studenteve, identifikon nevojat e bizneseve për konsulence, trajnim, kërkim shkencor, kryerjen e praktikave profesionale të studentëve. Kjo zyrë kordinon veprimtarine e saj me Zyrën e Karrierës dhe Alumni si dhe Zyrën e Divulgimit të Informacionit (dokumenti i dorëzuar, nr. 12-13, neni 36). Në dokumentin nr. 34.3 jepen qartë Marrëveshjet e Biznesit vendas dhe/ose të huaj (43 biznese) për të realizuar me sukses objektivat e lidhura me procesin mësimor. Megjithatë, në bazë të dokumentit 34.1, Formati i marrëveshjes së bashkëpunimit, nuk janë dorëzuar nga GVB marrëveshje të nënshkruara midis Fakultetit FBU dhe Bizneseve, është dorëzuar vetëm një tabelë përmbledhëse nr. 32.1.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në bazë të dokumentit nr. 2, Statuti i UBT, neni 69, tregohet se UBT është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në UBT, pranë Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave &amp; Vlerësimit Institucional është organizuar dhe funksionon Zyra e Sigurimit të Cilësisë &amp; Vlerësimit Institucional (dokumenti nr. 8, Organigrama, faqe 14). Fokusi i veprimtarisë së kësaj zyre është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Evidentimi i problematikave të lidhura me mësimin.</li> <li>b. Evidentimin dhe ndjekjen e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies.</li> <li>c. Sigurimin e bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies.</li> <li>d. Vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.</li> <li>e. Realizimi i studimeve për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Universiteti.</li> <li>f. Organizimi dhe ndjekja e zhvillimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo programi studimi.</li> <li>g. Orientimin dhe udhëheqjen metodike të procedurave të veprimit për vlerësimin e brendshëm në departamente dhe fakultete.</li> <li>h. Vlerësimin e performancës së stafit akademik. Kjo tregohet edhe në dokumentin nr. 18.1, Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë, Standardi VI.5.</li> </ul> <p>Në rregulloren e DZHKKVI dhe DITNJ, dokumenti nr. 12-13, kreu VI, tregohet organizimi (neni 22), funksionet dhe përgjegjësitë (neni 23), kompetencat (neni 24), dokumentacioni që kërkon dhe mban (neni 25).</p> <p>FBU, duke u bazuar te rregulloret e Departamenteve dhe Fakultetit (dokumenti i dorëzuar, nr. 6, neni 90) ka bërë të mundur ndërtimin e politikave dhe strukturat e saj në lidhje me cilësinë në fakultet. Rregullore e Brendshme e DTAU, nr. 6.1. Në rregulloren e FBU, neni 11 për Komisionin e Sigurimit të cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor është e paplotësuar (Kreu II, Organizimi dhe drejtimi në FBU). Në bazë të raportit të GVB, sistemi i brendshëm i menaxhimit në rang FBU realizohet nëpërmjet Komisionit të Sigurimit të cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor i zgjedhur me zgjedhje të drejtpërdrejta nga Asambleja e Fakultetit. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar nr. 30.1 dhe nr. 30.2, ku nga zgjedhjet e mbajtura në datë 20.04.2016, komisioni u përbë nga 5 anëtarë fitues (4 pedagog dhe 1 student). Në bazë të raportit të GVB, këto komisione mbajnë lidhje të drejtpërdrejta me Dekanatin, zv. Dekanin për mësimin, zv. Dekanin për Shkencën</p>



	<p>dhe Përgjegjësin e Departamentit ku zhvillohet Programi i Studimit, detyrat e të cilëve, lidhet me administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Këto detyra janë përcaktuar në Rregulloren e FBU. Kjo tregohet në dokumentin nr. 6, Rregulloren e FBU, neni 9, 15 dhe 16.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sipas GVB, në planin strategjik të FBU përcaktohen politika për sigurimin e cilësisë si njëra nga objektivat kryesorë të mbarvajtjes së procesit akademike. Kjo tregohet në dokumentin nr. 3, Plani strategjik i zhvillimit të UBT, pjesa I, pika 5.</p> <p>Rregullorja e Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit, përcakton qartë ngritjen e komisionit për realizimin e procesit të vetëvlerësimit të brendshëm të cilësisë (dokumenti nr. 6, kreu 13, neni 90-91).</p> <p>Sipas GVB, bazuar në këtë rregullore, në vitin 2018 FBU, paraqiti një raport mbi vetë-vlerësimin e brendshëm të cilësisë nga e cila rezultoi pozitive në implementimin e një sërë standardeve të sigurimit të cilësisë. Vlen gjithashtu për tu përmendur evidentimin e një numëri problematikash të fakultetit që janë përmendur në raport. Nën çështja 3.2, Kapitulli 13 tek RVV 2018 (pika 369) nuk ndodhet.</p> <p>Sipas GVB, në vitin 2016 u realizuan zgjedhjet për drejtuesit institucionale dhe e komisioneve të përheshme duke patur si referencë ligjin e arsimit të lartë të 2015. Nga këto zgjedhje u bë e mundur zgjedhja komisionit të vlerësimit të cilësisë dhe monitorimit të kurrikulave me votimin e asamblesë së fakultetit. Funkcioni kryesor i këtij komisioni është garantimi i standardeve të cilësisë së fakultetit, departamentit si dhe programeve të studimit. Në dokumentin e dorëzuar nr. 30.1 dhe nr. 30.2, tregohet se nga zgjedhjet e mbajtura në datë 20.04.2016, komisioni u përbë nga 5 anëtarë fitues (4 pedagog dhe 1 student). Gjithashtu, në kuadër të Vlerësimit të Brendshëm të FBU, është ngritur një Grup Pune që ka realizuar Vlerësimin e Brendshëm të FBU në 2018. Kjo tregohet në dokumentin nr. 3.2, ku grupi i punës përbëhet nga 10 anëtarë: 1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc. Dr. (kryetar), 6 Dr, Kancelare e FBU dhe Specialistja e Zyrës së Karrierës dhe Studentëve.</p> <p>Megjithatë, është dorëzuar dhe një dokument tjetër 30.3, Grupi i punës për vlerësimin e brendshëm në FBU 2014, me 10 anëtarë: 1 Prof. Dr. (kryetar), 1 Prof. Asoc. Dr., 2 Dr, 4 MSc, Kancelarja e FBU dhe Specialistja e Zyrës së Karrierës dhe Studentëve.</p> <p>Sipas GVB, Departamenti i TAU në fund të çdo semestri organizon pyetësorët me studentët, këto pyetësorë organizohen me qëllimin e vlerësimit të cilësisë së zhvillimit të procesit mësimor apo të programit mësimor, të cilat kanë rezultuar pozitive kundrejt cilësisë së mësimdhënies bazuar te rezultatet e pyetësorëve. Kjo tregohet në dokumentin nr. 40, Pyetësor për studentët Format Tip, por duhet të ishte vetëm për Bachelor profilin Teknologji Agrorshqimore. Në dokumentin 40.1,</p>

	paraqiten komisionet e aprovuara nga dekani për kryerjen (4 anëtarë) dhe vlerësimin e tyre (5 anëtarë + 1 studente). Pyetësi i stafit akademik dhe ndihmës akademik (dokumenti nr. 41) është dorëzuar.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Në bazë të raportit të GVB, për DTA – në është viti parë që po aplikon për akreditimin e programeve të saj mësimore nga sisteme të jashtme të vlerësimit. Në vitin 2014 është përpjekur të përcaktojë nëpërmjet përdorimit të instrumentave të duhura sigurinë dhe cilësinë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie, duke ndërtuar një grup të brendshëm për vlerësimin e cilësisë, por nuk ka patur vlerësime të jashtme apo auditime. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar 30.3, Grupi i punës për vlerësimin e brendshëm në FBU 2014, me 10 anëtarë: 1 Prof. Dr. (kryetar), 1 Prof. Asoc. Dr., 2 Dr, 4 MSc, Kancelarja e FBU dhe Specialistja e Zyrës së Karrierës dhe Studentëve. Në bazë të dokumentit të dorëzuar (nr.18), UBT në vitin 2017 është akredituar në nivel institucional me një kohezgjatje 4-vjecare me vlerësim pozitiv.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjsteve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Sipas GVB, formalizimi i politikave institucionale dhe paraqitja e procedurave përkatëse për arritjen e tyre ka qënë një nga objektivat e raportit të vetë-vlerësimit të FBU, raporti që është realizuar në vitin 2014. Dokumenti nr. 3.2 (373), nuk është për RVV FBU 2014. por për 2018. Gjatë këtyre viteve mund të themi që një pjesë e mirë e formalizimit të këtyre politikave është realizuar siç mund të përmendim lidhjen ndërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në FB (dokumenti 38.3, Raporti i Analizës Kërkimore). Në bazë të GVB, organizimin e sistemit të sigurimit të cilësisë, aktualisht në FBU realizohet nëpërmjet Komisionit të përhershëm të Sigurimit të Cilësisë i cili monitoron në mënyrë periodike mbarëvajtjen e programit mësimor. Dokumenti nr. 37.2, (Raporte Kom Sig Cil 2017-2018). Sipas GVB, për vlerësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë është përfshirë edhe pjesëmarrja e studentëve, vlerësimi i tyre është arritur nëpërmjet shfrytëzimit të metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Siç shpjegohet në kriterin 2, dokumenti nr. 40 dhe 41.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				✓

#### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjsteve të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin,	Sipas RVB, në organigramën e UBT, pranë sektorit të zhvillimit të kurrikulave dhe vlerësimit insitucional, insitucioni ka një zyrë

<p>mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>të posaçme 'Zyra e mësimit dhe kurrikulave' që ka si objekt pune rishikimin dhe vlerësimin e programeve të studimit. Kjo tregohet në dokumentin nr. 3, Plani strategjik i zhvillimit të UBT, neni 2. Zyra e Mësimit dhe Kurrikulave e cila ndjek me përgjegjësi problemet që lidhen me mësimin programet dhe kurrikulat, merret me përgatitjen e programeve të reja të studimit për të gjitha ciklet e studimit, si dhe realizon rishikimin periodik të programeve ekzistuese që ofrohen në UBT. Kjo tregohet në dokumentin nr. 12-13, Rregullore DZHKKVI dhe DITNJ, Neni 19.</p> <p>Vlen për tu theksuar së në fund të çdo viti akademik nëpërmjet komisionit të rishikimit të programit i cili është përgjegjës për këtë proces dhe që aktivizohet nga Dekani i FBU bënë vlerësimin e cilësisë dhe gjithashtu rishikimin e programit të studimit dhe rregulloreve mësimore. Kjo tregohet tek dokumenti nr. 8, Manuali I cilësisë, pjesa I, II, III.</p> <p>Sipas RVB, kjo procedurë përcaktohet qartë edhe në rregulloren e FBU për ngritjen në nivel fakulteti të komisionit të kurrikulave dhe mësimit që zgjidhet me votim në fakultete cila funksionon sipas rregullorës së zyrës së mësimit dhe kurrikulave të UBT për rishikimin periodik të programit në fund të çdo viti akademik. Dokumenti nr. 2, Statuti i UBT, Neni 16 dhe dokumenti nr. 6, neni 90.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në neni 21 të rregullores së zyrës së kurrikulës, FBU nëpërmjet komisionit të kurrikulave dhe mësimit, për shqyrtimin dhe kontrollin e herë pashershëm të programeve të ciklit të dytë, grumbullon dokumenta si: Analiza vjetore (mësimore - kërkimore), programet e lëndëve, planet mësimore, shqyrtimin e ngarkesave të stafit dhe planeve kalendarene mënyrë periodike (vjetore) dhe i arkivon në arkiven e FBU. Kjo dosje i vihet në dispozicion komisionit në momentin rishikimit të programit. Kjo tregohet në dokumentin nr. 6, neni 91 dhe në Manualin e cilësisë, pjesa V).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Për të vlerësuar ecurinë e programeve të studimeve FBU dhe departamenti i TAU përdorin metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse dhe vlerësuese (dokumenti nr. 3.2, dokumenti nr. 38.3). Pranë Zyrës së Karrierës në FBU studentët plotësojnë skedën e punësimit, duke dhënë informacione në lidhje me punësimin aktual dhe kjo shërben për të gjurmuar e punësuar ata në 5 vitet në vazhdim. Dokumenti i dorëzuar nr. 17, tregon Skedën e punësimit të plotësuar për student që kanë mbaruar PS Master Shkencor.</p> <p>Sipas RVB, një nga metodat për të paraqitur rezultatet e përfutura nga vlerësimi dhe kontrolli i mbarëvajtjes së programeve studimore në FBU është analiza SWOT e Fakultetit të Bioteknologjisë ku paraqiten rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synohen të arrihen (dokumenti nr. 3.1, Analiza SWOT, FBU).</p> <p>FBU dhe Dep. i TAU për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Në grupin e metodave të tërthorta mund të përmendim sondazhet e ndryshme kryer të studentet lidhur me programet e studimeve si dhe sondazhet të</p>

	vlerësimin të didaktikës, kurrikulës dhe të mësuarit (dokumenti 40.1 dhe 41). Në grupin e metodave të drejtpërdrejta përmendim: teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare, vlerësimin e studentëve me nota dhe pikë, vlerësimet e detyrave të kursit për të analizuar të kuptuarit konceptual të studentëve (dokumenti nr. 6, kreu 9 dhe dokumenti nr. 19)			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Sipas RVB, DTA pranë FBU në fund të çdo viti akademik dhe kalendarik paraqet raporte lidhur me ecurinë e punës të procesit akademik si: për mësimdhënien, mësimnxënien, pyetësoreve të studentëve, programet e lëndëve, etj. Këto raporte grumbullohen pranë FBU dhe bën përpunimin e tyre dhe më pas i dorëzon në Rektorat. Duke u bazuar nga këto raporte të depozituara në fund të çdo viti akademik, rektorati bën analizën (SWOT), të çdo programi studimor ku paraqiten avantazhet, disavantazhet, mundësitë dhe kërcënimet (dokumenti nr. 3.1 , Analiza SWOT, FBU); dhe rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe depozitohen tek zyra e kurrikulave dhe mësimit të UBT (dokumenti nr. 12-13, Rregullore DZHKKVI dhe DITNJ, Neni 21).			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Analiza vjetore e procesit mësimor organizohet në fund të çdo viti kalendarik nga DTA dhe i depoziton në dekanatin e fakultetit. Nga këto analiza vazhdimisht janë theksuar problematikat e procesit mësimor, lidhur me plotësimin e bazës materiale për kryerjen e praktikave mësimore. Për këtë janë realizuar diskutime në departament për plotësimin e këtyre mangësive, të cilat lidhen me fondin financiar të dhënë nga FBU për programin master të DTAU. Dokumenti i cituar në referenca nr.37.1, Analizat mësimore kërkimore FBU 2014-2018, është në dokumentat e dorëzuara. Dokumenti i dorëzuar nr. 38.5. Sipas GVJ, në dokumentin nr. 38.4, Performanca e departamenteve të FBU, duhet të ishte e shoqëruar me mënyrën e përcaktimit për performancën e mësimdhënies, kërkimit apo bashkëpunime me të tretët, rezultoni nga 146.55 deri në 30.25.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓
<b>Standardi VI.3</b>				
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	FBU është orientuar në vlerësimin e brendshëm të programit studimor në mënyrë periodike. Nisur nga ky proces si dhe nga kodi i cilësisë për arsimin e lartë (Dokumenti i cituar nr. 8.1), FBU për herë të parë në vitin 2014 bëri vlerësimin e brendshëm të cilësisë nga stafi i brendshëm i saj. Nga ky proces vetëvlerësimi u evidentuan disa nga avantazhet dhe mangësitë që karakterizojnë Fakultetin në tërësi dhe Departamentet e tij. Në këtë mënyrë Departamenti i TAU i FBU në fund të çdo viti akademik mblodh rezultatet e punës të secilit prej anëtarëve të			

	<p>stafit nëpërmjet tabelave të ngarkesave dhe performancave akademike (si tek standardi VI.2, pika 5). Informacioni i mbledhur analizohet dhe përpilohet një raport mbi të dhe dorëzohet në dekanat, nga ku ndërtohet dhe analiza mësimore-kërkimore si një indikator e cilësisë në lidhje me programet studimore dhe stafin akademik.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin e vlerësimit të programit, FBU realizon metoda të ndryshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, si dhe me tregues të matshëm(dokumenti ii dorëzuar nr. 8). Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimin të Lartë, në vitin 2016 në zgjedhjet e zhvilluara për drejtuesit e institucionit, në FBU nëpërmjet votimeve u përzgjedh Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Detyra e këtij Komisioni është të vlerësojë periodikisht cilësinë e programeve studimore dhe në rast se është e nevojshme të japë orientime për ndryshim kurrikule në vlerën 20 % për të rritur cilësinë e këtyre programeve. Kjo paraqitet në dokumentin nr. 14.3 të dorëzuar, Kurrikula e PS në vitet 2014-2018. Kurrikula ka pësuar ndryshime nga viti 2014 deri në 2019, dhe procedura për ndryshimin e tyre tregohet në dokumentat nr. 52. 1 – 4. Në dokumentin nr. 52.1, Ndryshimi i Kurrikulës BSC 2014-2019, nuk cilësohet tek tabela Ndryshimet në programin e vitit akademik 2017-2018 tek 2018 – 2019, se moduli Biokimi &amp; Gjenetikë është ndarë në dy module Gjenetikë dhe Biokimi; është shtuar moduli Bioteknologji Ushqimore; Mikrobiologji e përgjithshme &amp; Ushqimore është ndarë në dy module Mikrobiologji e Përgjithshme dhe Mikrobiologji Ushqimore, të cilat ndikojnë përbëjnë jo vetëm 7% ndryshim. Zyra e Mësimin dhe Kurrikulave e cila ndjek me përgjegjësi problemet që lidhen me mësimin programet dhe kurrikulat, merret me përgatitjen e programeve të reja të studimit për të gjitha ciklet e studimit, si dhe realizon rishikimin periodik të programeve ekzistuese që ofrohen në UBT. Kjo tregohet në dokumentin nr. 12-13, Rregullore DZHKKVI dhe DITNJ, Neni 19.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Departamenti i TAU përdor metoda të ndryshme të drejtpërdrejta vlerësimi në kuadër të realizimit dhe vlerësimit të mbarëvajtjes së programit studimor. Disa nga metodat e përdorura për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies tek studentët realizohen nëpërmjet testimeve, vlerësimit me nota edhe pikë, përvetësimi i praktikave profesionale në laboratorët eksperimental teknologjike të FBU vlerësimit të detyrave të kryera për të analizuar format e perceptimit të tyre profesional, referimeve në konferenca shkencore të punëve studimore të ideuara dhe realizuara nga vetë studentët etj. Gjatë vizitës së GVJ u konfirmuan që të gjitha Syllabuset ndodhen në departament, dhe në dokumentat online. Sipas modelit të dokumentit të dorëzuar nr 35.1 GVJ: Mendojmë që këto elemente duhet të jenë në të njëjtin format syllabusi ose programi lënde duke specifikuar ngarkesën javore në auditor për veprimtarinë formuese (leksion:</p>

	seminar/ushtime: laboratore) me temat përkatëse të leksioneve; ashtu si e parashikon VKM Nr 41 dt 24.01 2018.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Sipas GVB, në kuadër të vlerësimit të realizimit dhe vlerësimit të mbarëvajtjes së programit studimor, Institucioni dhe Departamenti i TAU përdorin metoda dhe instrumenta të tërthorta vlerësimi. Metodat e tërthorta lidhen me realizimin e pyetësorëve tek studentet, si dhe stafit akademik. Siç shpjegohet në standardin V.II, kriteri 2, dokumenti nr. 40 dhe 41. Sipas dokumentit 38.3, Raporti i Analizës Kërkimore, Indikatorët e Cilësisë, një grup pune nga Dekani i FBU, realizon sondazhe, të dhënat e përfuara nga këto sondazhe përpunohen nga grupi i punës dhe paraqitet një raport i cili dokumentohet dhe depozitohet në arkivën e FBU.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sipas GVB, FBU organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullore mësimore të tij që ka si qëllim për të përmirësuar cilësinë e programeve. Kjo procedurë kryhet nga komisionin i rishikimit të programit që aktivizohet nga Dekani i FBU. Komisioni i rishikimit të programeve vepron në bazë të rregulloreve të FBU dhe UBT për rishikimin e programeve. Të dhënat e grumbulluara ruhen në arkivën e FBU. Dokumenti i dorëzuar, nr. 6, kreu 13, neni 90-91, paraqet se FBU, duke u bazuar te rregulloret e Departamenteve dhe Fakultetit ka bërë të mundur ndërtimin e politikave dhe strukturat e saj në lidhje me cilësinë në fakultet. Rregullore e Brendshme e DTAU, nr. 6.1 është viti 2018. Në rregulloren e DZHKKVI dhe DITNJ, dokumenti nr. 12-13, kreu VI, neni 23, tregohet funksionet dhe përgjegjësitë. Në dokumentin nr. 8, Manual i Cilësisë së UBT (pjesa V), tregohen procedurat për miratimin, monitorimin dhe rishikimin periodik të programave.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Sipas GVB, statusit i UBT, neni 16 përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë për komisionet e përhershme. Bazuar te ky status, në nivel fakulteti zgjidhet komisioni i sigurimit të cilësisë dhe monitorimit të kurrikulave që ka për detyrë rishikimin e programeve që ofron fakulteti. Komisioni i sigurimit të cilësisë dhe monitorimit të kurrikulave funksionon në bazë të rregulloreve të zyrës së ZCSVI, rregulloreve të FBU dhe UBT dhe Manualit të cilësisë. Sipas GVB, në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në FBU përfshihen një sërë njësish që janë
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë	

<p>dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>pjesë integrale e fakultetit: Dekani, përgjegjësi departamentit, kancelari dhe pedagogët. Kjo tregohet në dokumentin nr. 2, Statuti i UBT i miratuar 2018; dokumenti nr. 12-13, Rregulloren e DZHKKVI dhe DITNJ kreu VI; në dokumentin nr. 6, Rregullore e FBU, neni 90-92; në dokumentin nr. 8, Manual i Cilësisë së UBT (pjesa III, pika 3.3). Në dokumentin e dorëzuar nr. 30.1 dhe nr. 30.2, tregohet se nga zgjedhjet e mbajtura në datë 20.04.2016, komisioni u përbë nga 5 anëtarë fitues (4 pedagog dhe 1 student). Gjithashtu, në kuadër të Vlerësimit të Brendshëm të FBU, është ngritur një Grup Pune që ka realizuar Vlerësimin e Brendshëm të FBU në 2018. Kjo tregohet në dokumentin nr. 3.2, ku grupi i punës përbëhet nga 10 anëtarë: 1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc. Dr. (kryetar), 6 Dr, Kancelare e FBU dhe Specialistja e Zyrës së Karrierës dhe Studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>FBU harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student. Për të siguruar integritetin akademik në fakultet në lidhje me cilësinë dhe vlerësimin e programeve në nivel fakulteti, në FBU ekzistojnë komisionet e përhershme të emertuara ‘Komisioni Etikës’ dhe ‘Komisioni i sigurimit të cilësisë dhe rishikimit të programeve’ dhe bëjnë të mundur shmangjen e çdo lloj diskriminimi që ka të bëjë me pabarazinë apo diskriminimin ndaj personelit apo studentëve dhe funksionojnë në bazë të ligjit të arsimit të lartë dhe kodit të cilësisë. Kjo tregohet në dokumentin nr. 6, Rregulloren e FBU, neni 10, 13. Ndërsa, neni 11 për Komisionin e Sigurimit të cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor është e paplotësuar (Kreu II, Organizimi dhe drejtimi në FBU). Në dokumentin nr.2, Statutii UBT, Neni 16-17, trajtohen Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, së Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor dhe Komisionit të Etikës, në rang Fakulteti dhe Universiteti. Në dokumentin nr. 8.1, Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë, Pika III.4.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në nivel programi, akreditimi po bëhet për herë të parë dhe në këtë mënyrë nuk ka patur auditime, bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm që mund të ofronin ekspertizë në lidhje me cilësinë e programit apo përmirësimin e tij. Sipas GVB, UBT u akreditua me afat 5-vjeçar në 2017. Në bazë të dokumentit të dorëzuar (nr.18), UBT në vitin 2017 është akredituar në nivel institucional me një kohëzgjatje 4-vjecare me vlerësim pozitiv. Në dokumentin nr. 3.2, Raporti i vetëvlerësimit të FBU 2018, tregohet se FBU ka realizuar në 2018 raportin e vlerësimit të brendshëm.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Sipas GVB, Analiza mësimore-kërkimore si një indikator e cilësisë në lidhje me programet studimore dhe stafin akademik, organizohet në mënyrë periodike në FBU. Kjo tregohet në dokumentin nr. 3.2, Raporti i vetëvlerësimit të FBU 2018, në dokumentin nr. 38.2, Analiza e kërkimit, Indikatorët e cilësisë dhe në dokumentin 38.3, Raporti i Analizës Kërkimore.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Sipas GVJ, në dokumentin nr. 38.4, Performanca e departamenteve të FBU, duhet të ishte e shoqëruar me mënyrën e përcaktimit për performancën e mësimdhënies, kërkimit apo bashkëpunime me të tretët, rezultoi nga 146.55 deri në 30.25. Analizat mësimore kërkimore FBU 2014-2018, është në dokumentat e dorëzuara, por vetëm viti 2015-2016 mungon. Sipas GVB, në përgjithësi një pjesë e rezultateve të punës prezantohen gjatë mbledhjeve të departamentit dhe mbledhjeve vjetore të asamblesë të FBU ku diskutohet në mënyrë transparente dhe jepet informacion për çfarë ndodh gjatë vitit akademik. Pavarësisht kësaj mënyrë publikimi të rezultateve, kjo mbetet e vetmja formë e publikimit të të dhënave lidhur me ecurinë e programit. Në dokumentin nr. 62, Njoftim mbledhje departamenti në datën 4 dhjetor 2018, për vitin akademik 2017-2018.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Sipas GVB, UBT u akreditua me afat 5-vjeçar në 2017. Në bazë të dokumentit të dorëzuar (nr.18), UBT në vitin 2017 është akredituar në nivel institucional me një kohezgjatje 4-vjecare me vlerësim pozitiv. Në nivel programi, akreditimi po bëhet për herë të parë dhe në këtë mënyrë nuk ka patur auditime, bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm që mund të ofronin ekspertizë në lidhje me cilësinë e programit apo përmirësimin e tij. Në dokumentin nr. 3.2, Raporti i vetëvlerësimit të FBU 2018, tregohet se FBU ka realizuar në 2018 raportin e vlerësimit të brendshëm ku janë evidentuar disa nga mangësitë e punës në FBU dhe kryesisht janë marrë disa masa për përmirësime që kanë të bëjnë me aspektin menaxherial.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas GVB, rishikimi periodik i programeve të studimit me qëllim përmirësimin e tij është një proces i rëndësishëm në FBU. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet komisionit të përhershëm të vlerësimit të cilësisë dhe kurrikulave i zgjedhur me votë dhe që funksionon pranë FBU. Në dokumentin nr. 8, Manual i Cilësisë së UBT (pjesa V), tregohen procedurat për miratimin, monitorimin dhe rishikimin periodik të programeve. Në dokumentin e dorëzuar nr. 30.1 dhe nr. 30.2, tregohet se nga zgjedhjet e mbajtura në datë 20.04.2016, komisioni u përbë nga 5 anëtarë fitues (4 pedagog dhe 1 student). Gjithashtu, në kuadër të Vlerësimit të Brendshëm të FBU, është ngritur një Grup Pune që ka realizuar Vlerësimin e Brendshëm të FBU në 2018. Kjo tregohet në dokumentin nr. 3.2, ku grupi i punës përbëhet nga 10</p>



	<p>anëtarë: 1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc. Dr. (kryetar), 6 Dr, Kancelare e FBU dhe Specialistja e Zyrës së Karrierës dhe Studentëve.          Megjithatë, është dorëzuar dhe një dokument tjetër 30.3, Grupi i punës për vlerësimin e brendshëm në FBU 2014, me 10 anëtarë: 1 Prof. Dr. (kryetar), 1 Prof. Asoc. Dr., 2 Dr, 4 MSc, Kancelarja e FBU dhe Specialistja e Zyrës së Karrierës dhe Studentëve. Në grupin e vitit 2014, anëtarët janë nga të gjithë departamentet, ndërsa në 2018, departamenti i Kimisë mungon. Duke marrë parasysh që PS i vitit të parë, pjesa më e madhe e lëndëve i përkasin fushës së Kimisë, duhet të ishin pjesë e grupit të punës për vlerësimin e brendshëm.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Njësoj si kriteri i parë dhe i dytë. Gjithesesi informimi i studentëve në mënyrë periodike mbetet një objektivi për vitet e ardhshme, megjithatë janë realizuar disa organizime jo të dokumentuara.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Inxhinieri Agrorshqimore” Profili “Teknologji Agrorshqimore” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Pjesëmarrja e pedagogëve në projekte kërkimore, aftësimi i tyre në procesin e kërkimit shkencor, garanton pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre maksimal në procesin mësimor dhe kompetencë profesionale.
2. Pjesëmarrja në botime e studime shkencore, botimi i monografive, artikujve shkencorë, teksteve mësimore apo studimeve të realizuara nga pedagogët; të gjitha këto ndihmojnë nëvënien e rezultateve të kërkimit shkencor në shërbim të studentëve dhe procesit akademik.
3. Kryerja e studimeve eksperimentale nga ana e studentëve në ambientet e DTA, në laboratorët shkencore që disponon, si dhe në pesë linjat pilot të instaluar në ambientet e Departamentit, si: linja për përpunimin qumështit dhe nënprodukteve, djathi, linja e prodhimit tëverës e pijeve alkoolike, vajit ullirit, bukës dhe produkte konditore; ndihmon në lidhjen e njohurive teorike me aplikimin dhe aftësimin praktik.
4. Praktika profesionale, është një modul i veçantë në programin e studimit, duke i dhënë mundësi studentëve të përfitojnë eksperiencë praktike, për të shfrytëzuar në Industrinë e përpunimit Agrorshqimor.
5. Informimi dhe komunikimi me studentet nëpërmjet sistemit elektronik të Zyrës së Sekretarisë Mësimore.

**1. Pika të dobta**

1. Programi i studimit Bachelor në IAU profile TAU, bazuar në kurrikulën nuk ka të zhvilluar shumë orientimin drejt grup lëndëve inxhinierike.
2. Ambiente të mësimdhënies të pamjaftueshme, duke pasur parasysh numrin e studentëve.
3. Institucionalizimi jo i plotë me përfitim dy palësh i marrdhënieve me operatorët e biznesit, në drejtim të përfshirjes më të madhe të studentëve në kërkimin shkencor për zgjidhjen e problematikave të ndryshme që kanë lidhje me prodhimin, ruajtjen dhe modifikimin ushqimor.
4. Financimi kufizuar nga buxheti i shtetit për realizimin e proceseve të prodhimit dhe eksperimentimit shkencor në linjat pilot, si dhe në mirëmbajtjen dhe pasurimin e laboratorëve shkencorë.

**Rekomandime**

1. Përmirësimi dhe konsolidimi i kurrikulës së Programit Bachelor në IAU profili TAU në përputhje me emërtimin e programit sipas vlerësimeve në fushat përkatëse të RVJ, duke pasur parasysh tendencat në rritje e kërkesave të tregut të punës në sektorin e industrisë agrorshqimore dhe fakti që ky nuk është programi i vetëm i studimit në këtë fushë që ofrohen nga Institucionet e Arsimit të Lartë.
2. Nevoja për zgjerim, pajisje dhe modernizim të ambienteve të mësimdhënies, duke pasur parasysh numrin e studentëve.
3. Mbështetje, nga institucionet përkatëse për zhvillimin e agropërpunimit dhe agroturizmit, nëpërmjet projekteve dhe kredive të ndryshme. Të punohet më shumë për institucionalizimin

dy palësh me biznese për të rritur numrin e pjesmarrjes së studentëve në kërkimin shkencor për zgjidhjen e problematikave të ndryshme që kanë lidhje me prodhimin, ruajtjen dhe vlerësimin e sigurisë dhe cilësisë ushqimore.

4. Të rriten mundësitë financiare dhe të shtohet buxheti për pajisje laboratorike/praktikat mësimore në funksion të rritjes së cilësisë të programit të studimit.

### **Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor “Agricultural Engineering” Program “Agricultural Technology” of Higher Education Institution “Agricultural University of Tirana”**

#### **Strengths and affirmations**

1. The participation of lecturers in research projects, their training at scientific research, guarantees their maximum participation and commitment in the teaching process and professional competence.
2. Participation in scientific publications and studies, such as articles, monographs, textbooks carried out by lecturers; all of which help to put the research results at the service of students and the academic process.
3. Conducting experimental studies by students in the areas of DTA premises, in its scientific laboratories, as well as in the five pilot lines installed in the Department; such as: milk and by-products processing line, manufacturing cheese, wine and alcoholic beverages production line, olive oil production line, bread and confectionery products processing; helps connect theoretical knowledge with practical application and training.
4. Professional practice is a special module in the study program, giving students the opportunity to gain practical experience to use in the agri-food processing industries.
5. Informing and communicating with students through the electronic system of the Education Secretary Office.

#### **Weak points**

1. Bachelor study program at IAU profile TAU, based on the curriculum has not developed much in engineering orientation.
2. Insufficient teaching facilities, taking into account the number of students.
3. Incomplete institutionalization of the bilateral benefit of relationships with business operators, in order to increase the involvement of students in scientific research to solve various problems related to food production, storage and modification.
4. Limited funding from the state budget for the implementation of production processes and scientific experimentation on pilot lines, as well as the maintenance and enrichment of scientific laboratories.


#### **Recommendations**

1. Improvement and consolidation of the IAU Bachelor Degree curriculum TAU profile according to the title of the study program according to estimates in the relevant areas of the External expert evaluation report, given the increasing labor market demand trends in the agro-food sector and the fact that this program is not the only study program in this field offered by Higher Education Institutions.
2. Need to expand, equip and modernize teaching facilities, taking into account the number of students.

3. Support from relevant institutions for the development of agro-processing and agro-tourism through various projects and loans. Efforts will be made to institutionalize bilateral partnerships with businesses to increase student participation in research to address various issues related to the production, preservation and evaluation of food safety and quality.
4. Increase funding opportunities and increase the budget for laboratory equipment / teaching practices to enhance the quality of the study program.

**Experts Evaluations**

**Prof As Laura Shabani**



**Dr Anisa Dhroso**



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Notë përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			✓	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			✓	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				✓
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				✓
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				✓
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				✓
VLERËSIMI TËRËSOR			✓	

## Aneks

### MEMO

Përgjigja e GVJ mbi Objeksionet e UBT për Draft RVJ e programit Bsc në Inxhinieri Agroushqimore me profil Teknologji Agroushqimore

GVJ i pa me kujdes të gjitha objeksionet e bërë nga UBT në lidhje me Draft RVJ. Disa prej këtyre objeksioneve, GVJ i konsideron duke bërë ndryshimin në Raportin përfundimtar, ndërsa disa të tjera nuk i konsideron duke dhënë edhe argumentin përkatës.

Paraqitja në Draft RVJ, përgjigja e Institucionit dhe përgjigja e GVJ është sa më poshtë:

1. Në pjesën hyrëse të Draft RVJ është gabuar në emërtimin e Fakultetit që ofron këtë Program studimi. Kështu, aty thuhet: *Në RVJ të paraqitur për Programin e Studimit të Ciklit të Parë në IAU Profili TAU, në faqen nr 2 paragrafi 2, fakulteti i cili ofron programin e studimit referohet si "Fakulteti i Bujqësise dhe Ushqimit"*

**Përgjigja e GVJ --** Objeksioni është i drejtë.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

2. Në Draft RVJ në përshkrimin e axhendës në takimin me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm konstatohet mungesa e studentes F.K.

*Komenti I UBT - Studentja e pranishme në takimin me GVJ ka qenë pikërisht F.K e cila aktualisht është studente e ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor në "Inxhinieri Ushqimore" profili "Teknologji Ushqimore". U përzgjedh në GVB një studente e nivelit të Dytë të studimeve, MSc në IAU në Profilin TAU, pasi u gjykua se një studente që ka kaluar me sukses Nivelin e Parë të Studimeve Bachelor në IAU Profili TAU, ka krijuar një ide të plotë për cilësinë e realizimit të këtij Programi Studimi.*

**Përgjigja e GVJ -** Objeksioni i institucionit nuk është i drejtë, sepse në takim dhe në GVB duhet të ishte prezent student aktual i BSC. Studentja në fjalë mund të japi mendimin personal ndërkohë që prezent duhet të ishte student përfaqësues i studentëve të ciklit të parë, për shembull kryetari i Këshillit Studentor për BSC, viti III që e përfaqëson mendimin e studentëve dhe në borde përkatëse.

**GVJ nuk bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar**

3. **Standardi I.1, kriteri 1** - Në Draft RVJ përmendet vetëm se Dokumenti nr.5: Rregullore e Studimeve Universitare mungon në dokumentat e dorëzuar online.

*Komenti i UBT - Dokumenti nr 5: Rregullore e Studimeve Universitare është dorëzuar gjithashtu në formatin HardCopy. Në kopjen soft copy të cilën ne kemi ruajtur, Dokumenti nr. 5 gjendet. Besojmë se qëllimi i dorëzimit të dokumentave në dy formate hard copy edhe soft copy shërben për të shmangur pikërisht ndonjë problem teknik i cili mund të lindë nga transferimi i dokumentave në mënyre elektronike nga një dosje në një dosjet jetër. Për rrjedhojë, nuk konstatohet asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigja e GVJ -** Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të RVJ vërejmë se ky dokument është paraqitur.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**4. Standardi I.1, kriteri 2** - Në Draft RVJ përmendet se dokumenti nr. 4, “Strategjia e Zhvillimit të PS Bachelor” në Inxhinieri Agroushqimore, nuk është në dokumentat e dorëzuara.

*Komenti I UBT - Në dokumentat hard copy gjendet i kodifikuar si Dokumenti nr.4 “Strategjia e zhvillimit të programeve të studimit në FBU” në të cilën është paraqitur dhe Plani strategjik i zhvillimit të PS BSC në Teknologji Agroushqimore. Në plotësim të dokumentacionit, do tju dërgojmë dhe një kopje të këtij materiali bashkangjitur kësaj oponente. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigja e GVJ** - Ky objeksion ka të bëjë me kriterin nr. 1 dhe jo 2. Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**5. Standardi I.1, kriteri 3** – Në Draft RVJ përmendet se Dokumenti nr. 48 nuk gjendet.

*Komenti i UBT - Konstatohet se dokumenti me indeks nr 48: “Politikat Institucionale të publikimit të informacionit”, (Udhëzues të posaçëm; takime të hapura; faqja e IAL në ëeb; etj), është paraqitur në formën e link-ut të faqes zyrtare të universitetit ([@ëë.ubt.edu.al](mailto:ubt.edu.al)) dhe është dorëzuar në formatin hard copy, print screen i faqes zyrtare të universitetit. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigja e GVJ** - Ky objeksion ka të bëjë me kriterin nr. 2 dhe 3. Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur. Gjithashtu, në RVJ paraqitet se: Dokumenti nr. 5, Rregullore e Studimeve Universitare (17), mungon në dokumentat e dorëzuara online. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**6. Vlerësimi i dhënë për Standardin I.1 nga GVJ është KRYESISHT**

*Komenti I UBT - Në përfundim të Standardit I.1 konstatojmë se nuk është paraqitur asnjë vërejtje objektive dhe e qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, pretendojmë që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga “Kryesisht” në “Plotësisht”*

**Përgjigja e GVJ** - Ky përfundim është arritur në bazë të dokumentave të dorëzuara. Me plotësimin e tyre nga institucioni pas hartimit RVJ, dhe hedhjen on line nga Ascal, si dhe rishikimin nga GVJ konstatojmë se dokumentat e paraqitura përputhen me vlerësimin e GVB dhe janë në mbështetje të kritereve të standardit.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtare. Vlerësimi bëhet Plotësisht**

**7. Standardi I.2, kriteri 1** - Në RVJ përmendet se në dokumentin nr. 3, në pikën 4.1, “Raporti i vlerësimit të brendshëm i FBU” tregohet se PS BCH në TAU, ka disiplina të formimit të përgjithshëm 36, formimi bazë 10, formuese integruese 23 dhe formuese si gjuhë e huaj 3, etj. Megjithatë, në dokumentin 14.2, Kurrikula e BSC në IAU 2018-2019, tregohet se

janë gjithsej 33 disiplina të formimit të përgjithshëm”

*Komenti I UBT - Mos përputhja e numrit të disiplinave në dy dokumentat vjen si pasojë e raportimit në dy vite të ndryshme në secilin raport. Në Raportin e Vetë Vlerësimit, viti 2018, raportohet për kurrikulën e vitit 2017-2018 ndersa kurrikula e paraqitur ne dokumentin 14.2 tregon kurrikulen për vitin 2018-2019.*

**Përgjigje GVJ** - Institucioni pranon këtë mospërputhje të konstatuar nga GVJ. Kjo tregon për ndryshimet në kurrikulën e programit ne tre vitet e fundit. GVJ mer të mirëqënë dhe është referuar të dhënave të paraqitur ne dokumentin 14.2 që tregon kurrikulën për vitin 2018-2019.

**GVJ nuk bën ndryshime në RVJ në lidhje me paragrafin më sipër.**

Në Draft RVJ përmendet se “dokumenti nr. 4, Strategjia Zhvillimit të PS Bachelor në Inxhinieri Agrorshqimore, nuk është në dokumentat e dorëzuara”.

*Komenti i UBT - Në dokumenta hard copy gjendet i kodifikuar si Dokumenti nr.4 “Strategjia e zhvillimit të programeve të studimit në FBU” në të cilën është paraqitur dhe Plani strategjik i zhvillimit të PS BSC në Teknologji Agrorshqimore. Në plotësim të dokumentacionit, do tju dërgojmë dhe një kopje të këtij materiali.*

**Përgjigja e GVJ** - Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**8. Standardi I.2, kriteri 2 –Paraqitja në Draft RVJ** - FBU ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në fushat e agropërpunimit dhe ushqimit, drejtime të përcaktuara specifikisht në Rregulloren e Departamentit të Teknologjisë Agrorshqimore, i cili fokusohet në fushën e zhvillimit rural dhe në fushën e politikave agrare (Kjo nuk paraqitet në dokumentin e dorëzuar nr. 6.1 (Rregullore e Brendshme e DTAU), ku është vetëm faja e parë e rregullores viti 2014)”

*Përgjigja e UBT - Për shkak të volumit të madh të dokumentacionit u gjykua e arsyeshme që në dokumentacionin e dorezuar online të vendoset vetem faja e parë e rregullores, por në formatin Hard Copy është dorëzuar një kopje e rregullores DTAU.*

**Përgjigja e GVJ** - Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, dhe hedhjen on line nga Ascal të dokumentave nga arshiva, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**9. Standardi I.2, kriteri 3 – Paraqitja në Draft RVJ** përmendet se “Dokumenti nr.5: Rregullore e Studimeve Universitare mungon në dokumentat e dorëzuar online”.

*Komenti i UBT - Gjendet në kopjen soft copy të cilën ne kemi ruajtur si Dokumenti nr.5. Dokumenti nr 5: Rregullore e Studimeve Universitare është dorëzuar gjithashtu në formatin Hard Copy. Besojmë se qëllimi i dorëzimit të dokumentave në dy formate hard copy edhe soft copy shërben për të shmangur pikërisht ndonjë problem teknik i cili mund të lindi nga transferimi i dokumentave në mënyrë elektronike nga një dosje në një dosje tjetër.*



**Përgjigja e GVJ** - Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, dhe hedhjen on line nga Ascal të dokumentave nga arshiva, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

*Komenti i UBT - Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigja e GVJ** - Në draft RVJ përfundimtare GVJ ka bërë vërejtje, konkretisht në këtë kriter shkruhet: Gjithmonë në RVB dhe dokumentat ku Institucioni (Rektorati i UBT, dokumenti nr. 1.4, Aplikim per akreditim programi) i drejtohet ASCAL për akreditimin e këtij PS, përdoret emërtimi BCH në profilin ‘Teknologji Agroushimore’. Mendojmë se është emërtim i përshtatshëm që përputhet me përmbajtjen dhe tërësinë e moduleve që zhvillohen në këtë program, duke i dhënë atij karakterin e një programi studimi që jep njohuritë bazë në fushën e teknologjive të përpunimit agroushqimor, dhe vlerësimit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Ky PS u krijon mundësi studentëve të vazhdojnë studime të thelluara ose të avancuara në disa drejtime të shkencave të ushqimit.”

GVJ këtu është shprehur dhe ka vërejtje në lidhje me emërtimin e PS. Emërtimi i PS IAU profil TAU nuk pasqyron përmbajtjen e moduleve të kurrikulës. Konkretisht 33 module gjithësej nga të cilat dy module të detyrueshme dhe një modul me zgjedhje me orientim mirëfillt inxhinerik.

**10. Vlerësimi i dhënë për Standardin I.2 nga GVJ: KRYESISHT**

*Komenti i UBT - Në përfundim të Standardit I.2 konstatojmë se nuk është paraqitur asnjë vërejtje objektive dhe e qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, pretendojmë që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga “Kryesisht” në “Plotësisht”*

**Përgjigja e GVJ** - Mbështetur në konstatimin dhe vërejtjet të kriterëve 1 dhe 3 (si më sipër) të standardit I.2, **GVJ nuk bën ndryshim në lidhje me vlerësimin e këtij standardi.**

**Vlerësimi mbetet KRYESISHT.**

**11. Vlerësimi i dhënë për Standardin I.3 nga GVJ: KRYESISHT**

*Komenti i UBT - Në përfundim të Standardit I.3 konstatojmë se RVJ nuk ka paraqitur asnjë vërejtje me Plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, kerkojmë që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga “Kryesisht” në “Plotësisht”*

**Përgjigja e GVJ** - Me plotësimin e dokumentacionit nga institucioni pas hartimit RVJ, dhe hedhjen on line nga Ascal, si dhe rishikimin nga GVJ; GVJ bën ndryshim në lidhje me vlerësimin e këtij standardi.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtare Vlerësimi bëhet PLOTËSISHT**

**12. Standardi I.4, kriteri 2** - Në RVJ përmendet se “Kodifikimi i programit të studimit të ciklit BCH në IAU, në profilin TAU bëhet bazuar në Ligjin e Arsimit të lartë 80/2015, Neni 86; UBT ka bërë kërkesën pranë MAS për kodifikimin e Programeve të Studimit, por nuk ka marrë ende konfirmim të këtij kodifikimi. Në dokumentacion, nuk është paraqitur kërkesa”.

*Komenti i UBT - Kodifikimi i programeve të studimit është një proces që NUK kryhet nga IAL apo nga Fakulteti, por nga MAS. Me sa konstatojmë, të gjitha Programet e studimit të*

zhvilluara në UBT dhe në gjithë Republikën e Shqipërisë janë në pritje të këtij kodifikimi.

**Përgjigja e GVJ** - Në draft RVJ vërejtja është: “Në dokumentacion, nuk është paraqitur kërkesa”. GVJ e pranon këtë objeksion dhe gjithashtu e merr të mirëqënë dhe dorëzimin pas hartimit të draft RVJ në dokumentacion te kërkesës nga ana e intucionit në lidhje me klasifikimin dhe kodifikimin e PS.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**13. Standardi I.4, kriteri 3 Në RVJ përmendet se** “dokumenti i dorëzuar nr. 6.1 “Rregullore e Brendshme e DTAU”, është vetëm faqja e parë e rregullores viti 2014”.

*Komenti i UBT - Për shkak të volumit të madh të dokumentacionit u gjykua e arsyeshme që në dokumentacionin e dorëzuar online të vendoset vetëm faqja e parë e rregullores, por në formatin Hard Copy është dorëzuar një kopje e rregullores DTAU.*

**Përgjigja e GVJ** - Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, dhe hedhjen on line nga Ascal të dokumentave nga arshiva, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

Në RVJ përmendet se “Kodifikimi i programit të studimit të ciklit BCH në IAU, në profilin “TAU” bëhet bazuar në Ligjin e Arsimit të lartë 80/2015, Neni 86; UBT ka bërë kërkesën pranë MAS për kodifikimin e Programeve të Studimit, por nuk ka marrë ende konfirmim të këtij kodifikimi. Në RVJ përmendet se “dokumenti i dorëzuar nr. 6.1 “Rregullore e Brendshme e DTAU”, është vetëm faqja e parë e rregullores viti 2014”.

*Komenti i UBT - Për shkak të volumit të madh të dokumentacionit u gjykua e arsyeshme që në dokumentacionin e dorëzuar online të vendoset vetëm faqja e parë e rregullores, por në formatin Hard Copy është dorëzuar një kopje e rregullores DTAU.*

**Përgjigja e GVJ** - Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, dhe hedhjen on line nga Ascal të dokumentave nga arshiva, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

Në RVJ përmendet se “Kodifikimi i programit të studimit të ciklit BCH në IAU, në profilin “TAU” bëhet bazuar në Ligjin e Arsimit të lartë 80/2015, Neni 86; UBT ka bërë kërkesën pranë MAS për kodifikimin e Programeve të Studimit, por nuk ka marrë ende konfirmim të këtij kodifikimi. Në dokumentacion, nuk është paraqitur kërkesa”.

*Komenti i UBT - Kodifikimi i programeve të studimit është një veprim që NUK kryhet nga Institucioni (UBT) apo nga Fakulteti, por nga MAS. Me sa konstatojmë, të gjitha Programet e studimit të zhvilluara në UBT dhe në gjithë Republikën e Shqipërisë janë në pritje të këtij kodifikimi.*

**Përgjigja e GVJ** - GVJ e pranon këtë objeksion dhe gjithashtu e merr të mirëqënë dhe dorëzimin në dokumentacion të kërkesës nga ana e intucionit në lidhje me klasifikimin dhe kodifikimin e PS. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, dhe hedhjen on line nga Ascal të dokumentave nga arshiva, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se vërejtjet e bëra nga GVJ në lidhje me mungesë dokumentacioni janë plotësuar nga Institucioni

**GVJ bën ndryshimin përkatës në vlerësimin në RVJ përfundimtar.**

#### **14. Vlerësimi i dhënë për Standardin I.4 nga GVJ: KRYESISHT**

*Komenti i UBT - Në përfundim të Standardit I.4 konstatojmë se RVJ nuk ka paraqitur asnjë vërejtje me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, kërkojmë që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga "Kryesisht" në "Plotësisht"*

**Përgjigja e GVJ:** GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtare për shkallën e vlerësimit të standardit I. 4. **Vlerësimi për këtë Standard bëhet PLOTËSISHT.**

**15. Standardi 1.5, kriteri 1 - Në Draft RVJ** përmendet se dokumenti i dorëzuar nr. 6.1 "Rregullore e Brendshme e DTAU", është vetëm faqja e parë e rregullores viti 2014.

*Komenti i UBT - Për shkak të volumit të madh u gjykua e arsyeshme që në dokumentacionin e dorëzuar online të vendoset vetëm faqja e parë e rregullores por në formatin Hard Copy është dorëzuar një kopje e rregullores DTAU.*

**Përgjigja e GVJ -** Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, dhe hedhjen on line nga Ascal të dokumentave nga arshiva, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar**

Në Draft RVJ përmendet se "Veprimtaria e GMK-ve monitorohet nga Përgjegjësi i DTA dhe një herë në vit kryhet analiza e punës mësimore e kërkimore e tyre. Dokumentat nr. 43.4 dhe 43.5, janë vetëm për vitin 2017-2018, dhe jo për 5 vitet e fundit".

*Komenti i UBT - Dokumentat nr. 43.4 dhe 43.5 janë paraqitur si provë e GMK- ve ekszistuese, ndërkohë informacioni për GMK të 5 viteve të fundit paraqiten në raportet vjetore mësimore-kërkimore të FBU-së (dokumenta nr 37.1 dhe 37.2)*

**Përgjigje e GVJ -** Në Draft RVJ e dorëzuar për këtë kriter shkruhet "Veprimtaria e GMK-ve monitorohet nga Përgjegjësi i DTA dhe një herë në vit kryhet analiza e punës mësimore e kërkimore e tyre. Dokumentat nr. 43.4 dhe 43.5, janë vetëm për vitin 2017-2018, dhe jo për 5 vitet e fundit, siç theksohet në indekset 63 dhe 64."

Objeksioni më sipër nuk e ka cituar të plotë RVJ. Ndërkohë dokumentat nr 37.1 dhe 37.2 që përmenden në objeksion janë raport analiza të punës mësimore-kërkimore për 2016-2017 dhe jo për 5 vitet e fundit siç e thotë objeksioni.

**GVJ nuk bën ndryshime në RVJ për këtë paragraf**

**16. Standardi 1.5, kriteri 2 Paraqitja në Draft RVJ:** "Megjithatë, në bazë të dokumentit 34.1, Formatit i marrëveshjes së bashkëpunimit, nuk janë dorëzuar nga GVB marrëveshje të nënshkruara midis Fakultetit FBU dhe Bizneseve, është dorëzuar vetëm një përmbledhëse nr.32.1".

*Komenti i UBT - Dokumentet e dorëzuara 34.1 (Formati marrëveshjes) apo lista e marrëveshjeve 32.1 tregon se pranë Fakultetit është ngjitur sistemi i bashkëpunimeve me Industrinë përkatëse. Lista 32.1 është vërtetuar nga Përgjegjësi i DTAU dhe është përpiluar mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit që ekzistojnë midis FBU dhe kompanive/insitucioneve homologe, të cilat mund të vihen në dispozicion në çdo kohë. Praktikrat profesionale të kryera në kuadër të këtij Programi Studimi vërtetojnë më së miri bashkëpunimin e DTAU/FBU me operatorë biznesi apo institucione të tjera shtetërore, Dokumenti35\_2. Në plotësim të dokumentacionit të disponueshëm lidhur me marrëveshjet e*

*bashkëpunimit midis universitetit dhe biznesit, do të bashkangjitet dhe një format i plotësuar i këtij dokumenti.*

*Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigja e GVJ** - Me dokumentat e dorëzuara në shtator, është një marrëveshje bashkëpunimi e nënshkruar midis FBU dhe fabrikës së pijeve alkoolike “GJ Kastrioti” Durrës. Vërejmë se dokumentacionin në këtë drejtim mund ta konsiderojmë të paraqitur.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar**

**17. Standardi 1.5, kriteri 3** – *Komenti I UBT - Në draft RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetet konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin.*

**Përgjigje GVJ** - Në këtë kriter në draft RVJ përfundimtare është cituar RVB, konkretisht: “Mbetet detyrë të rregullohen marrëveshjet institucionale ndërmjet Fakultetit dhe bizneseve të Agropërpunimit dhe kontrollit të cilësisë së produkteve ushqimore, për kryerjen e praktikës profesionale të studentëve, intershipit dhe një punësimi të mundshëm të tyre.

**GVJ konstaton se ka vërejtje në plotësimin e këtij kriteri të cilën e thotë vetë institucioni në RVB.**

**18. Standardi 1.5, kriteri 4** Paraqitja në Draft RVJ: “Megjithatë, në bazë të dokumentit 34.1, Formati i marrëveshjes së bashkëpunimit, nuk janë dorëzuar nga GVB marrëveshje të nënshkruara midis Fakultetit FBU dhe Bizneseve, është dorëzuar vetëm një përmbledhëse nr.32.1”.

*Komenti i UBT - Dokumentet e dorëzuara 34.1 (Formati marrëveshjes) apo lista e marrëveshjeve 32.1 tregojnë se pranë Fakultetit është ngjitur sistemi i bashkëpunimeve me Industrinë përkatëse. Lista 32.1 është vërtetuar nga Pergjegjësi i DTAU dhe është përpiluar mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit që ekzistojnë midis FBU dhe kompanive/institucioneve homologe, të cilat mund të vihen në dispozicion në çdo kohë. Praktikën profesionale të kryera në kuadër të këtij Programi Studimi vërtetojnë më së miri bashkëpunimin e DTAU/FBU me operatorë biznesi apo institucione të tjera shtetërore, Dokumenti 35\_2. Në plotësim të dokumentacionit të disponueshëm lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit midis universitetit dhe biznesit, do të bashkangjitet dhe një format i plotësuar i këtij dokumenti.*

**Përgjigja e GVJ** - Format-marrëveshja dhe lista e marrëveshjeve 32.1 nuk tregojnë detyrimisht se pranë Fakultetit është ngjitur sistemi i bashkëpunimeve me Industrinë përkatëse. Marrëveshjet duhet të jenë zyrtarizuar ose institucionalizuar nëpërmjet kontratave të nënshkruara nga të dy palët.

Me dokumentat e dorëzuara në shtator, është një marrëveshje bashkëpunimi e nënshkruar midis FBU dhe fabrikës së pijeve alkoolike “GJ Kastrioti” Durrës. Megjithatë GVJ i përmbahet vërejtjes së cituar më sipër, që mbetet detyrë të rregullohen marrëveshjet institucionale ndërmjet Fakultetit dhe bizneseve të Agropërpunimit nëpërmjet kontratave të nënshkruara dypalëshe.

**GVJ nuk bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar**

**19. Vlerësimi i dhënë për Standardin 1.5 nga GVJ: KRYESISHT**

*Komenti i UBT - Në përfundim të Standardit I.5 konstatojmë së RVJ nuk ka paraqitur asnjë vërejtje me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, kerkojmë që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga "Kryesisht" në "Plotësisht"*

**Përgjigja e GVJ -** Bazuar në komentet që GVJ ka bërë për kriteret e këtij standarti, GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtare për shkallën e vlerësimit të standardit I.5.

Vlerësimi për këtë standard është **KRYESISHT**

Me ndryshimin e vlerësimit të standarteve të fushës I shkalla e vlerësimit është dy standarte kryesisht (I.2 dhe I.5) dhe tre standarde plotësisht.

**GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare vlerësimi është Kryesisht**

**20. Standardi II.1. kriteri 1 -** Në Draft RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetet konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin. Koment në RVJ: "Në dokumentin nr. 14.1, VKM 41/2.1, nuk jepet shtojca A, por mendojmë se i referohet shtojcës Nr.2".

*Komenti i UBT - Konstatim i saktë. Ndjesë për gabimin në shprehjen e shtojcës.*

**Përgjigja e GVJ - GVJ nuk bën ndryshime në RVJ**

**21. Vlerësimi i dhënë për Standardin II.1 nga GVJ: KRYESISHT**

*Komenti i UBT - Në përfundim të Standardit II.1 konstatojmë se nuk është paraqitur asnjë vërejtje objektive dhe e qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, pretendojmë që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga "Kryesisht" në "Plotësisht"*

**Përgjigja e GVJ -** Duhet të sqarojmë se fillimisht vlerësimi është bërë me % dhe me pas u kalua në kategorizimet aktuale (vlerësimi nuk ka qënë 100%) Objeksioni dhe kërkesa e institucionit është marrë në konsideratë. GVJ është dakort që standarti II.1 të vlerësohet PLOTËSISHT.

**GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtar, vlerësimi i standardit II 1 bëhet PLOTËSISHT**

**23 – Standardi II.2, kriteri 2 –** *Komenti i UBT - Në Draft RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetet konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin. Pretendimi se "Nuk ka dokument të vendimit për emërimin e koordinatorit të PS" nuk qëndron sepse: Rregullorja e studimeve të FBU (Ref. dokumenti nr 6\_1) përcakton qartë detyrat dhe rolin e Pergjegjësit të departamentit njëkohësisht dhe koordinator i programit të studimit; konkretisht në Nenin 16, pika 6, pika 8 dhe pika 14. Në këto kushte bëhet evident roli i Pergjegjësit të Departamentit si Koordinator i çdo programi studimi që mbulon Departamenti që aidrejton. Gjithashtu, kjo mbështetet edhe në L. 80/2015: Neni 25, Pika 3 ku shprehet qartë se është departamenti organi i cili nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore. Në dokumentin nr 36.1 të dorëzuar në formatin soft dhe hard copy, paraqitet vendimi nr. 43, dt 29.04.2016, mbi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në UBT, për autoritetet drejtuese për të gjitha kategoritë, ku në faqen 2 të këtij dokumenti, gjendet emri fitues i Pergjegjësit të Departamentit të TAU, njëherësh dhe koordinator i programeve të studimit që mbulon DTAU.*

**Përgjigja e GVJ -** GVJ është dakort me objeksionet e paraqitura nga institucioni

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ**

**24. Vlerësimi i dhënë për Standardin II.2 nga GVJ: KRYESISHT**

*Komenti i UBT - Në përfundim të Standardit II.2 konstatojmë se nuk është paraqitur asnjë vërejtje objektive dhe e qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, pretendojmë që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga "Kryesisht" në "Plotësisht"*

**Përgjigja e GVJ -** Objeksioni dhe kërkesa e institucionit është marrë në konsideratë. Standarti II.2 të vlerësohet PLOTESISHT.

**GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtar standardi II.2 vlerësimi bëhet PLOTËSISHT**

**25. Standardi II.3, kriteri 4 - UBT shprehet se: Në RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetës konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin.**

**Përgjigje GVJ -** Në RVJ për këtë kriter është bërë kjo vërejtje: "Bazuar në dokumentat e dorëzuar 14.5 rezulton se në këtë PS plani mësimor ka të pasqyruar ngarkesën mësimore për çdo modul të ndarë në orë leksion: orë seminar, nuk del qartë ngarkesa në orë laborator për ato module që zhvillojnë praktika laboratorike". Me sa shihet institucioni nuk e ka marrë parasysh këtë fakt ashtu siç e kërkon dhe kriteri: planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit,

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ**

**26. Standardi II.3, kriteri 6 -** Komenti në Draf RVJ "Sipas dokumentit të dorëzuar 14.1 pika 2.8 dhe shtojca nr2. GVJ konstatoi se secili titullar lënde duhet të paraqesë në departament, planin kalendar ku ka të specifikuar me orë dhe përqindje, informacionin e nevojshëm për organizmin e lëndës, leksione dhe seminare ose ushtrime/laboratore. Sipas modelit të dokumentit të dorëzuar nr 35.1 GVJ: Mendojmë që këto elemente duhet të jenë në të njëjtin format syllabusi ose programi lënde duke specifikuar ngarkesën javore në auditor për veprimtarinë formuese (leksion: seminar/ushtrime: laboratore) me temat përkatëse të leksioneve dhe më pas për tematikat e laboratoreve; ashtu si e parashikon VKM Nr 41 dt 24.01 2018. (dokumentit të dorëzuar nr 14.1 pika 2.8 dhe shtojca nr 2.) Nuk është e nevojshme që krahas programit të lëndëve të jenë dhe planet kalendarike të lëndëve thjesht për të treguar tematikat e seminareve ose praktikave laboratorike. Dokumenti i dorëzuar nr 35.1".

*Komenti i UBT - Në dokumentin nr. 14\_5, i cili i referohet planeve mësimore, pasqyrohen dy zërat kryesorë: Leksione dhe Seminare. Kjo gjë është bërë për arsyen e thjeshtë se Plani Mësimor ka për qëllim kryesor të shprehë ndarjen e ngarkesës në dy zërat kryesorë: Leksione dhe Praktika/Seminare, dhe jo specifikimin e llojit të ngarkesës në zërin e dytë. Zëri "Seminare" zhvillohet në mënyra të ndryshme, në varësi të karakterit të modulit. Kështu, në disa module ato zhvillohen në formë teorike, në disa module zhvillohen në forma ushtrimesh dhe në disa të tjera në formë seancash laboratorike. Në pjesën më të madhe të moduleve "seminaret" përbëhen nga forma të kombinuara, pra teorike, laboratorike apo ushtrimore.*

**Përgjigje GVJ -** Në planet mësimore edhe në syllabuset duhet të jepet ndarja e ngarkesës javore jo vetëm në dy zërat kryesorë: Leksione dhe Seminare, por për të tërë komponentët formues të tërë programit brenda dhe jashtë auditorit. Komponenti seminare nënkupton zhvillimi

në auditor në formë teorike ose ushtrime te argumentave të modulit. Në këtë komponent nuk mund të futen edhe laboratorët, siç thuhet më sipër në objeksion: Në pjesën më të madhe të moduleve “seminaret” përbëhen nga forma të kombinuara, pra teorike, laboratorike apo ushtrimore. GVJ ka mendimin që për modulet që zhvillojnë seanca laboratorike në laboratore ato duhet të pasqyrohen si komponentë më vete me ngarkesën përkatëse.

*Komenti i UBT - Syllabuset e dorëzuara për PS cikli parë në LAU profili TAU janë të gjitha në përputhje me formatin e Syllabusit të përcaktuar në Shtojcën nr 2 të VKM 41 (Doc 14.4). Formatin e VKM Nr 41 dt.24.01.2018, Shtojca Nr.2 “Programi i lëndës” lejon vetëm paraqitjen e tematikave të zhvilluara nën zërin “Temat e Lëndës”. Në përputhje me këtë format, janë paraqitur vetëm temat e Moduleve Përkatëse. Ky format, është plotësuar në të njëjtën mënyrë nga të gjitha programet e studimit në UBT. Theksojmë se kjo mënyrë paraqitjeje është kryer vetëm duke filluar në vitin akademik 2018-2019, në zbatim të VKM Nr. 41 Shtojca nr.2. Gjatë takimit me GVJ, na u rekomandua se në format mund të bënim shtesë të zgjeruar për paraqitjen e hollësishme të ngarkesave të zërit ‘Seminare’, pavarësisht se në dukje figuron ndryshe. Këtë vërejtje do ta kemi parasysh në vazhdim.*

**Përgjigje GVJ -** GVJ ashtu si dhe në RVJ i përmbahet faktit që në syllabus ose Programi i lëndës” duhet bërë jo vetëm paraqitja e tematikave të zhvilluara, por edhe paraqitje e hollësishme të ngarkesave të zërit Seminare dhe laboratorë (dhe jo thjesht “seminare” siç e percepton institucioni “seminaret” përbëhen nga forma të kombinuara, pra teorike, laboratorike apo ushtrimore). *Komenti i UBT - Para vitit akademik 2018-2019, Syllabuset, plotësoheshin sipas formatit të miratuar nga Senati i UBT, ku paraqiteshin planet mësimore dhe kalendarike së bashku. Duke patur si qëllim paraqitjen sa më të saktë të mënyrës se si kryhen orët e “Seminareve”, kemi plotësuar Planet Kalendarë të moduleve, ku janë evidentuar në mënyrë të hollësishme orët konkrete të zhvillimit të seminareve teorike, praktikave laboratorike, ushtrimeve, detyrave të kursit, detyrave të kontrollit ndërmjetës etj së bashku me tematikat përkatëse. Këto Plane kalendarë disponohen në dokumentat 14.6. Planet Kalendarë të moduleve, megjithëse nuk kërkoheshin si dokumentacion mbështetës u gjykua nga GVB të dorëzoheshin edhe ato si elemente të rëndësishëm për shprehjen e komponentëve të programit të lëndës në vite. Kjo tregon se FBU ka përdorur formate për të siguruar informacion mbi programin e lëndëve edhe përpara implementimit të VKM Nr 41 dt 24.01.2018.*

**Përgjigje GVJ –** Në Draft RVJ, GVJ është shprehur qartë në lidhje me mënyrën e paraqitjes së ngarkesës në syllabus për elementët leksione, seminare/ushtime, dhe laboratore në auditor. Për ato module që i zhvillojnë të tre këto elemente duhet të dali e qartë në syllabus sa orë në javë studenti bën leksion, sa orë seminar ose ushtime dhe sa orë laboratore. Kjo nuk është treguar në syllabuset përkatëse. Përveç ngarkesës për secilën nga këto elemente duhet të pasqyrohen, gjithashtu në syllabus dhe tematikat e leksioneve dhe temat e laboratorëve.

*Komenti i UBT - Sa më sipër, mendojmë se nuk çënohet cilësia e paraqitjes dhe kontrollit të mësimdhënies, pasi Departamenti dhe Fakulteti kanë konsideruar dokumenta bazë, krahas Planeve Mesimore dhe Syllabuseve të moduleve, Planet Kalendarë - të cilat tregojnë në kohë reale zhvillimin konkret të mësimin, sipas tematikave dhe ngarkesës së aprovuar.*

*UBT shprehet se: Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ -** GVJ mendon se këto janë vërejtje reale dhe qëndrojnë.

**GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtare**

**27. Standardi II.3, kriteri 7 -** Paraqitja në Draft RVJ: "GVJ mendon që përmbajtja e PS duhet të përmirësohet: në drejtim të zvogëlimit të numrit të disiplineve ose moduleve, nëpërmjet grupimit të moduleve të afërta në të cilat është konstatuar edhe përsëritje të temave që trajtojnë. Kjo është vënë re në modulet me detyrim të lëndëve të tipologjisë A të formimit bazë: Biologji, Gjenetikë dhe Mikrobiologji e përgjithshme. E njëjta gjë është edhe për modulet Kimia e ushqimit, Biokimia, Ushqimi dhe të ushqyerit tek njeriu. Rekomandojmë të shikohet mundësia e integritit dhe kombinimit të tyre sepse trajtojnë pothuaj elemente të njëjtë. Sygjerohet që të shihet mundësia e grupimit të tyre në një disiplinë të vetme. Në këtë mënyrë pakësohet dhe numri i disiplineve (30 module teorike mendojmë se janë shumë, ose të eliminohen temat që përsëriten në këto module sepse në mënyrë artificiale rritet ngarkesa e studentit). Gjithashtu, duhet të kenë më shumë module që lidhen me fushën e Inxhinierisë, meqë studentët në fund fitojnë titull Inxhinier. Mendojmë se moduli Kontrolli Automatik, që është lëndë kryesore në fushën e Inxhinierisë është futur me vonesë në PS dhe duhet të kalojë në lëndë bazë jo me zgjedhje. Mendime për përmirësim të PS jepen edhe në kriteret e mëposhtme".

*Komenti i UBT - Në takimet që GVJ pati me stafin akademik u diskutua dhe pjesa e integritit të disa moduleve. Në gjykimin e njësisë bazë dhe asaj kryesore, integrimi i moduleve, nuk e lehtëson por e ngarkon akoma më shumë studentin që në një semester të realizojë tre disiplina të rëndësishme të formimit bazë duke rrezikuar që dijet e marra për këto disiplina të jenë të cunguara. Bazuar edhe në kurrikulat e Universiteve të ngjashme psh. atyre Italiane perkatesisht Universitetit te Torinos dhe atij te Perugias, Modulet Biologji dhe Mikrobiologji e pergjithshme zënë përkatësisht 8 dhe 6 ECTS (Programet: Tecnologie Alimentari, Scienze e technologie agro-alimentari). Elementët që trajtohen edhe pse mund të duken të njëjtë ndahen në funksion të modulit dhe mënyrës se si trajtohen. Psh. nqs do të flasim për karbohidratet, është një temë e përbashkët që trajtohet si tek moduli "Kimia Ushqimore" ashtu edhe tek moduli "Ushqimi dhe të Ushqyerit", por aspekti në të cilin trajtohen është i ndryshëm. Tek moduli "Kimia Ushqimore", trajtohet struktura e tyre kimike, forma në të cilën gjendet në ushqime dhe veçoritë funksionale me rëndësi në industrinë ushqimore, ndërsa tek moduli "Ushqimi dhe të Ushqyerit", trajtohet mënyra e përdorimit të karbohidrateve nga organizmi, përthithja dhe metabolizimi dhe roli i tyre në organizmin e njeriut.*

**Përgjigje GVJ -** GVJ e kupton orientimin e çdo moduli në trajtimin e elementëve të njëjtë, por nga krahasimi i syllabuseve përkatëse konstatohet përsëritje të temave, dhe secila nga ato ka ngarkesë 2orë leksion: 2 orë seminar. Përsëritje të temave që trajtojnë është vënë re edhe në modulet me detyrim të lëndëve të formimit bazë: Biologji, Gjenetikë dhe Mikrobiologji e përgjithshme. (në takimin me stafin akademik një pjesë e pedagogëve e pohuan këtë fakt)

*Komenti i UBT - Në lidhje me modulet inxhinierike: Në kurrikul implementohen me sukses që në krijimin e këtij programi studimi dy lëndë inxhinierike: Bazat e Transmetimit në Industrinë Ushqimore dhe Proceset Themelore në Industrinë Ushqimore, nëpërmjet zhvillimit jo vetëm të leksioneve, por edhe të ushtrimeve, detyrave të kursit, projekteve etj. Gjatë vitit akademik 2018-2019 u implementua dhe edhe moduli 'Pajisje Matëse dhe të Kontrollit' me qëllim mbylljen e zinxhirit të lëndëve Bazë inxhinierike. Por ajo që e bënë të veçantë këtë PS është fakti se konceptet inxhinierike nuk merren vetëm nëpërmjet lëndëve të mirëfillta inxhinierike. Kështu, në masën 30%-40% ato janë pjesë e programit në çdo lëndë që trajton Teknologjitë e Prodhimit (Dokument 14\_4). Për më tepër, gjatë kursit të këtyre moduleve, studentët marrin*



*koncepte dhe zbatojnë metoda të projektimit inxhinierik, zbatimit dhe optimizimit të proceseve të prodhimit duke punuar drejtëpërsëdrejti në pesë linjat pilot që DTAU/FBU ofron. Theksojmë, se puna në impiante pilot është një rast unik në të gjitha Programet e Studimit të ngjashme ose të njëjtë me tonin në të gjithë rajonin, përfshi Kosovë, Bosnjë Hercegovinë, Maqedoni, Mali i Zi), e ngjashme me PS analoge në Bullgari dhe në Greqi.*

**Përgjigje GVJ** - GVJ mendon se dy lëndët inxhinierike: Bazat e Transmetimit në Industrinë Ushqimore; Proceset Themelore në Industrinë Ushqimore, edhe moduli "Pajisje Matëse dhe të Kontrollit" të futur në kurikul vitin 2018-19 si lëndë me zgjedhje, të cilat konsiderohen bazë inxhinierike, janë shumë pak (3 module nga 33 gjithesej që ka PS) për të justifikuar emërtimin dhe orientimin e Programit të Studimit në inxhinieri agroushqimore. Modulet që trajtojnë teknologjitë e prodhimit janë më tepër lëndë me orientim teknologjik. Për këtë arsye GVJ ka sygjeruar emërtimin e programit bachelor ne Teknologji Agroushqimore; dhe zhvillimin e tre moduleve me orientim inxhinierik në programin master duke pasuruar kurrikulën e tij me këtë grup lëndësh.

*Komenti i UBT - Gjatë takimeve me GVJ kemi shprehur dinamizmin e ndryshimit të kurrikulës në funksion të përmirësimit të cilësisë. Në këtë kuadër kurrikula është pasuruar me modul inxhinierik "Pajisje Matëse dhe të Kontrollit", dhe jo "Kontrolli Automatik" si kundër përmendet në RVJ. Ky modul është vendosur vitin e kaluar akademik për herë të parë, pasi u përgatitën kuadrot e nevojshme për të implementuar këtë lëndë. Arsyeja pse u fut si lëndë me zgjedhje ishte sepse ky modul po implementohej për herë të parë dhe DTAU kishte për qëllim, të vëzhgonte cilësinë e mesimdhënis dhe interesin që zgjonte tek studentët. Ecuria e këtij moduli rezultoi pozitive nga rezultatet e pyetësorit të studentëve të realizuar në fund të vitit akademik 2018-2019. Për kurrikulën e vitit 2019-2020, lënda është përcaktuar si modul i detyrueshëm në këtë program studimi.*

**Përgjigje GVJ** - GVJ falenderon Institucionin për shpjegimet nëpërmjet këtij objeksioni, dhe faktin që institucioni do ta ketë në konsiderate sugjerimin e GVJ: "Për kurrikulën e vitit 2019-2020, lënda është përcaktuar si modul i detyrueshëm në këtë program studimi".

*Komenti I UBT - Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Bazuar në komentet e bëra nga GVJ mbi objeksionet dhe atë që është shkruar në RVJ ka vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri

**GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtare**

## **28. Vlerësimi i dhënë për Standardin II.3 nga GVJ: PJESËRISHT**

*Komenti i UBT – Në përfundim të Standardit II.3 konstatojmë se nuk është paraqitur asnjë Vërejtje objektive dhe e qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi.*

*Prandaj, pretendojmë që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga "Kryesisht" në "Plotësisht"*

**Përgjigje GVJ** - Bazuar në komentet e mësipërme GVJ nuk bën ndryshim në vlerësimin e standardit II.3 ai mbetet PJESËRISHT

**29 – Standardi II.4, kriteri 1** - Koment në RVJ: "Ngarkesa në programin e studimit të ciklit të parë BCH në IAU profile TAU, është i organizuar në tre vite akademike. Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti është 60 kredite. Sipas dokumentit të dorëzuar nr 7 neni 3 rregullore e programit të studimit, orët fizike të zhvilluara janë 625 orë leksion 450 orë

seminare. GVJ konstaton se ka mos përputhje me ngarkesën të treguar sipas dokumentit të dorëzuar 14. 2 kurrikula 2018-2019. Ku tregohet se orët fizike për këtë PS janë: 795 orë leksione; 855 orë seminare/ushtrime ose laboratore; praktika profesionale 90 orë, provim formimi 60 orë. Në total për tre vite 1800 orë për 180 kredite”

*Komenti i UBT - Në dokumentin nr 7, neni 3, janë të specifikuara orët minimale për zhvillimin e këtij programi studimi të cilat janë të nevojshme për studentët për të përthithur të gjithë informacionin e nevojshëm të dhënë në këtë program. Numri më i lartë i orëve të paraqitura në kurrikule, lidhet me rritjen e numrit të studentëve gjatë viteve.*

**Përgjigje GVJ** - GVJ nuk është dakort me objeksionet e paraqitura. Sepse GVB kur ka përgatitur RVB, për llogaritjen e ngarkesës të PS nuk duhet ti referohej dokumentit të dorëzuar nr 7 neni 3 rregullore e programit të studimit, por duhet ti referohej dokumentit kryesor (planeve mësimore ose/dhe kurrikulës që është dokumenti i dorëzuar 14. 2 kurrikula 2018-2019. *Komenti i UBT - Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** -GVJ mendon se ka vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri. **GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtare**

**29. Standardi II.4, kriteri 3** - Komenti në RVJ: “GVJ nga shqyrtimi i dokumenteve sidomos planeve mësimore të dy viteve të fundit, konstaton që në listën e 12 moduleve me zgjedhje janë tre disiplina të rëndësishme për formimin profesional dhe arritjen e objektivave të të nxënit: “Teknologjia e drithërave dhe produkteve të tyre”, Teknologjia e vajit, “Teknologjitë e pas vjeljes”. Mendojmë që këto module të zhvillohen si disiplina të detyrueshme. Gjithashtu në modulet me zgjedhje është dhe disiplina: Paisjet matëse dhe të kontrollit, e cila mund të zhvillohet si lëndë e detyruar në Bachelor ose më mirë në Programin Master Shkencor IAU-TAU duke e përmirësuar kurrikulën e këtij programi me lëndët e karakterit inxhinierik. Dokumentit të dorëzuar 14. 2 kurrikula 2018-2019”

*Komenti i UBT - Modulet “Teknologjia e Drithërave dhe produkteve konditore” si dhe “Teknologjia e vajit, bimeve etero-vajore dhe aromatike”, janë disiplina të detyrueshme. Ndryshimi i kurrikules për vitin akademik 2018-2019 dhe mos paraqitja e tyre në kurrikulën e 2018-2019, shpjegohet me faktin se këto module, janë lëvizur nga kursi në të cilin realizohen, përkatësisht, “Teknologjia e Drithërave dhe produkteve konditore”, në kurrikulën e vitit akademik, 2017-2018 është realizuar në kursin e dytë dhe të tretë. Për këtë arsye ajo nuk rezulton në kurrikulën e vitit akademik 2018-2019. Në kurrikulën e këtij viti akademik, 2019-2020, është parashikuar si disiplinë e detyrueshme që do të zhvillohet në kursin e tretë.*

**Përgjigje GVJ** - Së pari sqarojmë se institucioni e ka gabim ne objeksion kur shprehet për modulën Teknologjia e drithërave dhe për këtë arsye ajo nuk rezulton në kurrikulën e vitit akademik 2018-2019. Si është shkruar ne RVJ konstaton që në listën e 12 moduleve me zgjedhje janë tre disiplina të rëndësishme për formimin profesional dhe arritjen e objektivave të të nxënit: “Teknologjia e drithërave dhe produkteve të tyre”, Teknologjia e vajit, “Teknologjitë e pas vjeljes”. Kjo sipas dokumentit 14.2 kurrikula e 2018-2019. Atëherë GVJ mendon të pasqyrojë zhvillimin e këtyre moduleve në tre vitet e fundit bazuar në dokumentin e dorëzuar 14.3 kurrikula në vite 2014-2018. Për vitin akademik 2014-2015 moduli Teknologji e drithërave” zhvillohet në semestrin IV viti II ndërsa moduli Teknologjia e vajit dhe bimëve etero vajore zhvillohet në semestrin VI viti III. Për vitin akademik 2015-2016 moduli

Teknologji e drithërave” zhvillohet në semestrin IV viti II ndërsa moduli Teknologjia e vajit dhe bimëve etero vajore zhvillohet në semestrin V viti III. Për vitin akademik 2016-2017 moduli Teknologji e drithërave” zhvillohet në semestrin IV viti II ndërsa moduli Teknologjia e vajit dhe bimëve etero vajore zhvillohet në semestrin VI viti III. Për vitin akademik 2017-2018 moduli “Teknologji e drithërave dhe produkteve konditore” zhvillohet në semestrin IV viti II ndërsa moduli “Teknologjia e vajit” zhvillohet së bashku me Teknologjia e frutave - perime si një modul i vetëm (ngarkesa në orë nuk është shtuar) dhe zhvillohet në semestrin IV viti II; pra në të njëjtin semester. Në kurrikulën e këtij viti në semestër VI viti III janë zhvilluar për herë të parë modulet me zgjedhje ku nga 12 module student duhet të zgjedhë 3. Në këtë listë figurojnë dhe Teknologjia e drithërave dhe produktet konditore dhe Teknologjia e vajit. Për vitin akademik 2018-2019 moduli Teknologji e drithërave” dhe Teknologjia e vajit, nuk janë module të detyrueshme, por vetëm module me zgjedhje. GVJ ka mendimin se këto ndryshime nga viti në vit nuk janë në kuadër të përmirësimit të kurrikulës por krijon një konfuzion. Për më tepër nga module të detyrueshme kthehen me zgjedhje kur ato përfaqesojnë teknologji të produkteve kryesore. Gjithashtu bashkimi i dy moduleve të detyrueshme sic u përmënd më sipër është në dëm të të nxëniet të njohurive dhe cilësisë.

*Komenti I UBT - Ndërsa, modulin “Teknologjitë e pasvjeljes”, njësia bazë dhe ajo kryesore, e ka gjykuar si disiplinë me zgjedhje pasi të gjitha modulet me karakter teknologjik, trajtojnë në përgjithësi teknikat e ruajtjes së lëndëve të para.*

**Përgjigje GVJ --** Meqënëse njësia bazë dhe ajo kryesore e gjykon si disiplinë me zgjedhje për arësyen e përmëndur në objeksion GVJ bie dakort

*Komenti I UBT - Lidhur me modulin “Pajisjet matese dhe kontrollit”, ju lutem referojuni, objeksionit në standartin II.3, kriteri 7, pika 4.*

**Përgjigje GVJ -** (përgjigjia e dhënë për objeksionin në standartin II.3, kriteri 7, pika 4)

GVJ falenderon Institucionin për shpjegimet nëpërmjet këtij objeksioni, dhe faktin që institucioni do ta ketë në konsideratë sygjerimin e GVJ: “Për kurrikulën e vitit 2019-2020, lënda është përcaktuar si modul i detyrueshëm në këtë program studimi”.

*UBT shprehet se: Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ -** GVJ mendon se ka vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri. GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtare

**30. Standardi II.4, kriteri 4 -** Komenti në RVJ: “Në RVB thuhet Programi i studimit të diplomës së nivelit të parë BCH në IAU profile TAU, ka strukturë në përputhje me profilin e studimeve BCH ku orët fizike të zhvilluara janë si më poshtë: 625 orë leksione; 450 orë seminare, ushtrime, punë laborator, 375 orë teza e diplomes, pergatitja e një materiali të shkruar në fund të kryerjes së saj dhe provim formimi që përmbyll ciklin e studimeve të këtij niveli. Nga RVB konstatohet se këto të dhëna janë të gabuara, në fakt ngarkesa është: orët fizike për këtë PS janë: 795 orë leksione; 855 ore seminare/ushtime ose laboratore; praktika profesionale 90 orë, provim formimi 60 orë. Në total për tre vite 1800 orë për 180 kredite. Raporti teori/ praktikë është 0,9:1 pra afërsisht 1;1”.

*Komenti I UBT - Në dokumentin nr 7, neni 3 janë të specifikuar orët minimale për zhvillimin e këtij programi studimi të cilat janë të nevojshme për studentët për të përthithur të gjithë informacionin e nevojshëm të dhënë në këtë program. Numri më i lartë i orëve të paraqitura në kurrikul, lidhet me rritjen e numrit të studentëve gjatë viteve.*

**Përgjigje GVJ** - GVJ nuk është dakort me objeksionet e paraqitura. Sepse GVB kur ka përgatitur RVB, për llogaritjen e ngarkesës të PS duhet ti referohet dokumentit kryesor (planeve mësimore ose/dhe kurrikulës që është dokumenti i dorëzuar 14. 2 kurrikula 2018-2019. Në këto dy dokumenta ngarkesa shprehet si ngarkesë totale për çdo modul (orë në javë X numrin e javëve të semestrit ku zhvillohet moduli). Institucioni arsyeton gabim në objeksionin 2, kjo ngarkesë nuk ka të bëjë me rritjen e numrit të studentëve. Rritja e numrit të studentëve ndikon në rritjen e numrit të grupeve të vogla për seminare dhe/ose laboratore dhe për rrjedhojë dhe në rritjen e ngarkesës së pedagogut.

*Kommenti I UBT - Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigja e GVJ** mendon se ka vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri. **GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtare**

**31. Standardi II.4, kriteri 6** - Në RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetet konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin.

Koment në RVJ: Literatura nuk pasqyrohet për pjesën më të madhe të programeve të lëndëve në mënyrë të detajuar për çdo kapitull.

*Komenti nga UBT - Formati i VKM Nr 41 dt.24.01.2018, Shtojca Nr.2 lejon paraqitjen e literaturës të specifikuar në zërin "Literatura", e cila ndahet më pas në "Literaturë bazë e detyrueshme" dhe "Literatura e rekomanduar". Për këtë arsye, në syllabuset e moduleve të programit të studimit, gjendet literaturë përkatëse në përputhje me këtë format. Sa më sipër, është zbatuar në të njëjtën mënyrë nga të gjitha programet e studimit në UBT.*

**Përgjigje GVJ** - GVJ është dakort me objeksionin. **GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtare (heq komentin më sipër)**

**32. Vlerësimi i dhënë për Standardin II.4 nga GVJ: PJESERISHT**

*Komenti I UBT - Në përfundim të Standardit II.4 konstatojmë se nuk është paraqitur asnjë vërejtje objektive dhe e qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, pretendojmë që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga "Kryesisht" në "Plotësisht"*

**Përgjigje GVJ** - Bazuar në komentet më sipër GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare **Vlerësimi për standardin II. 4 është PJESËRISHT**

**33. Vlerësimi i dhënë për Standardin II.5 nga GVJ: PLOTËSISHT**

**Përgjigje GVJ** - Bazuar në komentet më sipër GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare **Vlerësimi për standardin II. 5 është PLOTËSISHT.**

**Përgjigje GVJ** - Shënim: Institucioni nëpërmjet GVB në RVB vlerësimin për këtë standart e ka dhënë kryesisht. Nga rishikimi i standardeve të fushës II, vlerësimi është dy standarde me vlerësim "pjesërisht" dhe tre me vlerësim "plotësisht"

**GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare, vlerësimi i fushës II është KRYESISHT.**

**34 - Standardi III.1, kriteri 2** - Në RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetet konstatohet i plotë dhe në përputhje

mekriterin.

*Komenti i UBT - në Draft RVJ shkruhet se: Nga takime me studentët, këto kontrolle janë të rralla, më shpesh bëhen për të evidentuar kryerjen e mësimit dhe respektimin kohor të orëve mësimore dhe shumë pak janë kontrolle tematike për të parë zhvillimin cilësor të mësimit.*

**Për sa më sipër** - Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, si funksion të tij, ka dhe kontrollin mbi mësimdhënien dhe mesimnxënien. Për këtë arsye, ai realizon, kontrolle të vazhdueshme, mbi kryerjen e mësimit dhe respektimin kohor të orëve mësimore, gjithashtu kontrolle tematike mbi cilësinë e mësimdhënies, cilësinë e materialeve mësimore, metodat e mësimdhëniesetj. Në çdo fillim viti akademik, personeli akademik, depoziton pranë njësisë bazë, materiale didaktike, të cilat vlerësohen nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Komisionin e Sigurimit të Cilësisë. Mbi kontrollin e cilësisë së mësimdhënies, realizohen gjithashtu dhe një vlerësim në pyetësorin e studentëve, në mënyrë periodike.

*Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Në RVJ për këtë kriter në fillim shkruhet "Monitorimi për mësimdhënien kryhet në nivel Fakulteti nga Dekanati dhe Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Kjo sipas dokumentit të dorëzuar nr 14.6 neni 15 pika 6" që është rregullore e FBU; më pas vazhdohet me pjesën që citon objeksioni. Kjo tregon se janë përcaktuar në rregullore strukturat përgjegjëse për monitorimin e mësimdhënies dhe mekanizmat të monitorimit që vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse të personelit. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, funksion si një strukturë e tillë. Kriteri kërkon kryerjen e kontrolleve periodike për vlerësimin e aftësive të mesimdhënies dhe innovative, të cilat që të jenë efektive duhet të shoqërohen me një dokument memo ku të dy palët bien dakort për rezultatet e kontrollit.

### **35 Vlerësimi i dhënë për Standardin III.1 nga GVJ: KRYESISHT**

*Komenti i UBT - Në përfundim të Standardit III.1 konstatojmë se nuk është paraqitur asnjë vërejtje objektive dhe e qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, pretendojmë që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga "Kryesisht" në "Plotësisht"*

**Përgjigje e GVJ** - Institucioni nëpërmjet GVB në RVB vlerësimin për këtë standart III.1 e ka dhënë kryesisht. **GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare Vlerësimi mbetet KRYESISHT**

**36 Standardi III.2, kriteri 1** - GVJ konstatoi që laboratorët janë pjesë e veprimtarisë formuese për 50 % të lëndëve që zhvillon programi i studimit BCH në IAU me profil TAU, ato zhvillohen në grupe prej 20 studentësh. Mendojmë se numri i madh i studentëve nuk lejon përfshirjen aktive të secilit në analizat ose matjet eksperimentale.

*Komenti i UBT - Bazuar në VKM Nr 41 dt.24.01.2018 Shtojca 1 Tabela nr. 2, përcaktohet se nr i studentëve për seancë laboratorike, duhet të jetë 20. Në lidhje me sa më sipër theksojmë se grupet mësimore në programin e studimit BSc TAU, janë konform kësaj VKM-je.*

**Përgjigje GVJ** - GVJ e pranon objeksionin. GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.

**37 Standardi III.2, kriteri 2** - Komenti në RVJ: Programi Studimit dhe stafi akademik mundohet të sigurojë një raport të drejtë mes formimit teorik dhe formimit praktik, ky raport

për PS në tërësi nuk është 1:1; më shumë janë orët leksion dhe seminare, në krahasim me orët e seancave laboratorike dhe ushtrime.

*Komenti I UBT -- Në dokumentin nr 14.5. pasqyrohen dy zëra kryesore: leksione dhe seminare sipas krediteve që ka secili modul. Duhet të theksohet se modulet me karakter teknologjike janë me raportin 1:1. Seminaret zhvillohen në mënyra të ndryshme në varësi të karakterit të modulit. Kështu seminarët përbëhen nga forma të kombinuara teorike, laboratorike dhe ushtrimore. Në pjesën më të madhe të lëndëve formuese pjesa laboratorike tentohet të jetë gjithmonë mbi 60%, dhe në çdo vit akademit stafi pasuron programin me tema të rejalaboratori. Formimi praktik identifikohet si në seancat laboratorike ashtu dhe në proceset teknologjike të prodhimit të produkteve të ndryshme në linjat e prodhimit pilotpranë FBU-së*

**Përgjigje GVJ** - Të dhënat që tregohen në RVJ janë nxjerë nga planet mësimore dhe kurrikulat e viteve akademike si dhe sylabusët për modulet që zhvillon në PS. **GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar**

**38 Standardi III.2 kriteri 4** - Oferta e punës dhe kriteret e punësimit, dokumenti i dorëzuar 44.5 nuk është e firmosur nga kancelari dhe rektori. Sipas RVB, në njoftim institucioni shpall ofertën e punës me kërkesat specifike që ka propozuar njësisia bazë dhe dekanati, të miratuara nga titullari i institucionit. Dokumenti i dorëzuar nr. 44.2 paraqet formatin e publikimit të vendit të lirë të punës, por jo të kriterëve.

*Komenti I UBT - Dokumenti 44.5 është version soft copy i ofertës së punës dhe shpreh mjaft qartë disa shëmbuj të kriterëve të veçanta të vendosura për rekrutimin e stafit pranë FBU-së në departamente të ndryshme të FBU-së. Dokumenti 44.2 është formati i publikimit të kriterëve për secilën kategori "Asistent Lektor", "Lektor" dhe "Profesor" ku përfshihen kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta. Këtij materiali do ti bashkangjitet një shëmbull i këtij dokumenti të firmosur nga titullarët e institucionit.*

*Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje RVJ** - Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, dhe hedhjen on line nga Ascal të dokumentave nga arshiva, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar**

**39 Vlerësimi I dhënë për Standardin III.2 nga GVJ: KRYESISHT**

Komenti I UBT – Në përfundim të Standardit III.2 konstatojmë se nuk është paraqitur asnjë vërejtje objektive dhe e qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, pretendojmë që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga "Kryesisht" në "Plotësisht"

**Përgjigje e GVJ** - Institucioni nëpërmjet GVB në RVB vlerësimin për këtë standart III.2 e ka dhënë kryesisht. **GVJ bën ndryshime në RVJ përfundimtare Vlerësimi nga KRYESISHT bëhet PLOTËSISHT**

**40 Standardi III.3, kriteri 1** *Komenti i UBT - Në RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetet konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin.*

**Përgjigje e GVJ** - Në draft RVJ është bërë kjo vërejtje: "Megjithëse shumë prej ambienteve janë jo shumë të mëdha për të mirëpritur 20/25 studentë. Kjo shprehet edhe në raportin 2017-2018: Mbetet problem hapësira e kufizuar e ambienteve të mësimdhënies, në veçanti e laboratorëve, të cilët kanë sipërfaqe të vogla në krahasim me numrin e studentëve në një grup, 20/25". Problemi i hapësirave të pamjaftueshme për laboratorët e pohon dhe vetë institucioni nga raporti analizës 2017-2018

**41 Standardi III.3, kriteri 2** - Gjithashtu laboratorët janë pajisur me pajisje, sipas specifikës së secilit laborator por disa kanë sipërfaqe të vogël për grupe laboratorimi me 20-25 studentë.

*Komenti i UBT - Hapësira totale e vënë në dispozicion për procesin mësimor kërkimor është 4.4 m<sup>2</sup>/ student (dok 42.2) duke plotësuar normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme prej 3,8 – 4.0 m<sup>2</sup>/student (minimumi) dhe 7.5 – 8.0 m<sup>2</sup>/student (maksimumi) të përcaktuara nga standartet shtetërore të cilësisë. Pjesa praktike e studentëve plotësohet përveç laboratorëve edhe nëpërmjet linjave teknologjike të prodhimit të FBU-së. Si dhe bëhet përpjekje maksimale në hapjen e laboratoreve të rinj nëpërmjet projekteve të ndryshmendërkombëtare.*

*Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje RVJ** - Në Draft RVJ është bërë kjo vërejtje: "Numri i studentëve në grupin mësimor është në përputhje me VKM 41 përkatësisht deri në 100 studentë për zhvillimin e leksioneve dhe 25 student për çdo grup seminaresh. Jo të gjitha sallat janë pajisur me kondicioner për të krijuar kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të mësimin, si një nga problematikat kryesore rezultuar nga anketimi studentëve. Gjithashtu laboratorët janë pajisur me pajisje, sipas specifikës së secilit laborator por disa kanë sipërfaqe të vogël për grupe laboratorimi me 20-25 studentë.

Problemi i hapësirave të pamjaftueshme për laboratorët e pohon dhe vetë institucioni nga raporti analizës 2017-2018

**42 Standardi III.3, kriteri 5** – *Komenti i UBT - Në RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetës konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin.*

**Përgjigje RVJ** - Në draft RVJ për këtë kriter është bërë kjo vërejtje: GVJ i këtij programi studimi nuk pati mundësinë të kontaktojë me punonjësit e bibliotekës. Ato nuk ndodheshin aty edhe pse institucioni ishte lajmëruar më parë për vizitën sipas agjendes me orare fikse, zyra dhe grupet e takimit. Pra vizita e programuar nuk u bë për mos korektësi nga ana e institucionit

**43 Standardi III.3, kriteri 7** Në RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetës konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin.

**Përgjigje RVJ** - Në draft RVJ për këtë kriter është bërë kjo vërejtje: Raporti mesatar sipërfaqe/student është 4,4 m<sup>2</sup> për programin e studimit Bachelor me profil TAU, i cili ka 404 student. Është brenda standardeve, por në disa laboratore veçmas sipërfaqja është e vogël për grupe me 20-25 studentë. Në dokumentat 42.1 dhe 42.2, tregohet se FBU ka 21 salla laboratorimi, por tregohet se ky program shfrytëzon 18 laboratore. Nga një sipërfaqe totale 5046 m<sup>2</sup> që i takon programit të studimit, 1280 m<sup>2</sup> (25,4%) janë në dispozicion vetëm për ambiente

laboratorike dhe zhvillimit të praktikave mësimore.

**44 Standardi III.3, kriteri 10** - Në RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetet konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin.

**Përgjigje RVJ** - Në draft RVJ për këtë kriter është bërë kjo vërejtje Në programin e studimit të ciklit të parë BCH në IAU, profile TAU, përfundimi i studimeve realizohet nëpërmjet provimit të formimit.

**45 Vlerësimi i dhënë për Standardin III.3 nga GVJ: KRYESISHT**

*Komenti i UBT - Në përfundim të Standardit III.3 konstatohet se nuk është paraqitur asnjë vërejtje objektive dhe e qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, Nga "Kryesisht" në "Plotësisht"*

**Përgjigje e GVJ** - Institucioni nëpërmjet GVB në RVB vlerësimin për këtë standart III.3 e ka dhënë kryesisht. Bazuar në komentet më sipër **GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare Vlerësimi për këtë standart III.3 mbetet KRYESISHT**

**46. Vlerësimi i dhënë për Standardin III.4 nga GVJ: KRYESISHT**

*Komenti i UBT - Në përfundim të Standardit III.4 konstatohet se nuk është paraqitur asnjë vërejtje objektive dhe e Qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, pretendohet që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga "Kryesisht" në "Plotësisht"*

**Përgjigje e GVJ** - Institucioni nëpërmjet GVB në RVB vlerësimin për këtë standart III.4 e ka dhënë kryesisht 80%. **GVJ bën ndryshime në RVJ përfundimtare Vlerësimi bëhet PLOTËSISHT**

**47. Standardi III.6, kriteri 2** – *Komenti UBT - Në RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetet konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin.*

**Përgjigje GVJ** - Në RVJ është paraqitur vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Në këtë kriter është shkruar: Institucioni nuk aplikon sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat do të eliminojnë abuzimin në marrjen e notave të pa merituar. Këto sisteme rrisin transparencën në vlerësim dhe minimizojnë korrupsionin. Siç është përmendur dhe në kriteret më sipër testimi i studenteve në vlerësimin përfundimtar bëhet me teza të printuara ose me fletore jo në formë elektronike. **GVJ mendon se kriteri nuk plotësohet**

**48. Standardi III.6, kriteri 4** - Nga takimi me studentë GVJ konstatoi që: testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve në provimet me shkrim, nuk zhvillohet në mënyrë anonime, pra nuk bëhet me sekretim ose kodifikim. Kjo të paktën deri për provimet e semestrit të parë.

*Komenti I UBT - Konstatimi është i vërtetë por kontrolli i dijeve me sekretim apo kodifikim nuk është shënuar si metodë provimi në Programet e Lëndës sipas VKM nr.41, rrjedhimisht nuk është i detyrueshëm zbatimi i kësaj metode*

**Përgjigje GVJ** - Kriteri ka të bëjë me testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve me shkrim, i cili sipas këtij kriteri duhet të zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim. VKM nuk e ndalon aplikimin e provimeve me sekretim. Kjo nuk është e nevojshme të



shënohet në syllabus. Sekretimi është një formë për të eliminuar vlerësimin abuziv dhe për të rritur transparencën dhe objektivitetin në vlerësim. **Mendojmë që ky kriter nuk përmbushet.**

*Komenti i UBT - Në qershor 2019, UBT, në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për zhvillim aplikoi korrigjimin e automatizuar të provimeve përmes projektit Clean Score, dokumenti nr.79. Kjo metodologji siguron cilësi më të lartë dhe transparencë në gjykimin e studentëve si dhe një kohë shumë të shkurtër korrigjimi. Në sezonin e qershor 2019, u aplikua si test për disa module në UBT, dhe mendohet që këtë vit, ky system të aplikohet në të gjithë Institucionin. Dokumentat shoqërues për këtë sistem do t'i bashkangjiten këtij materiali.*

*Linku: <http://ubt.edu.al/sq/2019/09/11/korrigjimi-i-provimeve-me-%e2%9c%94%ef%b8%8f-nisi-edhe-per-kete-sezon/>*

**Përgjigje GVJ -** GVJ nuk e mer parasysh objeksionin 2 sepse bëhet fjalë për periudhë mbas hartimit të raportit dhe vizitave e takimeve në institucion dhe nuk ka mundësi të vlerësojë ose gjykojë për këtë process, për të cilin në të gjitha takimet në FBU nuk u informua, megjithëse periudha ishte në muajin Qershor. **GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare**

#### **49. Vlerësimi i dhënë për Standardin III.6 nga GVJ: KRYESISHT**

*Komenti I UBT - Në përfundim të Standardit III.6 konstatojmë se nuk është paraqitur asnjë Vërejtje objektive dhe e Qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, pretendojmë që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë*

**Përgjigje e GVJ -** Bazuar në komentet më sipër për kriteret që nuk plotësohen **GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare. Vlerësimi për këtë standart III.6 mbetet KRYESISHT**

**50. Standardi III.7, kriteri 1 –** *Komenti I UBT - Në RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetes konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin.*

**Përgjigje GVJ -** Në draft RVJ është shkruar një vërejtje në lidhje me këtë kriter Ndërsa teknologjinë e drithit, prodhimit të bukës dhe produkteve konditor dhe teknologjitë e vajit janë parashikuar lëndë me zgjedhje kështu nuk janë me detyrim për të gjithë studentët.

#### **51. Vlerësimi i dhënë për Standardin III.7 nga GVJ: KRYESISHT**

*Komenti I UBT – Standardi III.7 është vlerësuar pa asnjë vërejtje nga ana e GVJ. Kërkojmë që Vlerësimi rishikohet dhe të vlerësohet “Plotësisht”*

**Përgjigje e GVJ -** Nga rishikimi i kriterëve GVJ bën ndryshime në RVJ përfundimtare, **vlerësimi për kriterin III.7 bëhet PLOTËSISHT**

**52. Komenti I UBT -** *Siç konstatohet nga shqyrtimi i vlerësimit që GVJ ka bërë mbi Standardin III, vërejtjet e bëra janë te pakta dhe aspak relevante për vlerësimin e kriterit në teresi. Shpesh është marrë vlerësimi “Kryesisht” pa shënuar asnjë vërejtje. Për këto arsye, lutemi rishikimin e vlerësimit të Standardit III nga “Kryesisht” në vlerësimin “Plotësisht”*

**Përgjigje GVJ -** Nga rishikimi i standardeve të fushës III, vlerësimi është tre standarde me vlerësim “kryesisht” dhe pesë me vlerësim “plotësisht”

**GVJ bën ndryshime në RVJ përfundimtare, vlerësimi i fushës III është PLOTËSISHT.**

**53. Standardi IV.1, kriteri 1** - Komenti në Draft RVJ: “Formati i dosjes personale të Stafit (dokumenti i dorëzuar nr. 44.1) përmban disa dokumenta që duhet të ketë cdo punonjës, por gjatë shqyrtimit të disa dosjeve u konstatuan parregullsi në lidhje me dokumentacionin, si mungesa e dokumentit të marrjes së titullit Doktor i Shkencave, Dëshmi penaliteti, Raportit mjekësor për aftësinë në punë, Kontrata e punës për këtë vit akademik. Në dokumentin nr. 52.1, Ndryshimi i Kurrikulës BSC 2014-2019, nuk cilësohet tek tabela Ndryshimet në programin e vitit akademik 2017-2018 tek 2018 – 2019, se moduli Biokimi & Gjenetikë është ndarë në dy module Gjenetikë dhe Biokimi; është shtuar moduli Bioteknologji Ushqimore; Mikrobiologji e përgjithshme & Ushqimore është ndarë në dy module Mikrobiologji e Përgjithshme dhe Mikrobiologji Ushqimore, të cilat ndikojnë përbëjnë jo vetëm 7% ndryshim. Dokumenti (nr. 22.3) Lista e Stafit ndihmës akademik për programin e BCH TAU, nuk është për Bachelorin por për Masterin. CV e personelit ndihmës akademik dhe përshkrimi i punës për Departamentin Teknologji Agroushqimore, nuk janë dorëzuar të gjitha nga GVB, sepse në bazë të dokumentit (nr. 23.2) janë 4 punonjës, mungojnë të dhënat e dy punonjësve të fundit (M. R dhe A. B). Tek përshkrimi i punës së E. K, thuhet se është laborant, por nuk shpjegohet se për cilën fushë është përgjegjës. Gjithashtu, formati i përshkrimit të punës, nuk është i njëjtë për të gjithë stafin ndihmës akademik”.

*Komenti I UBT - Ashtu siç përshkruhet në dokumentin nr 11, “Rregullorja e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave”, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e stafit akademik duke pasuruar dosjet e tyre me dëshmitë e kualifikimeve dhe trajnimevetëshkencore. Gjatë vitit 2019 kjo drejtori u ka kërkuar stafit akademik të dorëzojnë dokumentat e nevojshëm për të plotësuar dosjen personale për çdo punonjës të IAL. Për këtë arsye mund të ketë patur mungesë në dokumentacion, pasi kanë qenë në proces përditësimi. Kriteri 1 i standardit IV.1 nuk parashtron ndryshimet që pëson kurrikula në vite, por i referohet mënyrës së organizimit të programit të studimit, angazhimit e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. Në të cilën pasqyrohet në dokumentin nr23.1*

*“Të dhëna Tabelore për personelin në FBU 2018”. Konstatohet se në kokën e tabelës është vendosur emërtimi “Stafi akademik Programi i studimit MSC ne LAU Profili TAU”, por ky staf akademik angazhohet gjithashtu edhe për programin e studimit BSC në TAU. Të dhënat personale për punonjësit në fjalë M.R. dhe A.B. nuk janë paraqitur, pasi këto punonjës janë pjesë e këtij departamenti, por nuk angazhohen në këtë program studimi. Në lidhje me përshkrimin e punës të laborantes E.K, detyrat dhe përgjegjësitë e saj, janë të përshkruara në pikën 8, të dokumentit 22\_2.6. Ndër vite njësia kryesore, gjatë vlerësimeve të brendshme, është përpjekur që të unifikojë dokumentacionin e përshkrimit të vendit të punës, për stafin ndihmës akademik dhe administrativ. Proces ky i cili është ende në vazhdim.*

*Për rrjedhojë, nuk konstatohet vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri.*

*Përgjigje e GVJ - GVJ është dakord se Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e stafit akademik, duke pasuruar dosjet e tyre me dëshmitë e kualifikimeve dhe trajnimeve të tyre shkencore, në përputhje me rregulloren, neni 6. Dosja personale për çdo punonjës themelohet që në momentin e konkurimit dhe pasurohet në vazhdimësi. Në bisedën që GVJ pati me përgjegjësin e kësaj drejtorie, u evidentua se stafi akademik dhe ndihmës akademik ishte i njoftuar prej shumë kohësh për këtë*

plotësimin e dosjeve. Në dosje mungonin dokumenta si dëshmi penaliteti (dokument që duhet që në fillim), Raport mjekësor (që merret në fillim dhe rinovohet cdo vit), Kontrata e punës (që nënshkruhet në fillim të vitit), titulli Doktor i Shkencave (që duhet të dorëzohet për të vlerësuar ecurinë). Shqyrtimi i dosjeve ishte rastësore. GVJ ka shqyrtuar dokumentin nr. 52.1 që është cituar në RVB. Dokumentat që duhet të dorëzohen nga GVB duhet të jenë për Bachelor profilin përkatës, jo për MSc. Për arsye se edhe vetë lista emërore nuk është për staf akademik, por për ndihmës akademik dhe ka mos përputhje me listën tjetër. Meqenëse nuk janë pjesë e këtij PS, nuk duhet të ishin në listë. Dokumenti i dorëzuar nga GVB, në lidhje me përshkrimin e punës nuk e ka të cituar se për cilin laborator është përgjegjës punonjësi E. K. Pika PËRGJEGJËS PËR është lënë bosh.

**GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtar**

**54. Standardi IV.1, kriteri 2** – Paraqitja në Draft RVJ: Kandidatët që kanë pikë të barabarta duhet të vlerësohen në të gjitha fushat, dhe jo të preferohet kandidati që ka kryer studimet jashtë shtetit. Në këtë mënyrë, mund të vlerësohet mësimdhënia dhe kërkimi shkencor në fakultetet brenda vendit.

*Komenti i UBT - Vlerësimi i diferencuar për rekrutimin e stafit akademik nga IAL është e vendosur në Rregulloren e këtij Institucioni dhe qartësohet në dokumentin 11.1 "Rregullores për rekrutimin e Stafit Akademik", Aneksi A, B, C. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri.*

**Përgjigje GVJ** - Sipas Neni 3, në dokumentin nr. 11.1, tregohet se "Kriteret e veçanta të rekrutimit përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Rektori.". **GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtar**

**55. Standardi IV.1, kriteri 3** – paraqitja në Draft në RVJ: "Në dokumentin nr. 44.5, Oferta e punës dhe kriteret e punësimit, e dorëzuar nga GVB, por nuk është e firmosur nga kancelari dhe rektori. Dokumenti i dorëzuar nr. 44.2 paraqet formatin e publikimit të vendit të lirë të punës dhe jo të kriterëve. Në bazë të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm paraqitet se një vëmendje të veçantë në procesin e rekrutimit është kushti për paraqitjen e dëshmisë së penalitetit. Kjo paraqitet në dokumentin nr. 11.2, Urdhër nr. 102 për paraqitjen e dëshmisë së penalitetit në dosjen për konkurim, por në dosjen personale nuk e kishin të gjithë. Dokumenti nr. 44.3, Shembull Kriteret e pranimit në FBU, duhet të ishte për departamentin e Teknologjisë Agroushqimore. GVB ka dorëzuar dokumentin nr. 44.2 paraqet formatin e publikimit të vendit të lirë të punës dhe jo të kriterëve dhe nuk ka lidhje me kualifikimet jashtë vendit të cilët kanë patur vlerësim të diferencuar. Ndërsa dokumenti i dorëzuar nr. 11.1, Rregullore për rekrutimin e Stafit Akademik, Aneksi A, B, C mbështur në: Ligjin Nr. 80/2015, paraqet kriterin ku me kualifikimet jashtë vendit kanë patur vlerësim të diferencuar".

*Komenti i UBT - Dokumenti nr. 44.5 është formati i publikimit të kriterëve për secilën kategori "Asistent Lektor", "Lektor" dhe "Profesor" ku përfshihen kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta. Këtij materiali do ti bashkangjitet një shembull i këtij dokumenti të firmosur nga titullarët e institucionit. Dokumenti 44.2 është version soft copy i ofertës së punës dhe shpreh mjaft qartë disa shëmbuj të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të vendosura për rekrutimin e stafit pranë FBU-së në departamente të ndryshme të saj. Ashtu siç u përshkrua edhe në kriterin 1 të këtij standardi, i gjithë personeli i IAL gjatë vitit 2019, po përditëson dosjen personale të stafit akademik, për këtë arsye, mund të këtë mungesa të perkohshme në*

*dokumentacion. Dokumenti i dorëzuar është një shëmbull rekrutimi i stafit akademik në FBU. Bashkangjitur këtij dokumenti do tju dergohet një kopje e firmosur e rekrutimit të personelit akademik, në DTAU, ku janë të specifikuara kriteret e përzgjedhjes për pozicionin e kërkuar bashkë me vlerësimetpërkatëse. Për vlerësimin e kandidatëve përdoren llogaritja e pikëve të kriterëve vlerësues dhe në rast se kandidati ka kualifikime jasht vendit atëherë i shtohen pikët e vlerësimit sipas dokumentit 11.1 "Rregullores për rekrutimin e Stafit Akademik", Aneksi A, B,C.. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Dokumenti nr. 44.5 paraqet formatin e publikimit të kriterëve për secilën kategori. Në dokumentat e dorëzuara në shtator është edhe shëmbulli. Obieksioni është i drejtë edhe dokumenti nr. 44.2 paraqet disa shëmbuj të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të vendosura për rekrutimin e stafit pranë FBU-së në departamente të ndryshme të saj. Dosja personale për cdo punonjës themelohet që në momentin e konkurimit dhe pasurohet në vazhdimësi. Në bisedën që GVJ pati më përgjegjësën e kësaj drejtorie, u evidentua se stafi akademik dhe ndihmës akademik ishte i njoftuar prej shumë kohësh për plotësimin e dosjeve. Dëshmia e penalitetit është një nga dokumentat e konkurimit për një pozicion pune. Dokumenti i rekrutimit të personelit akademik, në DTAU, ku janë të specifikuara kriteret e përzgjedhjes për pozicionin e kërkuar bashkë me vlerësimetpërkatëse u shqyrtuar nga GVJ. Sipas Neni 3, në dokumentin nr. 11.1, tregohet se "Kriteret e veçanta të rekrutimit përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Rektori."

**GVJ bën ndryshime në RVJ përfundimtar.**

#### **56. Vlerësimi i Standardit IV. 1 sipas GVJ është: "KRYESISHT**

*Komenti i UBT - Për Standardin IV.1. me 4 kritere gjithsej, 3 prej tyre plotësohen pa asnjë vërejtje nga GVJ. Vërejtja e vetme që GVJ ka bërë ndodhet në Kriterin 1 dhe është më tepër një sugjerim, se sa një vërejtje. Rrjedhimisht për Standardin IV 1 pretendojmë vlerësimin "Plotësisht"*

**Përgjigje GVJ --** Vlerësimi i GVB për standardin IV.1 është Kryesisht. Bazuar në komentet më sipër për kriteret që nuk plotësohen. **GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare**  
**Vlerësimi për këtë standart IV.1 mbetet KRYESISHT**

**57. Standardi IV. 2, kriteri 1 –** Paraqitja në Draft RVJ: "Në dokument 42.3 Ambientet e FBU, shprehen shifra reale dhe teorike, të cilat jo gjithmonë janë në përputhje. Në Raportet Vjetore, tek përmbledhja e problematikave theksohet vazhdimisht për mangësi në pajisje. (Raporti 2017-2018: Mbetet detyrë pajisja e klasave dhe sallave të leksioneve me projektorë, Mbetet nevojë e paplotësuar Sigurimi i pajisjeve të rëndësishme për zyrat e pedagogëve, si kompjutera dhe printera. Për krijimin e mjediseve dhe mundësive të barabarta është përgjegjës Drejtuesi i njësisë bazë, i cili është autoriteti drejtues akademik i departamentit. Kjo paraqitet në dokumentin e dorëzuar nr. 6 (Rregullore e FBU) dhe jo në nr. 6.1 (Rregullore e Brendshme e DTAU), ku është vetëm faqja e parë e rregullores viti 2014. Pyetëtori i stafit akademik dhe ndihmës akademik (dokumenti nr. 41) është dorëzuar, por nuk është dhënë ndonjë rezultat nga përgjigjet e marra për vlerësimin apo përmirësimin e kushteve të personelit"

*Komenti I UBT - Dokumenti nr 42. 3 "Ambientet e FBU", paraqiten shifra reale dhe teorike të cilat nuk përputhen me njëra tjetrën, sepse këto janë materiale konsumi dhe si rrjedhojë*

*mund të dëmtohen gjatë vitit akademik. Ky dokument përdoret edhe si tabelë evidencash për bazën materiale për FBU-në. Është detyrë e njësisë kryesore që të realizojë kontrollin e vazhdueshëm dhe përmbushjen e kërkesave për këto materiale. Është e vërtetë që në këto raporte paraqiten problematika për mangësi në pajisje, por çdo vit akademik IAL plotëson kërkesat e paraqitura nga njësia bazë. Kështu, gjatë vitit 2019 FBU ka pajisur të gjitha sallat e mësimdhënies dhe kërkit shkencor me projektor, kompjuter dhe sistem ngrohje, sipas specifikës së sallave. Përgjegjësitë e Drejtuesit të njësisë bazë paraqiten në Rregulloren e UBT, Rregulloren e FBU dhe Rregulloren e DTAU, por RVB ka përdorur si referencë këtë të fundit. Për shkak të volumit të madh të dokumentacionit u gjykua e arsyeshme që në dokumentacionin e dorëzuar online të vendoset vetëm faqja e parë e rregullores nr 6.1, por në formatin Hard Copy është dorëzuar një kopje e rregullores DTAU. Përgjigjet e këtij pyetësi nuk janë paraqitur, pasi pyetësi i stafit akademik dhe ndihmës akademik plotësohet në fund të vitit akademik, ndërkohë që GVJ e realizoi vizitën e tij u gjatë muajit Maj të 2019. Rezultatet e këtij pyetësi do të pasqyrohen në Analizën vjetore mësimore të njësisë kryesore të realizuar nga Zv. Dekani përmësimin. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - GVJ konstatoi gjatë vizitës në ambiente pajisjet, por iu është referuar edhe raporteve të dorëzuara. Obieksioni është i drejtë ambientet janë pajisur me bazën materiale. Në bazë të raportit të përpiluar nga GVB dhe dokumentat e vëna në dispozicion, GVJ është referuar dokumentit nr. 6, sepse dokumenti nr. 6.1 ishte i paplotësuar. Në dokumentat e shtuara në shtator, pas hartimit të draftit të RVJ u shqyrtua dokumenti nr. 6.1. GVJ shqyrtoi dhe përgjigjet për Pyetësin e stafit akademik dhe ndihmës akademik përpara 2019.

**GVJ bën ndryshime në RVJ përfundimtar.**

**58. Standardi IV 2, kriteri 2** – Paraqitja në Draft RVJ: “Sipas dokumentit nr. 43.1, Tabelë Kualifikimesh për PA të Programit të Studimit BSc në TAU departamenti ka gjithsej 38 pedagogë dhe jo 37. Dokumenti nr. 23, Tabela nr. 1 Numri i punonjësve në FBU, tregon 38 staf pedagogjik (6 personel akademik dhe 6 punonjës kërkimor). Në dokumentin nr. 43.2, tregohen Lëvizjet e stafit akademik të FBU 2014-2018, i cili është një tregues i rëndësishëm i kualifikimit të stafit, por titulli është Programi i studimit Msc në Inxhinieri Agrorshqimore Profili Teknologji Agrorshqimore dhe jo për Bachelorin. Sipas dokumentit nr. 43.1, Tabelë Kualifikimesh për PA të Programit të Studimit BSc në TAU 10 pedagogë kanë gradën doktor i shkencave, por në bazë të CV vetëm një rezulton të ketë mbaruar jashtë shtetit”

*Komenti I UBT - Konstatimi i realizuar nga GVJ është i saktë, sepse nga 37 personel akademik numri real është 38 ndër të cilët 32 prej tyre janë kategoria “lektor” dhe 6 prej tyre “kërkues shkencorë”. Dokumenti nr. 43.2 tregon lëvizjet e stafit akademik ku panvarësisht emërtesës së tabelës, në të listohen lëvizjet e stafit akademik të gjithë njësisë kryesore dhe jo vetëm të këtij PS. Lidhur me konstatimin e GVJ për numrin e stafit akademik të kualifikuar jashtë vendit, nga dokumenti nr 20.1 dhe 20 ku gjenden CV akademike të stafit akademik rezulton se 4 prej anëtarëve të stafit akademik kanë mbrojtur gradën Doktor Shkencash jashtë vendit dhe jo vetëm një si pretendohet nga GVJ. Gjithashtu një prej tyre mban edhe Titullin Prof.Dr. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Vërejtjet nga GVJ janë reale dhe të qëndrueshme. Dokumentat që dorëzohen duhet të jenë për PS bachelor që të mos ngatërohen gjatë shqyrtimit. **GVJ bën ndryshime në**

## **RVJ përfundimtar.**

**59. Standardi IV 2, kriteri 4** – Paraqitja në Draft RVJ: Kontrata për profesore të ftuar është dorëzuar 2 here (nr. 54), por të vitit 2009 dhe jo të viteve të fundit. Kontratë FBU me Univ. e Mitrovicës, Marrëveshje FBU me Univ. e Varshavës. Megjithatë, në bazë të dokumentit 34.1, Format i marrëveshjes së bashkëpunimit, nuk janë dorëzuar nga GVB marrëveshje të nënshkuara midis Fakultetit FBU dhe Bizneseve, është dorëzuar vetëm një tabelë përmbledhëse nr. 32.1. Pyetësoni për studentët Format Tip, duhet të ishte vetëm për Bachelor profilin Teknologji Agrorëshqimore dhe jo profilin Enologji dhe masterin.

*Komenti i UBT - Dokumenti nr.54 është një shembull mbi Vendimet e Senatit për aprovimin e staft akademik të ftuar. Bashkangjitur këtij dokumneti do tju dërgohet një kopje e përditesuar. Dokumentet e dorëzuara 34.1 "Template Format marrëveshje bashkëpunimi" si dhe dokumenti nr 34.2 "Lista e marrëveshjeve me bizneset Ushqimorë", tregon marrëdhëniet bashkëpunuese që janë vendosur midis Njësisë Kryesore dhe Industrive përkatëse. Kjo listë vërtetohet nga Përgjegjësi i DTAU dhe është përpiluar mbi bazën e marrëveshjeve të nënshkuara që janë të depozituara në DTAU. Dokumentacioni 35\_2 mbi Programin dhe realizimin e Praktikës Profesionale vërteton bashkëpunimin institucional që FBU ka me bizneset. Në plotësim të dokumentacionit të disponueshëm lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit midis Universitetit apo FBU-së dhe biznesit, do të bashkangjitet dhe një format i plotësuar i këtij dokumenti. Format i Pyetësorit të Studentëve është i unifikuar për të gjithë PS e IAL-së. Në dokumentacionin e dorëzuar gjenden formatet e pyetësorit që realizohen në FBU, sipas programeve të studimit.*

*Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Vërejtjet nga GVJ janë reale dhe të qëndrueshme. Dokumenti nr. 54 është i vitit 2009 dhe jo i pesë viteve të fundit. Në dokumentat e bashkëngjitur së fundmi është kopja e përditësuar. Format-marëveshja, lista e marrëveshjeve 32.1 dokumentin nr. 35.2 nuk tregon detyrimisht se pranë Fakultetit është ngjitur sistemi i bashkëpunimeve me Industrinë përkatëse. Marrëveshjet duhet të jenë zyrtarizuar ose institucionalizuar nepërmjet kontratave të nënshkuara nga të dy palët. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, është një marrëveshje bashkëpunimi e nënshkuar midis FBU dhe fabrikës së pijeve alkoolike "GJ Kastrioti" Durrës. Megjithatë GVJ i përmbahet vërejtjes së cituar më sipër, që mbetet detyrë të rregullohen marrëveshjet institucionale ndërmjet Fakultetit dhe bizneseve të Agropërpunimit nepërmjet kontratave të nënshkuara dypalëshe. Obieksioni është i drejtë, pyetësoni për studentët është i unifikuar, por duhet të dorëzohet vetëm për PS që po shqyrtohet. **GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar**

## **60. Vlerësimi i dhënë për Standardin IV.2 nga GVJ: KRYESISHT**

*Komenti I UBT – Kërkojmë nga GVJ, që të rishikojë disa nga kriteret të cilësuar si të Papërbushura dhe të japë Vlerësimin "Plotësisht".*

**Përgjigje e GVJ** - Vlerësimi i GVB për standardin IV.2 është kryesisht. Bazuar në komentet më sipër për kriteret. GVJ bën ndryshime ne RVJ përfundimtare Vlerësimi për këtë standart IV.2 bëhet **PLOTËSISHT**.

**61. Standardi IV.3, kriteri 1** - Paraqitja në Draft RVJ: "Në dokumentat nr. 42.1 / 2/ 3,

paraqitet ë dhëna për infrastrukturën për të gjithë FBU, por që të krijohet një pasqyrë më e qartë duhet një dokument për raportin pedagog dhe student në lidhje me ambientet përkatëse për Bachelorin me profil TAU. Në dokumentat 42.1 dhe 42.2, tregohet se FBU ka 21 salla Laboratori, por në kriterin 3 të këtij standardi ka 20 salla Laboratori dhe më poshtë tregohet se ky program shfrytëzon 18 laboratore. Sipas raportit të GVB, në dispozicion të këtij Programi janë 4 godina, në të cilën përfshihen 9 salla leksionesh, 18 laboratorë, 5 linja eksperimentale të teknologjisë së përpunimit ushqimor. Në dokumentin nr. 42.3, Ambientet e FBU, Shërbimet që kërkohen, ku për çdo ambient tregohen baza materiale (orenditë dhe mënyra e ngrohjes). Në dokument shprehen shifra reale dhe teorike, të cilat jo gjithmonë janë në përputhje. Megjithatë, në raportin 2017-2018 një nga problematikat është sigurimi i ngrohjes në të gjitha ambientet e studimit, si dhe disa zyrave.

*Komenti I UBT - Dokumenti i llogaritjes të raportit të sipërfaqe/ student është realizuar nga experti i IAL-së. Në këtë raport, dokumenti nr 42.2 pasqyrohet qartë se FBU-ja plotëson standardin e vendosur nga standartet shtetërore të cilësisë. Kriteri në shqyrtim nuk i referohet raportit pedagog dhe student në lidhje me hapësirat përkatëse për BSc TAU, por vetëm për raportin sipërfaqe/student. Në Dokumentat 42.1 dhe 42.2 nuk përshkruhet se programi i studimit të BSc në TAU shfrytëzon 18 laboratore. Përkundrazi, në këtë dokument janë përfshirë realisht 21 salla Laboratori, dhe programi i studimit BSc në IAU-TAU realisht përdor vetëm 20 të tilla. Laboratori Shkencor i Mikrobiologjisë dhe Ushqimit që figuron në këtë dokument nuk shfrytëzohet për PS BSc në IAU Profili TAU. Kjo vërejtje është e shpjeguar edhe në standardin IV. 2 kriteri 1 objeksion në piken 1 dhe 2. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Problemi i hapësirave të pamjaftueshme për laboratorët e pohon dhe vetë institucioni nga raporti analizës 2017-2018. "Mbetet problem hapësira e kufizuar e ambienteve të mësimdhënies, në vecanti e laboratorëve, të cilët kanë sipërfaqe të vogla në krahasim me numrin e studentëve në një grup, mesatarisht 20/25 studentë. Kjo vështirëson lëvizjen dhe punën nëpër laboratore." Në dokumentat 42.1 dhe 42.2, tregohet se FBU ka 21 salla Laboratori, por në kriterin 3 të këtij standardi ka 20 salla Laboratori dhe më poshtë tregohet se ky program shfrytëzon 18 laboratore. GVJ konstatoi gjatë vizitës në ambiente pajisjet, por iu është referuar edhe raporteve të dorëzuara. **GVJ nuk bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar**

**62. Standardi IV.3, kriteri 3** – Paraqitja në Draft RVJ: Dokumenti nr. 53.1 (nuk figuron në referencat). Duhet të specifikohet laboratore që shfrytëzohen për Bachelor në IAU me profilTAU

*Komenti i UBT - Dokumenti nr 53.1. është i indeksuar Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm me nr 284. Në Raportin e Vetëvlerësimit të Brendshëm, standarti IV.2 kriteri 3, janë të specifikuar të gjithë labororet që përdoren në programin e studimit të BSc në TAU. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigja GVJ** - Dokumenti nr. 53.1 në dokumentat e dorëzuara online nga Institucioni nuk është "Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm me nr 284" sipas objeksionit të parë, por është "FLETE INVENTARI-FBU.pdf". Dokumenti nr. 53.1 nuk figuron tek referencat. Në objeksionin e kriterit të parë, pika thuhet se: "Në Dokumentat 42.1 dhe 42.2 nuk përshkruhet se programi i studimit të BSc në TAU shfrytëzon 18 laboratore. Përkundrazi, në këtë

dokument janë përfshirë realisht 21 salla Laboratori, dhe programi i studimit BSc në IAU-TAU realisht përdor vetëm 20 të tilla. Laboratori Shkencor i Mikrobiologjisë dhe Ushqimit që figuron në këtë dokument nuk shfrytëzohet për PS BSc në IAU Profili TAU.” Atëherë, në kriterin 3 (aktual), në raportin e GVB janë vendosur 20 laboratore, hiq dy të fundit që nuk përdoren sipas objeksionit ngelen 18 laboratore në shfrytëzim. **GVJ nuk bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar**

**63. Standardi IV.3, kriteri 4** - Komenti në RVJ: “Meqë fusha e studimit është Inxhinieri Agrorshqimore, që studenti të kompletohet nga ana inxhinierike, programi duhet të pasurohet me lëndë mbi modelimin, projektimin, simulimin e teknologjive të ndryshme agrorshqimore, duke përdorur programe të ndryshme inxhinierike. Format i marrëveshjes së bashkëpunimit, nuk janë dorëzuar nga GVB marrëveshje të nënshkruara midis Fakultetit FBU dhe Bizneseve, është dorëzuar vetëm një tabelë përmbledhëse nr. 32.1 dhe nr.34.2”.

*Komenti I UBT - Siç është trajtuar edhe gjatë takimeve me GVJ, kemi shprehur dinamizmin e ndryshimit të kurrikulës në funksion të përmirësimit të cilësisë, e cila është pasuruar vazhdimisht me module të reja inxhinierike si psh “Pajisje Matëse dhe të Kontrollit”, dhe jo “Kontrolli Automatik” si kundër përmendet në RVJ, është bërë pjesë e kurrikulës vitin e kaluar akademik për herë të parë pasi u përgatitën kuadrot e nevojshme për të implemetuar këtë lëndë. Arsyeya pse u fut si modul me zgjedhje ishte sepse kjo disiplinë po implemetohej për herë të parë dhe DTAU kishte për qëllim, të studjonte cilësinë e mësimdhënies dhe interesin që do të shprehnin studentët në lidhje me të. Pas marrjes së rezultatit pozitiv nga pyetësori me studentët, u vendos që në kurrikulën e vitit 2019-2020, lënda të përcaktohet si modul i detyrueshëm në këtë program studimi. Kriteri në fjalë, flet mbi gjëndjen e laboratorëve informatikë për realizimin e seancave laboratorike të inxhinierisë dhe jo për pasurimin e programin të BSC TAU me module inxhinierike. Në lidhje me këtë kriter, FBU, është angazhuar në plotësimin e një laboratorit të tillë edhe në ciklin e parë të studimit. Në programet e moduleve të inxhinierisë agrorshqimore sidomos në modulet me karakter teknologjik janë shtjelluar tematikat e modelimit, projektimit dhe simulimit të teknologjive ushqimore. Demonstrimet e tyre realizohen në linjat përpunuese pilot që disponon DTAU/FBU gjatë seancave laboratorike. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Lënda “Pajisjet matëse dhe të kontrollit” përbën një nga lëndët më të rëndësishme për PS Inxhinierë. Duhet të ishte modul i detyrueshëm që në momentet e themelimit të këtij PS. Kjo lëndë është në vazhdimësi të lëndëve “Bazat e transmetimit të nxehtësisë” dhe “Proceset themelore”. Studenti duhet të njihet me modulet inxhinierikë nga ana teorike, duke e aplikuar në laboratorë kompjuterik. GVJ vlerëson angazhimin e FBU për laborator të tillë në ciklin e parë. Në këtë rast, po flasim për laboratorë kompjuterik dhe jo linja pilot. **GVJ nuk bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar**

**64. Standardi IV.3, kriteri 5** – Paraqitja në Draft RVJ: Format i marrëveshjes së bashkëpunimit, nuk janë dorëzuar nga GVB marrëveshje të nënshkruara midis Fakultetit FBU dhe Bizneseve, është dorëzuar vetëm një tabelë përmbledhëse nr. 32.1 dhe nr. 34.2.

*Komenti I UBT - Kjo vërejtje është e shpjeguar edhe në standardin IV. 2 kriteri 4 objeksion në piken 2 dhe2. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Format-marëveshja dhe lista e marrëveshjeve 32.1 nuk tregojnë detyrimisht se



pranë Fakultetit është ngjitur sistemi i bashkëpunimeve me Industrinë përkatëse. Marëveshjet duhet të jene zyrtarizuar ose institucionalizuar nepërmjet kontratave të nënshkruara nga të dy palët. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, është një marëveshje bashkëpunimi e nënshkruar midis FBU dhe fabrikës së pijeve alkoolike “GJ Kastrioti” Durrës.  
GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar

**65. Vlerësimi i Standardit IV.3 sipas GVJ është: “KRYESISHT**

*Komenti I UBT – Kërkojmë nga GVJ, që të rishikojë disa nga kriteret të cilësuar si të Papërbushura dhe të japë Vlerësimin “Plotësisht”.*

**Përgjigje GVJ - Vlerësimi i GVB për standardin IV.3 është kryesisht. Bazuar në komentet më sipër për kriteret që nuk plotësohen. GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare Vlerësimi për këtë standart IV.3 mbetet KRYESISHT**

**66. Standardi IV. 4, kriteri 1** – Paraqitja në Draft RVJ: Grupi i Vlerësimit të jashtëm nuk pati mundësi të shikoj dhe të njihet me sallat dhe mënyrën e organizimit të bibliotekës, për shkak të një takimi të papritur të përgjegjëses së bibliotekës në Akademinë e Shkencave.

*Komenti I UBT - Gjatë vizitës së GVJ, në ambientet e bibliotekës, përgjegjësi i Bibliotekës, nuk ishte prezent për shkak të një takimi në Akademinë e Shkencave, megjithatë ai u tregua i gatshëm të kthehej menjëherë dhe të mundësonte takimin me grupin. Ky disponibilitet nuk u konsiderua nga GVJ. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ -** Axhenda e vizitës së GVJ pranë ambienteve të bibliotekës u përcaktua nga specialistja e ASCAL që në muajin maj, me dakortësinë e të gjitha palëve dhe për takimin e përgjegjësit të bibliotekës në Akademinë e Shkencave nuk ishte lajmëruar as specialistja e ASCAL dhe as përgjegjësjë e departamentit. Përpara këtij fakti duhet të ishin marë masa. Megjithatë po të shikohet vlerësimi përfundimtar, GVJ nuk e ka marë në konsideratë, meqë një nga ekspertët e jashtëm ishte pjesë e një grupi tjetër akreditimi në këtë fakultet dhe i kishte parë ambientet dhe ishte e informuar më parë. Ky vendim u mor në prani të GVJ, specialistes së ASCAL dhe përgjegjëses së departamentit.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**67. Standardi IV. 4, kriteri 2** - Paraqitja në Draft RVJ: Grupi i Vlerësimit të jashtëm nuk pati mundësi të shikoj dhe të njihet me sallat dhe mënyrën e organizimit të bibliotekës, për shkak të një takimi të papritur të përgjegjëses së bibliotekës në Akademinë e Shkencave.

*Komenti I UBT - Ju lutem referojuni oponences së kriteri 1, standardi IV.4 (me lart)*

*Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ --** Ju lutem referojuni përgjigjes së dhënë në kriterin 1, standardi IV.4.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**68. Standardi IV. 4, kriteri 3** - Paraqitja në Draft RVJ: Grupi i Vlerësimit të jashtëm nuk pati mundësi të shikoj dhe të njihet me sallat. Sipas raportit të GVB, në kuadër të Projektit Erasmus+ “Library Network Support Services” (LNSS), jemi pjesë e platformës Springshare LNSS, një platformë online, me burime shumë të pasura informacioni 199, por kjo nuk ndodhet në referencën përfundimtare dhe dokumentat e dorëzuara. Sipas raportit GVB, shpreh

se janë në hapat e parë, drejt implementimit të platformës RASH, ku stafi akademik dhe studentet nëpërmjet sistemit ESS3 do të kenë akses në mijera punime shkencore, libra apo revista të botuara në të gjitha fushat e studimit, por nuk ka asnjë dokument shoqëruar

*Komenti i UBT - Kriteri në fjalë nuk flet për gjendjen e sallave të bibliotekës por për aksesin në librarinëonline. Ashtu siç përmendet tek Raporti i Vlerësimit të brendshëm universiteti sapo ka nisur me implementimin e platformes RASH, trajnimet e para të funksionimit të këtij sistemi përkuan me dorëzimin e Raporti i Vlerësimit të Brendshëm. Implementimi i platformës është akoma në proces, prandaj dhe nuk disponohet një manual përfundimtar. Në lidhje me dokumentacionin nr 45.3 që i referohet platformës Springshare LNSS, konstatohet se është dorëzuar në të dy formatet soft dhe hardcopy. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ -** Vërejtjet e GVJ kanë rezultuar nga raporti i GVB. Sipas raportit të GVB: “Bibliotekat janë të pajisura me salla studimi dhe salla kompjuterike ku studentët kanë akses përdorimi. Rrjeti kompjuterik dhe shërbimi i internetit është i pa ndërprerë dhe pa pagesë”, pra shpjegon gjendjen e sallave. Vlerësimi i GVJ është në bazë të RVB. Sipas raportit të GVB: “Në kuadër të Projektit Erasmus+ “Library Network Support Services” (LNSS), jemi pjesë e platformës Springshare LNSS, një platformë online, me burime shumë të pasura informacioni<sup>199</sup>.”, pra jepet nr. 199 për referencë. Ky numër nuk ndodhet në referencën përfundimtare. Sipas raportit të GVB: “Ndërkohë, jemi në hapat e parë, drejt implementimit të platformës RASH, ku stafi akademik dhe studentët nëpërmjet sistemit ESS3 do të kenë akses në mijra punime shkencore, libra apo revista të botuara në të gjitha fushat e studimit.”, nuk është dhënë asnjë citim në lidhje me dokumentin 45.3. **GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**69. Standardi IV. 4, kriteri 4 -** Paraqitja në Draft RVJ: Grupi i Vlerësimit të jashtëm nuk pati mundësi ti shikonte dhe të njihej me sallat.

*Komenti i UBT - Në lidhje me vlerësimin e GVJ, referojuni objeksionin në standartin IV.4, kriteri 1. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ -** Ju lutem referojuni përgjigjes së dhënë në kriterin 1, standardi IV.4. **GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**70. Standardi IV. 4, kriteri 5 –** Paraqitja në Draft RVJ: Sipas raportit të GVB, FBU çdo vit harton një plan të detajuar për shtimin e zërave në bibliotekë, të cilën ja percjell UBT-së. Megjithatë, nuk ka një dokument të dorëzuar për këto plane të detajuara cdo vit që dorëzohen

*Komenti i UBT - Në dokumentin e dorësuar nr 49\_50, nën zërin Mallra dhe shërbime, pika f, blerje dokumenet, përdoret si planifikim buxheti për shtimin e zërave të bibliotekës. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ -** Obieksioni është i drejtë, por duhet cituar edhe tek raporti i GVB. **GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**71. Vlerësimi I Standardit IV.4 sipas GVJ është: “KRYESISHT**

*Komenti i UBT - Kërkojmë nga GVJ, që të rishikojë disa nga kriteret të cilësuar si të Papërbushura dhe të ndryshojë vlerësimin nga “Kryesisht” në “Plotësisht”*

**Përgjigje GVJ - Vlerësimi i GVB për standardin IV.4 është kryesisht. Bazuar në komentet më sipër për kriteret që nuk plotësohen. GVJ nuk bën ndryshime në RVJ perfundimtare**  
**Vlerësimi për këtë standart IV.4 mbetet KRYESISHT**

**72. Standardi IV.5, kriteri 1 - Paraqitja në Draft RVJ: Dokumenti nr. 5, Rregullore e Studimeve Universitare (290), mungon në dokumentat e dorëzuara online Obieksion: Në lidhje më objeksionin mbi këtë kriter, ju lutem referojuni standartit I.1 kriteri 1. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri**

**Përgjigja e GVJ -** Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të RVJ vërejmë se ky dokument është paraqitur. **GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**73. Standardi IV.5, kriteri 2 - Paraqitja në Draft RVJ:** Grupi i punës për vlerësimin e brendshëm në FBU 2014, me 10 anëtarë: 1 Prof. Dr. (kryetar), 1 Prof. Asoc. Dr., 2 Dr., 4 MSc, Kancelarja e FBU dhe Specialistja e Zyrës së Karrierës dhe Studentëve. Në grupin e vitit 2014, anëtarët janë nga të gjithë departamentet, ndërsa në 2018, departamenti i Kimisë mungon. Në Rregulloren e FBU, tek Komisionin e Sigurimit të cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor është e paplotësuar (Kreu II, Organizimi dhe drejtimi në FBU).

*Komenti i UBT - Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm rregullorja e njesisë bazë nuk ka një rregull të veçantë për zgjedhjen e tyre. Përzgjedhja bëhet në mënyrë rastësore, bazuar dhe në ngarkesën mësimore semestrale të stafit akademik. Konstatimi i GVJ, është i drejtë pasi në Rregulloren e FBU, kreu II, është i paplotësuar vetëm neni 11. Ky dokument do të rishikohet dhe do të plotësohet menjëherë. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ:** - Ky koment është i dhënë edhe në kriterin 2. GVJ është dakord me obieksionin se nuk ka kriter për ngritjen dhe përzgjedhjen e grupit të GVB, por akreditimi i një PS duhet të jetë gjithëpërfshirës edhe duke i paraqitur me komente në GVB fillestare.

**GVJ nuk bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**74. Standardi IV.5, kriteri 5 - Paraqitja në Draft RVJ:** Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, regjistri I pedagogut nuk është nr.58, por nr. 61.1 (e para)/2/3.

Ndërsa në dokumentin 61.1 (i dyti) nuk ka lidhje me regjistrin e pedagogut. Plani kalendar i mësimdhënies, në referimet tregohet nr. 14.6, por nuk është në dokumentacionin e dorëzuar. Nuk ka një plan të përgjithshëm, por plane kalendare për secilën lëndë të pa specifikuar, thjesht emri i pedagogut. Gjithashtu, planet kalendare nuk janë të unifikuara dhe në disa prej tyre percaktimi seminare, laboratore, praktika nuk janë në pozicionin e duhur.

*Komenti i UBT - Indeksi i dokumentit me nr.58 i referohet paraqitjes numerike të dokumentacioneve në versionin soft copy. Në këtë dosje paraqiten dy dokumenta me nr.61\_1 faqja e parë e regjistrit dhe 63\_3, kapaku i regjistrit. Gjithashtu konstatohet se në këtë dosje gabimisht është bashkangjitur dhe një dokument i cili nuk i perket informacionit mbi regjistrin. Planet kalendare të indeksuara me nr 14.6 janë dorëzuar në të dy formatet soft dhe hard copy, në të cilat detajohen të dhëna në kohë reale mbi zhvillimin e planit mësimor për çdo javë të semestrit. Ndërkohë ekziston dhe Plani Mësimor me nr. Dokumneti 14.5, i vënë në dispozicion për GVJ në të dy formatet. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje*

*reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Grupi i GVJ konstaton vërejtje reale dhe të qëndrueshme, në momentin që bëhen gabime me identifikimin dhe paraqitjen e dokumentave, sepse krijon konfuzion në vlerësim. Në listën e dokumentave bazë nr. Ref. 298 është për nr. 58, i cili nuk është në dokumentat online. Dokumenti nr. 14.6 nuk është dorëzuar në momentin e hartimit të RVJ përfundimtare. Në dokumentat e shtuara nuk është paraqitur modeli i referimit, por është paraqitur plani kalendarik i një pedagogu. Pas këtij plani kalendarik, janë bashkangjitur syllabuset e pedagogëve të tjerë, që nuk kanë lidhje me dokumentin. Megjithëse, dokumenti nr. 14.5 nuk është cituar nga RVB që të merrej parasysh, grupi i GVJ duke u bazuar tek plani mësimor shpreh se planet kalendare nuk janë të unifikuara dhe në disa prej tyre përcaktimi seminare, laboratore, praktika nuk janë në pozicionin e duhur. **GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**75. Vlerësimi I Standardit IV.5 sipas GVJ është: “KRYESISHT**

*Komenti I UBT - Kërkojmë nga GVJ, që të rishikojë disa nga kriteret të cilësuar si të Papërmbushura dhe të Ndryshojë vlerësimin nga “Kryesisht” në “Plotësisht”*

**Përgjigje e GVJ** - Vlerësimi i GVB për standardin IV.5 është kryesisht. Bazuar në komentet më sipër për kriteret. GVJ bën ndryshime në RVJ përfundimtare, **Vlerësimi për këtë standart IV.5 bëhet PLOTËSISHT.**

**76. Vlerësimi i Standardit IV.6, kriteri 1** Paraqitja në Draft RVJ: GVJ nuk kontrollon dot nëse veprimet janë të sakta për Programin e studimit, sepse dokumenti i dorëzuar ka lidhje me masterin.

*Komenti i UBT - Vërejtje e saktë. Gabimisht ju kemi vënë në dispozicion dokumentin e Masterit. Bashkangjitur këtij material do tju dërgohet një kopje e raportit financiar të kostove të programit të studimit BSc në TAU. Dokument i indeksuar me nr.49-50.*

**77. Përgjigje GVJ** - Nga shqyrtimi i dokumentave të dorëzuara, dokumenti me nr. 49-50 rezulton. **GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**78. Vlerësimi I Standardit IV.6, kriteri 2** Paraqitja në Draft RVJ: Dokumenti nr. 4 sipas referimeve nuk është dorëzuar). Në bazë të dokumentit 34.1, Formatin e marrëveshjes së bashkëpunimit, nuk janë dorëzuar nga GVB marrëveshje të nënshkruara midis Fakultetit FBU dhe Bizneseve, është dorëzuar vetëm një tabelë përmbledhëse nr. 32.1.

*Komenti I UBT - Në dokumenta hard copy gjendet i kodifikuar si Dokumenti nr.4 “Strategjia e zhvillimit të programeve të studimit në FBU në të cilën është paraqitur dhe Planin strategjik të zhvillimit të PS BSc në Teknologji Agrorëshqimore. Në plotësim të dokumentacionit, do tju dërgojmë dhe një kopje të këtij materiali. Dokumentet e dorëzuara 34.1 “Template Format marrëveshje bashkëpunimi” si dhe dokumenti nr 34.2 “Lista e marrëveshjeve me bizneset Ushqimorë”, tregojnë marrëdhëniet bashkëpunuese që janë vendosur midis Njesisë Kryesore dhe Industrive përkatëse. Në plotësim të dokumentacionit të disponueshëm lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit midis Universitetit apo FBU-së dhe biznesit, do të bashkangjitet dhe një format i plotësuar i këtij dokumenti. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigja e GVJ** - Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, dokumentat nuk figuronin. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur. **GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**79. Vlerësimi I Standardit IV.6, kriteri 4** Paraqitja në Draft RVJ - Sipas raportit të GVB, në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, FBU-ja dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Megjithatë, nuk është dorëzuar ndonjë dokument për analizën financiare dhe raportet e institucionit, për tre vitet e fundit

*Komenti I UBT - Konstatimi i GVJ është i drejtë. Të ardhurat në rritje të universitetit vijnë dhe si pasojë e rritjes së vazhdueshme të studenteve të paraqitur në evidencat e rregjistrimit, dokumenti nr.27 dhe gjithashtu dhe nga projekte të shumta që FBU ka fituar në vitet e fundit si janë paraqitur në dokumentat nr.9 dhe 43.6.*

**Përgjigje GVJ** - Në plotësimin e dokumentave të dorëzuara, rezulton dokument për analizën financiare dhe raportet e institucionit, për tre vitet e fundit. GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.

**80. Vlerësimi I Standardit IV.6, kriteri 5** - Paraqitja në Draft RVJ - Sipas raportit të GVB, FBU në këto tre vitet ka pasur një rritje në të ardhurat e saj si nga ato të miratuara nga buxheti i shtetit por edhe nga ato të krijuara nga vetë institucioni. Megjithatë, nuk është dorëzuar ndonjë dokument për rritjen financiare, për tre vitet e fundit

*Komenti I UBT - Mendojmë se për këtë informacion GVJ duhet të kishte marrë një informacion nga drejtorja e financave të institucionit. Gjithsesi, do të vihet në dispozicion në dokumentat mbështetëse të kësaj oponente, një raport për rritjen e të ardhurave për FBU.*

**Përgjigje GVJ** - GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.

**81. Vlerësimi I Standardit IV.6 sipas GVJ është: "PËRMBUSHET KRYESISHT"**

*Komenti i UBT - I lutemi GVJ, që të rishikojë disa nga kriteret të cilësuar si të papërbushura duke marrë në konsideratë dokumentat mbështetëse shtesë që do të vihen në dispozicion dhe vlerësimi të kalojë nga "Përbushet Kryesisht" në "Përbushet Plotësisht"*

**Përgjigje e GVJ** - Vlerësimi i GVB për standardin IV.5 është kryesisht. Bazuar në komentet më sipër për kriteret që nuk plotësohen. **GVJ bën ndryshime në RVJ përfundimtare. Vlerësimi për këtë standart IV.5 bëhet PLOTËSISHT**

**82. Komenti I UBT** - Siç konstatohet nga shqyrtimi i vlerësimit të Standardit IV, vërejtjet e bëra janë të pakta. Lutemi rishikimin e vlerësimit të Standardit IV nga "Kryesisht" në vlerësimin "Plotësisht"

**Përgjigje GVJ** -- Nga rishikimi i standardeve të fushës IV, vlerësimi është katër standarde me vlerësim "kryesisht" dhe dy me vlerësim "plotësisht"

**GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare, vlerësimi i fushës IV është PLOTËSISHT**

**83. Vlerësimi i Standardit V.2, kriteri 5** - Paraqitja në Draft RVJ: Sipas raportit të GVB,

Para çdo fillimi viti akademik UBT dhe FBU përdor metoda dhe mjete për të udhëzuar publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të programit të studimit për ciklin e parë të studimit në IAU pranë DTAU, por sipas GVJ por në dokumentacionin e dorëzuar nuk janë (dokumenti nr. 51).

*Komenti i UBT -- Pas rishikimit të kopjes soft, të dorëzuar tek GVJ, konstatohet se ky dokument është i disponueshëm në formën e një dosjeje me numër dokumenti 51. Për rrjedhojë, nuk konstatohet asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigja e GVJ** - Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur. **GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**84. Vlerësimi I Standardit V.2 nga GVJ është: “KRYESISHT**

*Komenti I UBT – Kërkojmë që vlerësimi i standartit V.2 të rishikohet dhe të kalojë nga “Përbushet Kryesisht” në “Përbushet Plotësisht”*

**Përgjigja e GVJ** - Obieksioni dhe kërkesa e institucionit është marrë në konsideratë. Standarti V.2 vlerësohet Plotësisht. **GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtar standardi V.2 vlerësimi bëhet PLOTËSISHT.**

**85. Vlerësimi I Standardit V.3, kriteri 4** *Komenti I UBT - Në RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje negative lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetet konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin.*

**Përgjigje e GVJ** - Në Draft RVJ e dorëzuar për këtë kriter shkruhet “Karrierës së Studentëve (ZKS) pranë FBU-së, në mënyrë të përvitshme përgatit paketën e informacionit orientues, publikon: -broshurën e programit të studimit, -fletëpalosjen e FBU, -fletëpalosjen e Qendrës së Karrierës, -fletëpalosjen e UBT, -guida e studimeve në FBU, etj. Këto materiale u vëzhguan gjatë vizitës së GVJ por në dokumentacionin e dorëzuar nuk janë (dokumenti nr. 51).” Në këtë kriter ishte cituar dokumenti nr. 51. Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është paraqitur. **GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtar.**

**86. Vlerësimi i Standardit V.3 nga GVJ është: “KRYESISHT”**

*Kërkojmë që vlerësimi i standartit V.3 të rishikohet dhe të kalojë nga “Përbushet Kryesisht” në “Përbushet Plotësisht”*

**Përgjigja e GVJ** - Obieksioni dhe kërkesa e institucionit është marrë në konsideratë. Standarti V.3 vlerësohet Plotësisht. **GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtar standardi V.3 vlerësimi bëhet PLOTËSISHT.**

**87. Vlerësimi I Standardit V.4, kriteri 1** – Paraqitja në Draft RVJ: Sipas raporti të GVB, UBT dhe FBU disponon struktura që përgjigjen për ruajtjen e dokumentacionit në letër lidhur me studentët që nga fillimi deri në përfundim të studimeve sikurse janë: Regjistri Themeltar i Studentëve, Regjistri i Arritjeve Akademike, Regjistri i Dhënies së Diplomave dhe Certifikatave. Dokumenti i cituar në referenca nr.37.1, Analizat mësimore kërkimore FBU

2014-2018, nuk është në dokumentat e dorëzuara, por vetëm viti 2016-2018

*Komenti I UBT - Të gjitha të dhënat mbi studentët e regjistruar, të cregjistruar, të diplomuar, etj. për periudhën 2013-2018 janë nxjerrë nga ZSS e UBT dhe dokumentohen hollësisht në Dokumentnr.27. Analizat mësimore - kërkimore në rang FBU janë paraqitur për vitet akademike: 2014-2015, 2016-2017 dhe 2017-2018. Mungon Raporti i Analizës mësimore-kërkimore për Vitin akademik 2015-2016, sepse siç është spjeguar edhe ne takimin me GVJ dhe në RVB, ky vit ka qenë vit zgjedhjesh dhe dekanati ishte i angazhuar me procedurat e zgjedhjeve në rang fakulteti dhe universiteti.*

**Përgjigje GVJ:** Në RVB për kriterin e I është cituar dokumenti numër 37.1. “FBU-ja nëpërmjet të dhënave që merr nga ZKS, harton raporte vjetore lidhur me shkallën e kalueshmërisë dhe nr e studentëve të diplomuar (340).” Prandaj, vlerësimi nga GVJ është kryer në bazë të informacionit nga GVB. Në këtë rast, Dokumenti nr. 27 (I duhuri) u shqyrtua dhe është konform me kriterin 1.

Ndërsa, në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, dokumenti nr. 37.1 nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është plotësuar për vitet e tjera. **GVJ nuk bën ndryshim në RVJ**

**88. Vlerësimi I Standardit V.4, kriteri 2 –** Paraqitja në Draft RVJ: GVJ zhvilloi takim në Sekretarinë mësimore dhe pa nga afër Rregjistrin Themeltar të studentëve, Rregjistrin e notave dhe atë të diplomimit dhe u gjeten mosperputhje me deklaratimet e bera.

*Komenti i UBT - Siç u theksua më lart, në dokumentat nr.27 gjenden të dhëna nga ZSS e UBT lidhur me Numrin e studentëve të regjistruar në programet e ciklit të parë, tërheqjet nga programi, regjistër notash etj. “Mospërputhjet” e vërejtura janë gjetur në numrin e studentëve të regjistruar në ciklin e parë të PS Bach në LAU-TAU. Kjo ka ndodhur për arsyen e thjeshtë, se të dhënat që disponohen në dok.nr.27 janë marrë mbi bazën e studentëve të regjistruar deri në muajin Nëntor në sekretari. Ndërkohë, numri real i studentëve që kanë frekuentuar (pra përfundimisht ata student që pas regjistrimit kanë vazhduar mësimin) vitin e parë është më i vogël. Ky numër përbën numrin real të tyre dhe disponohet në ZSS vetëm pas semestrit të parë, zakonisht në Maj – periudhë në të cilën GVJ ka vizituar zyrën e ZSS-UBT. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ:** - Vizita në ZSS u krye në 17 qershor. Komenti real në RVJ është “GVJ zhvilloi takim në Sekretarinë mësimore dhe pa nga afër Rregjistrin Themeltar të studentëve, Rregjistrin e notave dhe atë të diplomimit.” dhe fjalia e fundit “u gjeten mosperputhje me deklaratimet e bëra” nuk është pjesë e komentit të RVJ. Duhet të rilexoni edhe njëherë vlerësimin. Zyra e ZSS i sqaroi ndryshimet e kryera. **GVJ nuk bën ndryshim në RVJ**

**89. Vlerësimi i Standardit V.4, kriteri 5 –** *Komenti i UBT - Në RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje negative lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetes konstatohet i plotë dhe në perputhje me kriterin.*

**Përgjigje GVJ -** Në RVJ: “Në këtë raport paraqiten të detajuar problematikat që lidhen me: - ecurinë dhe kalueshmërinë e studentëve (Dokument i cituar në referenca nr.37.1, Analizat mesimore kerkimore FBU 2014-2018, nuk është në dokumentat e dorëzuara, por vetëm viti 2016-2018).”

Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, dokumenti nr. 37.1 nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është plotësuar për vitet e tjera **GVJ nuk bën ndryshim në RVJ**

**90. Vlerësimi I Standardit V.4 sipas GVJ është: “KRYESISHT”**

*Komenti i UBT – Kërkojmë nga GVJ, që të rishikojë disa nga kriteret të cilësuar si të papërmbushura, pasi vërejtjet nuk janë rilevante për cilësinë e standardit dhe kalimin nga Vlerësimi “Përmbushet kryesisht” në Vlerësimin “Përmbushet plotësisht”*

**Përgjigje e GVJ** - Bazuar në komentet më sipër për kriteret që nuk plotësohen

GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare. **Vlerësimi për këtë standart V.4 mbetet KRYESISHT**

**91. Vlerësimi I Standardit V.5, kriteri 1** – paraqitja në Draft RVJ: lidhur me nismën Pakti për Universitetin të vitit 2019, studentët ju jepet e drejta të përfaqësohen me një antarë të zgjedhur edhe në Bordin e Administrimit. (Nuk ka dokument).

*Komenti i UBT - Konstatim i saktë. Nuk kemi dërguar dokumentin mbështetës. Por në të vërtetë, me nismën Pakti për Universitetin studentët janë të përfaqësuar nga kandidati i përzgjedhur prej tyre në Bordin e Administrimit. Kjo vërtetohet me dokumentin me nr. protokollin 134, datë 20/02/2019. Ky dokument do ti bashkangjitet këtij materiali. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë asnjë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ:** - Vërejtja është reale dhe e qëndrueshme në periudhën kur është bërë vlerësimi nga ekspertët e jashtëm. Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtar vërejmë se ky dokument është paraqitur.

**GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtare.**

**92. Vlerësimi i Standardit V.5, kriteri 3** – *Komenti i UBT - Në RVJ nuk është paraqitur asnjë vërejtje negative lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështetës konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin.*

**Përgjigja GVJ:** Në bazë të RVJ “Dokumenti i Studimeve Universitare (350), mungon në dokumentat e dorëzuara online.” Kjo tregon se ka vërejtje. Në citime është Nr. 5 Rregullore e studimeve universitare UBT 2017, Ref. 350. Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, ky dokument nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtar vërejmë se ky dokument është paraqitur. **GVJ bën ndryshimin përkatës në RVJ përfundimtare**

**93. Vlerësimi I Standardit V.5, kriteri 4** – Paraqitja në Draft RVJ - Komenti në RVJ: është konstatuar se gjatë takimit me studentët nuk ishte i pranishëm studenti që është përfaqësues në Këshillin Studentor dhe as viti I dhe as i II nuk kishin senator, përfaqësues të grupeve, dhe Pytesori i studentëve duhet të ishte i PS BSc TAU dhe jo e një programi tjetër studimi.

*Komenti i UBT - Realisht janë zhvilluar zgjedhjet e rregullta për Përfaqësuesin në Këshillin Studentor, që është njëkohësisht edhe përfaqësues në Senatin e UBT, por këto zgjedhje janë zhvilluar para përpilimit të RVB, ndaj nuk është dorëzuar dokument. Ky student (D.M) nuk ndodhej atë ditë i pranishëm në takimin me GVJ për arsye familjare. Në dokumentacionin shtesë*



*po japim dokumentin e zgjedhjes së D.M. Në dokumentin 30.2 tregohet zgjedhja e studentit E.H. në Komisionin e Etikës së FBU dhe studentes K.S në Komisionin e Sigurimit të Cilësisë. Në dokumentin nr.40 paraqiten në mënyrë të plotë të gjithë pyetësorët e studentëve, në veçanti për çdo Program Studimi që ofron FBU, përfshirë këtu edhe PS në Bachelor IAU-ProfilinTAU. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ-** Vërejtja është reale dhe e qëndrueshme në periudhën kur është bërë vlerësimi nga ekspertët e jashtëm. Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, dokumenti për përfaqësues në Këshillin Studentor nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtar vërejmë se ky dokument është paraqitur.

Komenti i dhënë më sipër për RVJ nuk është i saktë: “dhe Pytesori i studenteve duhet të ishte i PS BSc TAU dhe jo e një programi tjetër studimi.”

Komenti real: Kjo tregohet në dokumentin nr. 40, Pyetësor për studentët Format Tip, por duhet të ishte vetëm për Bachelor profilin Teknologji Agrorushqimore.

GVJ i ka shqyrtuar shumë mirë dokumentat, dhe në këtë dokument ishte pyetësori për këtë profil, por i mbingarkuar nga informacione të panevojshme me profilet e tjera (Bachelor e MSc).

Ndërsa, dokumenti 30.2 nuk është shqyrtuar për këtë kriter nga GVB.

**GVJ bën ndryshim në RVJ.**

#### **94. Vlerësimi I Standardit V.5 sipas GVJ është: “KRYESISHT”**

*Komenti i UBT – Kërkojmë nga GVJ, që të rishikojë disa nga kriteret të cilësuara si të papërbushura, pasi vërejtjet nuk janë relevante për cilesinë e standardit dhe kalimin nga vlerësimi “përmbushet kryesisht” në vlerësimin “përmbushet plotësisht”*

**Përgjigja e GVJ -** Obieksioni dhe kërkesa e institucionit është marrë në konsideratë. Standarti V.5 vlerësohet Plotësisht. **GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtar standardi V.5 vlerësimi bëhet PLOTËSISHT.**

#### **95. Vlerësimi i Standardit V.6, kriteri 1 –** Paraqitja në Draft RVJ: Konstatohet mungesa e rregullores programit të studimit bachelor referenca 293

*Komenti I UBT - Rregullore e programit të studimit Bachelor në TAU, konsatohet se gjenden në formatin soft dhe hard copy, të dorëzuar bashkë me RVB, ky dokumentacion është indeksuar me nr 7. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ -** Vërejtja nga GVJ është reale dhe e qëndrueshme. Në RVJ thuhet se mungon numri 293 tek referencat dhe jo dokumenti. Dokumenti nr. 7 është një nga dokumentet më të rëndësishme dhe nuk është cituar vetëm në këtë standard. Duhet të rregullohet tek citimet në fund të RVB. **GVJ nuk bën ndryshim në RVJ.**

#### **96. Vlerësmi i Standardit V.6, kriterin 4 –** Paraqitja në draft RVJ: Konstatohet mungesa e takimit të GVJ me përfaqësuesin e Universitetit në marrëdhëniet me biznesin

*Komenti I UBT - Konstatohet se kriteri në fjalë nuk parashikon takimin e GVJ me përfaqësuesin e Universitetit në marrëdhëniet me biznesin. Ky takim nuk ishte i parashikuar në axhendën e takimeve të GVJ-së. Dokumentacioni në lidhje më këtë kriter është dorëzuar i plotë. Për*

*rrjedhje, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Nga RVJ, vlerësimi për Kriterin 3 dhe 4 janë bashkuar në një të vetëm, meqënëse kishin lidhje me njëra-tjetrën. Komenti në lidhje me Zyrën e Marrëdhënies me Biznesin është për kriterin 3 dhe u bazua në komentin e RVB: "Zyra e Marrëdhënies me Biznesin ndjek në tërësi problemet dhe problematikat e lidhura me marrëdhëniet me biznesin, ofertat për punësimin e studenteve, identifikon nevojat e bizneseve për konsulence, trajnim, kërkim shkencor, kryerjen e praktikave profesionale të studentëve. Kjo zyrë kordinon veprimtarinë e saj me Zyrën e Karrierës dhe Alumni si dhe Zyrën e Divulgimit të Informacionit (358)." Prandaj, GVJ është shprehur se nuk takuam përfaqësuesin e kësaj zyre, duke qënë se ka lidhje me Zyrën e Karrierës dhe Alumni. **GVJ bën ndryshim në RVJ.**

**97. Vlerësimi I Standardit V.6 nga GVJ është "KRYESISHT"**

*Komenti I UBT - Konstatojmëse për Standardin V.6 praktikisht nuk ka vërejtje. Kërkojmë kalimine vlerësimin nga "Kryesisht" në vlerësimin me "Plotësisht"*

**Përgjigja e GVJ** - Obieksioni dhe kërkesa e institucionit është marrë në konsideratë. Standarti V.6 vlerësohet Plotësisht. **GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtar standardi V.6 vlerësimi bëhet PLOTËSISHT.**

*Komenti I UBT - Nga shqyrtimi që iu bë vlerësimin të Standardit V u konstatua se vërejtjet e pakta nuk janë relevante dhe në të shumtën e rasteve plotësohen me dokumenta shtesë. Për këtë arsye, kërkojmë rivlerësim duke kaluar nga vlerësimi "Kryesisht" në vlerësimin "Plotësisht"*

**Përgjigje GVJ** - Nga rishikimi i standardeve të fushës V, vlerësimi është një standard me vlerësim "kryesisht" dhe pesë me vlerësim "plotësisht"

**GVJ bën ndryshime në RVJ përfundimtare, vlerësimi i fushës V është PLOTËSISHT.**

**98. Vlerësimi i Standardit VI.1, kriteri 1** – Paraqitja në Draft RVJ: Evidentohet mungesa e rregullores së departamentit DTAU nr 6.1

*Komenti i UBT - Për shkak të volumit të madh të dokumentacionit u gjykua e arsyeshme që në dokumentacionin e dorëzuar online të vëndoset vetem faqja e parë e rregullores, por në formatin*

*Hard Copy është dorëzuar një kopjë e rregullores DTAU. Konstatimi I GVJ-së mbi mos plotësimin e Kreut II në Rregullore FBU qëndron, pasi vetëm Neni 11 është i pa plotësuar. Kjo rregullore do të shikohet dhe do të plotësohet. Për rrjedhje, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Vërejtja nga GVJ është reale dhe e qëndrueshme në periudhën kur është bërë vlerësimi nga ekspertët e jashtëm. Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, dokumenti përfaqësues nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtar vërejmë se ky dokument është paraqitur

**GVJ bën ndryshim në RVJ.**

**99. Vlerësimi I Standardit VI.1, kriteri 2** – Pasqyrimi në Draft RVJ: Evidentohen të padorëzuara rezultatet e pyetësorit të pedagogëve, dok 41.

*Komenti i UBT - Pyetësori i stafit akademik dhe ndihmës është realizuar pas afatit kohor të plotësimin të RVB dhe në këtë kontekst është parë e arsyeshme të paraqitet vetëm formati i*

pyetësorit dhe jo rezultatet. Për çdo rast këto rezultate janë të disponueshme pranë DTAU, të cilat do të paraqiten në analizën mësimore vjetore të FBU. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri

**Përgjigje GVJ** - Vërejtja nga GVJ është reale dhe e qëndrueshme në periudhën kur është bërë vlerësimi nga ekspertët e jashtëm. Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, dokumenti nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtar vërejmë se është paraqitur.

**GVJ bën ndryshim në RVJ**

**100. Vlerësimi I Standardit VI.1, kriteri 3** – Pasqyrimi në Draft RVJ: Është evidentuar mungesa e pedagogeve nga departamenti i Kimise per pregatitjen e RVV2018

*Komenti I UBT - Duke qënë se ne dokumentacionin e ASCAL nuk ka një listë të kriterëve të cilat duhet të plotësojë grupi që angazhohet me ngritjen e raportin e vlerësimit të brendshëm, janë përzgjedhur anetarë nga stafi akademik të cilët janë të përfshirë në mësimdhënien në këtë PS, pa patur si synim përjashtimin nga ky proces i stafit të Departamentit të Kimisë. Në këtë përzgjedhje është marrë parasysh dhe ngarkesa e lartë mësimore që stafi i këtij departamenti ka gjatë vitit akademik, duke qënë se janë të angazhuar në mësimdhënie në të gjitha programet e studimit te UBT. Megjithatë vlenë të theksohet së nuk ka munguar ndihma e pedagogeve të angazhuar në departamentet e tjera të FBU. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Ky koment është i dhënë edhe në kriterin 2. GVJ është dakord me objeksionin se nuk ka kriter për ngritjen dhe përzgjedhjen e grupit të GVB, por akreditimi i një PS duhet të jetë gjithëpërfshirës edhe duke i paraqitur me komente në GVB fillestare.

**GVJ bën ndryshim në RVJ.**

**101. Vlerësimi I Standardit VI.1, kriteri 4** – Pasqyrimi në Draft RVJ: Komenti në RVJ: Dokumenti nr. 3.2 (373), nuk është për RVV FBU 2014 por për 2018. Në referenca tregohet se dokumenti nr. 37.2, me këtë numër nuk ka tek dokumentat e dorëzuara, por besoj se është tek dokumentat pa numër (Raporte Kom Sig Cil2017-2018).

*Komenti i UBT - Konstatimi është i drejtë por bëhet fjalë për një lapsus në shprehjen e vitit të raportit. Në kopjen soft të dokumentave që në disponojmë, konstatohet së dokumenti me nr. 37.2 ekziston, dhe gjendet në formën e një dosje e cila përbëhet prej dy dokumentave që i referohen Raporteve të Kom Sig Cil 2016-2017; 2017-2018. Një kopje tjetër e këtyre dokumentave duhet të gjendet dhe në formatin Hard Copy. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Vërejtja nga GVJ është reale dhe e qëndrueshme në periudhën kur është bërë vlerësimi nga ekspertët e jashtëm. Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, dokumenti nuk figuronte me këtë numër. Me sqarimin e GVB vërejmë se është paraqitur.

**GVJ bën ndryshim në RVJ**

**102. Vlerësimi I Standardit VI.1 sipas GVJ është: KRYESISHT”**

*Komenti I UBT – Kërkojmë rivlerësimtë Standardit VI.1 nga “Kryesisht” në “Plotesisht” Pasi nuk konstatojmë vërejtje konsistente*

**Përgjigja e GVJ** - GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtar standardi VI.1 vlerësimi bëhet

## **PLOTËSISHT.**

**103. Vlerësimi I Standardit VI.2, kriteri 5** – Pasqyrimi në Draft RVJ: Koment në RVJ: Dokumenti i cituar në referenca nr.37.1, Analizat mësimore kërkimore FBU 2014-2018, nuk është në dokumentat e dorëzuara, por vetëm viti 2016-2018. Sipas GVJ, në dokumentin nr. 38.4, Performanca e departamenteve të FBU, duhet të ishte e shoqëruar me mënyrën e përcaktimit për performancën e mësimëdhënies, kërkimit apo bashkëpunime me të tretët, rezulton nga 146.55 deri në 30.25.

*Komenti i UBT - Në kopjen soft të dokumentave që në disponojmë, konstatohet se dokumentat me nr. 37.1 Analizat mesimore kerkimore në FBU ekzistojnë dhe përfshijnë vitin 2014-2015, 2016-2017, 2017-2018. Gjithashtu është dorëzuar një kopje e tyre në formatin Hard Copy. Ashtu siç edhe në takimin me GVJ mungesa e këtij dokumentacioni për vitin 2015-2016 u shpjegua me tranzicionin e strukturave drejtuese në Universitet për shkak të zgjedhjeve për strukturat Universitare. Raportet e departamenteve vlerësojnë (dokumenti nr 38.4) disa kritere siç janë ecuria e procesit mesimorë, mësimdhënia, studentët, punët administrative dhe analiza për çdo kriter shoqërohet me tregues të matshëm. Bashkangjitur këtij materiali do të dorëzohet edhe kjo dosje. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Vërejtja nga GVJ është reale dhe e qëndrueshme në periudhën kur është bërë vlerësimi nga ekspertët e jashtëm. Në RVJ: “Dokumenti I cituar në referenca nr.37.1, Analizat mesimore kerkimore FBU 2014-2018, nuk eshte ne dokumentat e dorëzuara, por vetëm viti 2016-2018.” Në dokumentat e dorezuara online që janë vënë ne dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, dokumenti nr. 37.1 nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është plotësuar për vitet e tjera. Dokumenti 38.4 është vënë në dispozicion të GVJ.

**GVJ bën ndryshim në RVJ**

## **104. Vlerësimi I Standardit VI.2 sipas GVJ është: KRYESISHT**

*Komenti I UBT – Kërkojmë rivleresim të Standardit VI.2 nga “Kryesisht” në “Plotësisht” pasi praktikisht Nuk konstatojmë asnjë vërejtje*

**Përgjigja e GVJ** - Obieksioni dhe kërkesa e institucionit është marrë në konsideratë. Standarti VI.2 vlerësohet PLOTËSISHT. **GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtar standarti VI.2 vlerësimi bëhet PLOTËSISHT.**

**105. Vlerësimi I Standardit VI.3, kriteri 2** - paraqitja në Draft RVJ: Në dokumentin nr. 52.1, Ndryshimi i Kurrikulës BSC 2014-2019, nuk cilësohet tek tabela Ndryshimet në programin e vitit akademik 2017-2018 tek 2018 – 2019 Gjenetikë është ndarë në dy module Gjenetikë dhe Biokimi; është shtuar moduli Bioteknologji Ushqimore; Mikrobiologji e përgjithshme & Ushqimore është ndarë në dy module Mikrobiologji e Përgjithshme dhe Mikrobiologji Ushqimore, të cilat përbëjnë jo vetëm 7% ndryshim.

*Komenti i UBT - Kriteri 2 i standardit VI. 3 nuk parashtron ndryshimet që pëson kurrikula në vite, por i referohet mënyrës së vleresimit të programit të studimit, në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Lidhje me këtë kriter janë dorezuar të gjitha dokumentacionet enevojshme. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të*

*qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - GVJ është dakord me obieksionin se kriteri 2 nuk parashtron ndryshimet që pëson kurrikula në vite, por në GVB thuhet se “Detyra e këtij Komisioni është të vlerësojë periodikisht cilësinë e programeve studimore dhe në rast se është e nevojshme të japë orientime për ndryshim kurrikule në vlerën 20 % për të rritur cilësinë e këtyre programeve<sup>396</sup> “ dhe është cituar dokumenti me numër ref. 396 (**nr. 52.1: Procedura për ndryshimin e kurrikulës** (nëse ka patur); Raport mbi ndryshimet ne Kurrikule. Vendim ndryshim kurrikule) për tu shqyrtuar nga GVJ. GVJ ka vlerësuar dokumentin nr. 52.1.

**GVJ nuk bën ndryshim në RVJ.**

**106. Vlerësimi I Standardit VI.3, kriteri 3** - paraqitja në Draft RVJ: Komenti në RVJ: Sipas modelit të dokumentit të dorëzuar nr 35.1 GVJ: Mendojmë që këto elemente duhet të jenë në të njëjtin format syllabusi ose programi lënde duke specifikuar ngarkesën javore në auditor për veprimtarinë formuese (leksion: seminar/ushtime: laboratore) me temat përkatëse të leksioneve dhe më pas për tematikat e laboratoreve; ashtu si e parashikon VKM Nr 41 dt 24.01 2018.

*Komenti I UBT - Syllabuset e dorëzuara për PS cikli parë në IAU profili TAU janë të gjitha në përputhje me formatin e Syllabusit të percaktuar në Shtojcën nr 2 të VKM 41 (Doc14.4). Formatin e VKM Nr 41 dt.24.01.2018, Shtojca Nr.2 “Programi i lëndës” lejon vetëm paraqitjen e tematikave të zhvilluara nën zërin “Temat e Lëndës”. Në përputhje me këtë format, janë paraqitur vetëm Temat e Moduleve Përkatëse. Ky format, është plotësuar në të njëjtën mënyrë nga të gjitha programet e studimit në UBT. Theksojmë se kjo mënyrë paraqitjeje është kryer vetëm duke filluar në vitin akademik 2018-2019, në zbatim të VKM Nr. 41 Shtojca nr.2. Para vitit akademik 2018-2019, Syllabuset, plotësoheshin sipas formatit të miratuar nga Senati I UBT, ku paraqiteshin planet mësimore dhe kalendarike sëbashku. Duke patur si qëllim paraqitjen sa më të saktë të mënyrës se si kryhen orët e “Seminareve”, kemi plotësuar Planet Kalendarike të lëndëve, ku janë evidentuar në mënyrë të hollësishme orët konkrete të zhvillimit të seminareve teorike, praktikave laboratorike, ushtimeve, detyrave të kursit, detyrave të kontrollit ndërmjetës etj së bashku me tematikat përkatëse. Këto Plane kalendarike disponohen në dokumentat 14.6. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri*

**Përgjigje GVJ** - Syllabuset e dorëzuara nuk janë të gjitha uniforme, sipas shtojcës nr 2 në dokumentin nr. 14.1 dhe jo 14.4 si në obieksion. Në dokumentat e dorëzuara online nuk ka nr. 14.4. Nuk e kanë të detajuar ngarkesën sipas modelit, (Ngarkesa: (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.), duke marrë parasysh planet mësimore të PS në 2016 – 2019. Nuk kanë dhënë shpjegim të cdo teme leksioni sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse. Temat e lëndëve nuk janë të detajuara në faqe. Ndërsa në lidhje me tematikat e laboratorëve ishte një sugjerim nga GVJ. Obieksioni është i drejtë, nuk përfshihen në model.

**GVJ nuk bën ndryshim në RVJ.**

**107. Vlerësimi i Standardit VI.3 sipas GVJ është: “KRYESISHT**

*Komenti I UBT - Nuk konstatohet asnjë vërejtje reale lidhur me plotësimin e standardit VI.3. Për rrjedhojë kerkojmë kalimin nga vlerësimi “Kryesisht” në vlerësimin “Plotësisht”*

**GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar standardi VI.3 vlerësimi KRYESISHT.**

**108. Vlerësimi I Standardit VI.4, kriteri 1 –** Paraqitja në Draft RVJ: Evidentohet mungesa e rregullores së departamentit DTAU nr 6.1

*Komenti i UBT - Për shkak të volumit të madh të dokumentacionit u gjykua e arsyeshme që në dokumentacionin e dorëzuar online të vëndoset vetem faqja e parë e rregullores, por në formatin Hard Copy është dorëzuar një kopje e rregullores DTAU. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri.*

**Përgjigje GVJ -** Vërejtja nga GVJ është reale dhe e qëndrueshme në periudhën kur është bërë vlerësimi nga ekspertët e jashtëm. Në dokumentat e dorëzuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, dokumenti përfaqësues nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtar vërejmë se ky dokument është paraqitur.

**GVJ bën ndryshim në RVJ.**

**109. Vlerësimi I Standardit VI.4, kriteri 3 –** Paraqitja në Draft RVJ - Tjetër problem i evidentuar është në rregulloren e FBU, neni 11 që është i paplotësuar.

*Komenti i UBT - Konstatimi i GVJ-së mbi mos plotësimin e Kreut II në Rregullore FBU qëndron, pasi Neni 11 është i pa plotësuar. Kjo rregullore do të rishikohet dhe do të plotësohet*

**Përgjigje GVJ - GVJ bën ndryshim në RVJ**

**110. Vlerësimi I Standardit VI.4, kriteri 4 –** Paraqitja në Draft RVJ - Dokumenti nr. 3.2 (37.3), nuk është për RVV FBU 2014 por për 2018.

*Komenti i UBT - Konstatimi është i drejtë por bëhet fjalë për një lapsus në shprehjen e vitit të raportit. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri.*

**Përgjigje GVJ -** Në vlerësimin e bërë nga GVJ për këtë kriter nuk është cituar dokumenti nr. 3.2. Duhet të rilexohet nga GVB.

**GVJ nuk bën ndryshim në RVJ**

**111. Vlerësimi I Standardit VI.4 sipas GVJ është: “KRYESISHT**

*Komenti i UBT – Duke qënë se nuk ka vërejtje konsistente lidhur me plotësimin e Standardit VI.4 Kerkojmë rivlerësim të tij nga vlerësimi “Kryesisht” në Vlerësimin “Plotësisht”*

**Përgjigja e GVJ -** Obieksioni dhe kërkesa e institucionit është marrë në konsideratë. Standarti VI.4 vlerësohet PLOTËSISHT. GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar standardi VI.4 vlerësimi bëhet PLOTËSISHT.

**112. Vlerësimi I Standardit VI.5, kriteri 1 -** Koment në RVJ: Sipas GVJ, në dokumentin nr. 38.4, Performanca e departamenteve të FBU, duhet të ishte e shoqëruar me mënyrën e përcaktimit për performancën e mësimdhënies, kërkitimit apo bashkëpunime me të tretët, rezulton nga 146.55 deri në 30.25.

*Komenti i UBT - Në kopjen soft të dokumentave që ne disponojmë, konstatohet se dokumentat me nr. 37.1 Analizat mësimore kërkimore në FBU ekzistojnë dhe përfshijnë vitin 2014-2015, 2016-2017, 2017- 2018. Gjithashtu është dorëzuar një kopje e tyre në formatin Hard Copy. Ashtu si edhe në takimin me GVJ mungesa e këtij dokumentacioni për vitin 2015-2016 u*

shpjegua me tranzicionin e strukturave drejtuese në Universitet për shkak të zgjedhjeve për strukturat Universitare. Raportet e departamenteve vlerësojnë (dokumenti nr 38.4) disa kritere si janë ecuria e procesit mësimorë, mësimdhënia, studentët, punët administrative dhe analiza për çdo kriter shoqërohet me tregues të matshem. Bashkangjitur këtij materiali do të dorëzohet edhe kjo dosje. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri.

**Përgjigje GVJ** - Ndërsa, në dokumentat e dorezuara online që janë vënë në dispozicion GVJ për hartimin e draft raportit, dokumenti nr. 37.1 nuk figuronte. Me dokumentat e dorëzuara në shtator, pas hartimit të draft RVJ përfundimtare vërejmë se ky dokument është plotësuar për vitet e tjera. Dokumenti 38.4 është vënë në dispozicion të GVJ.

**GVJ bën ndryshim në RVJ.**

**113. Vlerësimi I Standardit VI.5, kriteri 2** - Koment në RVJ: Koment në RVJ: Sipas GVJ, në dokumentin nr. 38.4, Performanca e departamenteve të FBU, duhet të ishte e shoqëruar me mënyrën e përcaktimit për performancën e mësimdhënies, kërkimit apo bashkëpunime me të tretët, rezulton nga 146.55 deri në 30.25.

*Komenti I UBT - Në kopjen soft të dokumentave që ne disponojmë, konstatohet se dokumentat me nr. 37.1 Analizat mësimore kërkimore në FBU ekzistojnë dhe përfshijnë vitin 2014-2015, 2016-2017, 2017- 2018. Gjithashtu është dorëzuar një kopje e tyre në formatin Hard Copy. Ashtu si edhe në takimin me GVJ mungesa e këtij dokumentacioni për vitin 2015-2016 u shpjegua me tranzicionin e strukturave drejtuese në Universitet për shkak të zgjedhjeve për strukturat Universitare. Raportet e departamenteve vlerësojnë (dokumenti nr 38.4) disa kritere si janë ecuria e procesit mësimorë, mësimdhënia, studentët, punët administrative dhe analiza për çdo kriter shoqërohet me tregues të matshem. Bashkangjitur këtij materiali do të dorëzohet edhe kjo dosje. Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri.*

**Përgjigje GVJ** - Njësoj si tek kriteri 1.

**114. Vlerësimi I Standardit VI.5, kriteri 4** - Komenti në RVJ: Tjetër problem i evidentuar është në rregulloren e FBU, neni 11 që është i paplotësuar. Dokumenti nr. 3.2 (373), nuk është për RVV FBU 2014 por për 2018.

*Komenti I UBT - Konstatimi i GVJ-së mbi mos plotësimin e Kreut II në Rregullore FBU qëndron, pasi Neni 11 është i pa plotësuar. Kjo rregullore do të rishikohet dhe do të plotësohet Për rrjedhojë, nuk konstatojmë vërejtje reale dhe të qëndrueshme lidhur me plotësimin e këtij kriteri.*

**Përgjigje GVJ:** - GVJ bën ndryshim në RVJ.

**115. Vlerësimi I Standardit VI.5 sipas GVJ është: "PLOTËSISHT"**

*Komenti I UBT - Pothuaj të gjitha vërejtjet janë të përsëritura dhe jemi të mendimit se nuk janë relevante për cilësinë e standardit VI.5. Kërkojmë rivlerësim duke kaluar në Vlerësimin "Plotësisht"*

**Përgjigja e GVJ** - GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar standardi VI.5 vlerësimi **PLOTËSISHT**

*Komenti i UBT - Mendojmë se vërejtjet e bëra në Standardin VI lidhen me nevojën për plotësim*

*dokumentacioni dhe jo me mangësi në zbatimin e këtij standardi cilësie. Prandaj jemi të mendimit se ky Standard duhet rivlerësuar duke kaluar nga vlerësimi "Kryesisht" në vlerësimin "Plotësisht".*

**Përgjigje GVJ** - Institucioni nëpërmjet GVB në RVB vlerësimin për këtë standart VI e ka dhënë kryesisht. Nga rishikimi i standardeve të fushës VI, vlerësimi është tre standarde me vlerësim "kryesisht" dhe dy me vlerësim "plotësisht"

**GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtare, vlerësimi i fushës VI është PLOTËSISHT.**